RAPORT PËRFUNDIMTAR AUDITIMI

MBI PËRPUTHSHMËRINË DHE RREGULLSHMËRINË

NË

SPITALI BASHKIAK SARANDË

Shtator 2022

Nr.	Përmbajtja	Faqe
I.	**PERMBLEDHJE EKZEKUTIVE**	**3-10**
1.	Përshkrimi i shkurtër i Projektit të Auditimit	
2.	Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve	
3.	Konkluzioni i përgjithshëm dhe Opinioni i auditimit	
II.	**HYRJA**	**11-13**
1	Objekti i auditimit	
2	Qëllimi i auditimit	
3	Identifikimi i çështjes	
4.	Përgjegjësitë e strukturave drejtuese	
5.	Përgjegjësitë e audituesve	
6.	Kriteret e vlerësimit	
7.	Standardet e auditimit	
8.	Metodat e auditimit	
9.	Dokumentimi i auditimit	
III.	**PËRSHKRIMI I AUDITIMIT**	**14-81**
1.	Informacion i përgjithshëm mbi subjektin	
2.	Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit	
2.1	Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.	15-16
2.2	Mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, si dhe shpenzimet administrative.	16-24
2.3	Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për strukturën organizative, marrëdhëniet e punës dhe pagave.	25-26
2.4	Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në mbajtjen e evidencës kontabël, ndjekjen e debitorëve e kreditorëve, si dhe menaxhimin e aktiveve të spitalit.	27-55
2.5	Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave të mallrave, shërbimeve dhe punimeve civile.	56-73
2.6	Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për krijimin dhe përdorimin e të ardhurave.	74-76
2.7	Mbi funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.	77-81
IV.	**GJETJET DHE REKOMANDIMET**	**82-96**
V.	**ANEKSE**	**97-98**

I. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Mbështetur në Ligjin nr. 154/2014, datë 27.11.2014 "Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit", në zbatim të Programit të Auditimit nr. 386/1, datë 29.04.2022, i ndryshuar, të miratuar nga Kryetari i KLSH, në subjektin Spitali Bashkiak, Sarandë, nga data 04.05.2022 deri në datë 15.07.2022, u krye auditimi "Mbi Përputhshmërinë dhe Rregullshmërinë e veprimtarisë ekonomike-financiare" për periudhën nga data 01.08.2018 deri në datën 31.12.2021.

1.1. Përshkrimi i shkurtër i projektit të auditimit.

Projekti i auditimit, për auditimin e përputhshmërisë në subjektin Spitali Bashkiak, Sarandë, është pjesë e Planit Vjetor 2022 të auditimit të KLSH-së, miratuar nga Kryetari i KLSH. Projektimi i këtij auditimi, është bërë bazuar në një analizë risku, si gjatë hartimit të planit vjetor, po ashtu edhe gjatë hartimit të Programit të Projektit të Auditimit.

Grupi i auditimit pas shqyrtimit të kundërshtive të subjektit mbi Projektraportin, hartoi Raportin Përfundimtar të Auditimit.

1.2. Përshkrimi i gjetjeve kryesore dhe rekomandimeve

GJETJA NR.	PËRMBLEDHJE E GJETJES	REFERENCA ME RAPORTIN	RËNDËSIA	REKOMANDIMI
1	Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "*Shërbimi lavanterisë dhe hotelerisë për nevoja të Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Sarandë" grupi* i përllogaritjes së fondit limit nuk ka respektuar specifikimet teknike të përcaktuara po nga këto në faqet 18-20 të relacionit nr, 625 prot date 14.05.2021, mos respektimi i specifikimeve konkretisht përmasave të materialit të butë për pavijonin pediatrik por duke i marrë ato si pavijonet për të rritur ka sjellë një rritje të fondit limit me *2,101,377 lekë, vlerë e cila konsiderohet efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit.*	56-73	E Lartë	AK, Njësia e prokurimit ose grupi i përllogaritjes së fondit limit nëse ka një të tillë, në çdo rast duhet të respektojë çdo specifikim teknik, dizajnim apo projektim të parashikuar në përllogaritjen e fondit limit me qëllim shmangien e diferencave që krijohen dhe përsosmërinë në përcaktimin e fondit që do prokurohet.
2	*Të ardhurat nga shërbimet spitalore* për vitin 2019, krahasuar me vitin 2018, janë ulur me 511, 850 lekë, ndërsa në vitet 2019, 2020 dhe 2021, janë në nivele të qëndrueshme, ndërsa *të ardhurat nga parkimi,* janë ulur ndjeshëm në vitin 2021. Krahasuar vitin 2019 me 2018, rezulton se të ardhurat nga ky burim janë rritur me 524,050 lekë, për vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, janë rritur me 167,300 lekë, ndërsa për vitin 2021, krahasuar me vitin 2020 janë ulur me 767,150 lekë, duke ndikuar negativisht në totalin e të	74-76	E lartë	-Drejtori i Spitalit, Drejtoria ekonomike dhe shërbimeve, të marrë masa për venien në funksionim të parkimit në ambientet e brendshme me qëllim shfrytëzimin e hapsirave për parkim në dobi të spitalit dhe rritjen e të ardhurave.

	ardhurave të mbledhura nga spitali, e cila reflektohet në uljen e nivelit të të ardhurave të realizuara në vitin përkatës. Për të ardhurat nga parkimi me qëllim menaxhimin e hapësirave të parkimit në territorin e spitalit është nxjerrë urdhri i drejtorit nr.115, datë 09.11.2018, ku janë përcaktuar edhe tarifat orare të qëndrimit të automjeteve. Të ardhurat në total për vitin 2019 krahasuar me 2018, janë ulur në shumën 12,200 lekë, për vitin 2020 krahasuar me 2019, të ardhurat janë ulur në shumën 14,650 lekë dhe për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020, janë ulur në shumën 373,718 lekë. Megjithëse të ardhurat nga shërbimet spitalore janë nivele të qëndrueshme, janë ulur me ***767,150 lekë***, të ardhurat nga parkimi krahasuar me vitin 2020, si rezultat i mosshfrytëzimit të sipërfaqes së parkimit në favor të spitalit, në kundërshtim me Udhëzimi nr.30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", i ndryshuar, pika 10 **"**Përgjegjësitë e menaxherëve të tjerë, nëpunësve dhe punonjësve publike" dhe rregulloren e institucionit Kreu II "Detyrat dhe kompetencat e zv/drejtorit ekonomik".			
3	Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekt "*Shërbimi lavanterisë dhe hotelerisë për nevoja të Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Sarandë"* me vlerë kontrate 96,880,898 lekë, ku fitues është shpallur OE "D.S" shpk, rezulton se: mallrat e paraqitura në faturën e muajin shkurt 2022, nuk janë sipas specifikimeve teknike të kontrëtës kontratë (faqet 16 deri në 19 Aneksi nr. 2 "Specifikimet teknike"), pasi nuk kanë ofruar llojin e materialit të butë sipas përmasave të hartuara nga grupi i punës, duke ofruar material të butë jo sipas kontratës (*konstatuar edhe nga AK*), duke përfituar padrejtësisht ***vlerën 1,095,579 lekë, e cila konsiderohet dëm ekonomik për buxhetin e shtetit***.	56-73	E Lartë	DSHSS të marrë masa që t'i kërkojë kontraktorit "D.S shpk", duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës **1,095,579** lekë, të cilën e ka përfituar padrejtësisht si edhe në të ardhmen shërbimi të kryhet referuar DST dhe kontratës së nënshkruar.

4	-Për periudhën objekt auditimi nuk është vënë në funksionim Ligji për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, nuk njihet nga strukturat drejtuese të SBR e punonjësit e saj, nuk ka funksionuar në asnjë hallkë të njësisë dhe për pasojë, drejtuesit nuk kanë bërë një vlerësim të efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit, veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar si dhe Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.	77-81	E lartë	Spitali Bashkiak Sarandë të marrë masa për të rritur performancën në drejtim të përdorimit efikas, efektiv dhe ekonomik të burimeve, të personelit, pasurive dhe buxhetit në zbatim të fondeve buxhetore që menaxhmenti i spitalit të jetë përgjegjës, jo vetëm për marrjen e vendimeve por edhe për të siguruar që këto vendime të jenë efektive, si hartimin dhe menaxhimin e strategjisë dhe regjistrit të riskut, krijimin e listave të proceseve kryesore dhe gjurmët e auditimit, me qëllim arritjen e mjaftueshme të aktiviteteve të kontrollit për identifikimin, kontrollin dhe reduktimin e risqeve, si edhe përfshirjen efektive të sektorëve të ndryshëm në procese, dokumentacionin përkatës, përgjegjësitë personale, mbështetjen e sistemeve të IT.
5	Nga Sektori i Financës nuk janë marrë masat e nevojshme për mbajtjen e regjistrit historik të AAGJM, kryerjen e procedurave të plota të inventarizimit si dhe llogaritjen e amortizimit aktiv për aktiv mbi bazë historiku të krijimit të tij. Nuk janë mbajtur të dhëna për aktivet për një pjesë të tyre si: viti i krijimit, shtesat dhe pakësimet për to, pra nuk është mbajtur një libër i mirëfilltë historik me të gjitha të dhënat e aktiveve të trupëzuara sipas modelit klasik të	27-55	E lartë	Sektori i Financës të hartojë një regjistër të plotë historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, vend-ndodhjen, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës

	trajtuar më lart, domosdoshmëri kjo për të pasur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit në përputhje me kap III pika 30, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".			së aktivit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur. Mbi bazën e tij të llogarisë amortizimin aktiv për aktiv si edhe të realizojë inventar fizik për të gjithë AAGJ, për verifikimin e ekzistencës fizike e tyre.
6	Referuar analizës së gjendjes së llog.401- 404 "Furnitorë e llogari të lidhura me to", në fund vitin 2021 rezulton me një gjendje prej ***18,556,689 lekë*** në të cilën janë akumuluar fatura të pa likuiduara të viteve 2019, 2020 dhe 2021, të cilave u ka kaluar afati 30-ditor i pagesës së këtyre faturave, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 52 dhe ligjin nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" neni 6 "Afati".			Spitali Sarandë të marrë masa për sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos krijojë kufizime limiti të arkës *(përjashtuar kufizimet e MFE)*, për likuidimin e faturave në kohë, me qëllim mos krijimin e borxhit për fatura të pa likuiduara dhe futjen e institucionit në vështirësi financiare.
7	Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për kryerjen e inventarizimit për vitet 2019, 2020 dhe 2021 janë nxjerrë urdhrat përkatës, rezultoi se komisionet e inventarizimit kanë hartuar fletët e inventarëve me gjendjen fizike të aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara e të trupëzuara dhe gjendjen kontabël sipas llogarive. Fletët e inventarëve janë të konfirmuara nga komisioni dhe përgjegjësit material brenda afateve të përcaktuara për kryerjen e inventarëve. Referuar dokumentacionit të mbajtur nga komisioni konstatohet se për disa njësi kryerja e inventarizimit paraqet mangësi dhe shkelje të dispozitave ligjore, pasi komisioni ka konstatuar mungesa në artikuj të ndryshëm ka kryer diferencat nga gjendja fizike dhe i ka kaluar brenda ditës së inventarizimit në listën "mallra për jashtë përdorimit dhe funksionit". Shuma e diferencave të artikujve për gjendjen fizike krahasuar me			-Drejtori i institucionit të marrë masa për ngritjen e komisionit të inventarizimit me qëllim verifikimin e diferencave të gjendjes fizike të mallrave të paraqitura nga inventarizimet e viteve 2019-2020 dhe 2021 në shumën ***5,412,482 lekë,*** për të cilat nëse rezultojnë me diferenca të nxirren urdhër

	gjendjen e kontabilitetit e konstatuar nga inventarët e kryer **për vitin 2020 është 7,503,244** lekë dhe **shuma për vitin 2021 është 5,412,482** lekë, për të cilat nuk janë zbatuar drejt procedurat e inventarizimit si edhe nuk janë nxjerrë urdhër zhdëmtimet për personat përgjegjës në rastet e diferencave të gjendjes fizike. -Vlera e propozuar për nxjerrje jashtë përdorimi e mallrave dhe materialeve që kanë humbur vlefshmërinë e përdorimit në spitalin Bashkiak Sarandë është **21,844,733 lekë,** për të cilën prej vitit 2019 nuk është vepruar nga strukturat drejtuese dhe nuk janë marrë masa për asgjësimin e tyre si ngritja e komisioneve të vlerësimit, komisionet e asgjësimit, etj.			zhdëmtimet për personat përgjegjës. -Drejtori i institucionit të marrë masa për ngritjen e komisionit të vlerësimit të mallrave që kanë humbur vlefshmërinë e përdorimit vlerësuar prej vitit 2019 në shumën **21,844,733 lekë,** si edhe të kryej procedurat e nxjerrjes jashtë përdorimit të mallrave që do të klasifikohen jashtë funksionit, duke kryer analizat dhe argumentimet e bazuara në kriteret përkatëse dhe me relacionet shoqëruese.

1.3. Konkluzioni i përgjithshëm dhe opinioni i auditimit

Në subjektin Spitali Bashkiak, Sarandë, nga data 04. 05. 2022 deri në datë 15.07.2022, u krye "*Auditim Financiar dhe i Përputhshmërisë*", për periudhën nga data 01.08.2018 deri në datë 31.12.2021, nga ku rezultuan mangësi dhe shkelje të dispozitave ligjore në fuqi. Institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë të cilat lidhen cilësisht e kryesisht me mbajtjen e sistemit të kontabilitetit, hartimit dhe plotësimit të gjurmës së auditimit, implementimin e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, regjistri i aktiveve që ka në pronësi apo posedim, nuk është plotësuar me kërkesat që duhet të përmbajë ky regjistër. Në procedurat e prokurimeve u konstatuan mangësi në hartimin e termave të referencës, duke e bërë të paargumentuar hartimin e fondit limit dhe për pasojë ofertimin e marrë nga operatorë të tregut. Nga auditimi u konstatuan mangësi në disa raste në llogaritjen e vlerës së kontratave dhe hartimin e kritereve të kualifikimit. Në procedurat e audituara rezulton se nga komisionet e vlerësimit të ofertave nuk është shpallur fitues asnjë operator ekonomik me vlerë më të lartë, si edhe në procedurat e kryera për medikamente për llogaritjen e vlerës së kontratës grupet e ngritura për këtë qëllim, janë bazuar në çmimet e medikamenteve të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë.

1.1. Përshkrimi i shkurtër i projektit të auditimit.

Projekti i auditimit, për auditimin e përputhshmërisë në Spitali Bashkiak, Sarandë, është pjesë e Planit Vjetor 2021 të auditimit të KLSH-së, miratuar nga Kryetari i KLSH. Projektimi i këtij auditimi, është bërë bazuar në një analizë risku, si gjatë hartimit të planit vjetor, po ashtu edhe gjatë hartimit të Programit të Projektit të Auditimit.

Auditimi në Spitali Bashkiak, Sarandë u planifikua të zhvillohej nga data 04. 05. 2022 deri në datë 15.07.2022, periudha e audituar është 01.08.2018 - 31.12.2021.

Grupi i auditimit pas shqyrtimit të kundërshtive të subjektit mbi Projektraportin, hartoi Raportin Përfundimtar të Auditimit.

Opinioni i pasqyrave financiare viti 2021:

Grupi i auditimit të KLSH, ka audituar pasqyrat financiare të Spitali Sarandë, të periudhave ushtrimor 01.01.2021 – 31.12.2021, të cilat përfshijnë pasqyrat e pozicionit financiar, pasqyrat e performancës financiare, pasqyrat e ndryshimeve të aktiveve, pasqyrat e fluksit të mjeteve monetare dhe pasqyrat e shënimeve shpjeguese.

Auditimi ka përfshirë ekzaminimin, në bazë testimesh, të dokumenteve që mbështesin shumat dhe shpalosjet në pasqyrat financiare, ku u bë vlerësimi i parimeve kontabël të përdorura dhe vlerësimeve të bëra nga drejtuesit, si dhe vlerësimi i paraqitjes së përgjithshme të pasqyrave financiare.

Sipas opinionit tonë, pasi kemi marrë evidenca dhe dëshmi të mjaftueshme dhe të përshtatshme të auditimit, shprehim një **opinion të kualifikuar** për llogaritë vjetore të subjektit Spitali Sarandë, duke arritur në përfundimin se anomalitë apo rastet e mospërputhshmërisë, individualisht ose së bashku, janë materiale por jo të përhapura, në llogaritë vjetore të vitit 2021".

Baza për opinionin e kualifikuar:

Ne e kryem auditimin tonë në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (SNA-të). Përgjegjësitë tona janë përshkruar në mënyrë më të detajuar në seksionin përkatës të Raportit Përfundimtar të Auditimit.

Ne jemi të pavarur nga Subjekti i audituar në përputhje me kërkesat etike, që janë të zbatueshme për auditimin e pasqyrave financiare dhe kemi përmbushur përgjegjësitë e tjera etike në përputhje me këto kërkesa.

Opinionin e dhënë e mbështesim në faktin se, pasqyra e pozicionit financiar, pasqyra e performancës financiare, pasqyra e ndryshimeve në kapital, pasqyra e flukseve e mjeteve monetare, si dhe shpjegimet janë përfshirë në deklaratat financiare, por gjatë auditimit kemi arritur në përfundimin se pasqyrat financiare përmbanin disa gabime materiale (por jo të përhapura), të cilat sipas mendimit tonë kanë efekt në pozicionin financiar të llogarive. Për këto arsye kemi dhënë opinion të kualifikuar, sipas përshkrimit të çështjeve të trajtuara në gjetjet e Projektraportin e Auditimit, konkretisht:

Nga auditimi i Pasqyrave financiare për periudhën objekt auditimi u konstatua se:

-Nuk janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.

-Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë mbajtur kronologjikisht dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, arkës, magazinës, pagave, etj, por nuk janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitore.

-Nuk është mbajtur libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera.

-Vlera e mbetur në fund të vitit 2021 për aktivet afatgjata jomateriale (Klasa 20), prej ***10,411,705 lekë*** e paraqitur në gjendjen e *llogarisë 202 "Studime dhe Kërkime",* është e pa analizuar dhe nuk ka të dhëna se çfarë përfaqëson.

-*Gjendja e llogarisë 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune"* në vlerë historike (vlerë bruto) në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 243,833,407 lekë, nuk ka analizë si edhe për shtesat dhe pakësimet nuk ka të dhënë për veprimet kontabël të kryera.

-Gjendja e llogarisë së fondeve ***7206 "Financim i pritshëm nga buxheti"*** në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 40,150,870 lekë, e cila nuk rakordon me gjendjen në vlerën 34,345,484 lekë të llogarisë analoge 4342 *"Operacione me shtetin (të drejta)"* të bilancit.

-*Gjendja e llogarisë **63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit"*** nuk rakordon me ndryshimin e gjendjeve të llogarive të klasës 3 **"Gjendja e inventarit qarkullues"** të aktiveve qarkulluese të cilat paraqiten me diferencë në zbritje në vlerën prej **-1,275,578** lekë.

-Gjendja e llog.401- 404 "Furnitorë e llogari të lidhura me to", në fund vitin 2021 rezulton në shumën ***18,556,689 lekë*** në të cilën janë akumuluar fatura të palikuiduara të viteve 2019, 2020 dhe 2021.

Përgjegjësitë e Drejtuesve të Spitalit Sarandë.
Stafi drejtues, është përgjegjës për përgatitjen dhe prezantimin e saktë të pasqyrave financiare në përputhje me kërkesat e kuadrit rregullator lidhur me raportimin financiar, si dhe kontrollin e brendshëm që ka rezultuar i nevojshëm për përgatitjen e pasqyrave financiare, për të shmangur gabimet apo mashtrimet.
Stafi drejtues është gjithashtu përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e aplikuara. Personat përgjegjës për drejtimin janë përgjegjës për kontrollin e procesit të raportimit financiar.
Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH.
Objektivi i audituesit të jashtëm publik lidhet me garantimin e sigurisë së arsyeshme[1]. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë. Përveç standardeve ISSAI, audituesi i KLSH, gjithashtu aplikon edhe gjykimin dhe skepticizmin e tij profesional në punën audituese.
Ne komunikojmë me drejtuesit ndër të tjera, edhe për planifikimin në kohë dhe përmbajtjen e auditimit si dhe konkluzionet/gjetjet, duke përfshirë edhe të metat e kontrollit të brendshëm që ne kemi identifikuar gjatë auditimit tonë.
Auditimi identifikon çështjet më të rëndësishme lidhur me auditimin, të cilat i përshkruajmë ato në raportet e auditimit, me përjashtim të rasteve kur kuadri ligjor nuk lejon vënien në dispozicion të tyre për publikun ose në raste të rralla kur vetë ne vendosim që këto çështje nuk duhet të përfshihen në raport për shkak të pasojave negative që publikimi i tyre mund të sjellë në publikun e gjerë.

Opinioni i auditimit mbi përputhshmërinë
KLSH ka audituar përputhshmërinë me kuadrin rregullator në fuqi të veprimtarisë së Spitalit Bashkiak, Sarandë, për periudhën 01.08.2018 – 31.12.2021, pasi kemi marrë dëshmi të mjaftueshme, të përshtatshme dhe të besueshme, sipas mendimit tonë, kemi konstatuar se në shumë raste nuk janë përmbushur si duhet kërkesat e kuadrit rregullator në fuqi. Për shkak të rëndësisë së devijimeve të konstatuara dhe numrit të tyre, mbështetur në standardet ISSAI 4000 , në gjykimin profesional të audituesit shtetëror të pavarur, këto devijime janë të përhapura dhe materiale, efektet e të cilave justifikojnë dhënien e një ***opinioni të kualifikuar.***
Baza për opinionin e kualifikuar
Bazuar në punën e kryer të auditimit, evidencat e marra për veprimtarinë e Spitalit Sarandë, rezultuan anomali, nga të cilat më kryesoret janë:
- Sistemi i menaxhimit financiar dhe kontrollit të brendshëm nuk është ngritur dhe nuk ka funksionuar si duhet, duke sjellë mangësi materiale në të gjithë elementët e tij kryesor.
-Janë konstatuar mangësi në procedurat e prokurimit publik, me pasojë dëm ekonomik në vlerën 1,911 mijë lekë, përdorim i fondeve publike pa efektivitet në vlerën 2,868 mijë lekë, mangësi në përcaktimin e kritereve të veçanta të dokumenteve standarde të tenderit dhe në kualifikimin e ofertave.
-Janë konstatuar mangësi në rregulloren e funksionimit të shoqërisë, në kryerjen e inventarëve të aktiveve, etj.
Përgjegjësitë e strukturave drejtuese
Stafi drejtues është përgjegjës për kryerjen e aktiviteteve dhe funksioneve të strukturës në përputhje me të gjitha ligjet dhe rregulloret në fuqi. Drejtimi është përgjegjës për ngritjen dhe monitorimin e sistemit të kontrollit të brendshëm, me qëllim shmangien e gabimeve apo mashtrimet e mundshme. Stafi drejtues është përgjegjës për përdorimin e burimeve financiare në përputhje me politikat, ligjet dhe rregulloret e miratuara, për kontrollin e procesit të

[1] ***ISSAI 300,*** *Parimet bazë të auditmit në lidhje me përputhshmërinë pohojnë se auditim duhet të japë siguri të arsyeshme për zbulimin e gabimeve, parregullsive dhe veprimtarive të paligjshme që mund të cenojnë ndjeshëm objektin e auditmit.*

raportimit financiar dhe për përdorimin e këtyre fondeve me ekonomicitet eficencë dhe efektivitet etj.

Përgjegjësitë e Audituesve të KLSH mbi Auditimin e Përputhshmërisë

Përgjegjësia jonë është që nëpërmjet auditimit të realizuar:

-Të vlerësojmë nëse informacionet mbi çështjet e audituara janë në përputhje me kriteret e përcaktuara sipas legjislacionit në fuqi. Masa e ndjekjes nga subjekti i audituar i rregullave, legjislacionit dhe akteve normative, politikave, kodeve të miratuara apo kushtet e përcaktuara (ISSAI 4000), nuk paraqesin devijime materiale nga kriteret e vlerësimit, si pasaktësi apo gabime dhe janë në përputhje me kuadrin rregullator mbi bazën e të cilit ushtrohet veprimtaria e subjektit të audituar. Ne si Auditues Shtetëror shprehemi me një opinionin mbi përputhshmërinë e aktivitetit të institucionit, si dhe përdorimin e duhur dhe eficient të burimeve financiare prej tij. Auditimi është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit (INTOSAI), bazuar në këto standarde ne aplikojmë gjykimin dhe skepticizmin tonë profesional në punën audituese.

-Të kryejmë në mënyrë efektive auditimin (ISSAI 1300)

-Të vlerësojmë nëse është siguruar evidenca e mjaftueshme dhe e përshtatshme e auditimit dhe nëse bazuar në ketë evidence ai mund të formojë konkluzionet përkatëse. (ISSAI 1500, ISA 300).

-Të kryejmë procedura të përshtatshme auditimi në funksion të këtij objektivi.

Ne jemi të pavarur kundrejt subjektit të audituar, e theksuar kjo në ISSAI-n 10 “Deklarata e Meksikës mbi Pavarësinë e SAI-t”, si dhe ISSAI 30 “Kodi Etik”, apo edhe çështje të tjera që lidhen me auditimin. Ne i kemi përmbushur përgjegjësitë tona etike, në përputhje me standardet e sipërpërmendura. Objektivat e punës sonë lidhen me garantimin e sigurisë së arsyeshme nëse çështjet subjekt auditimi, që mund të kenë ekzistuar, si dhe për të konkluduar me një raport auditimi që përfshin dhënien e opinionit. Siguria e arsyeshme është një nivel i lartë sigurie, por nuk garanton që auditimi i kryer në përputhje me standardet mundëson identifikimin e çdo gabimi apo anomalie që mund të ekzistojë në veprimtarinë e subjektit të audituar. Gjithashtu, ne besojmë se dëshmitë e marra gjatë punës sonë audituese janë të mjaftueshme dhe të përshtatshme për të siguruar bazat për përgatitjen e opinionit të auditimit.

II. HYRJA

Mbështetur në Ligjin nr.154/2014, datë 27.11.2014 "Për Organizimin dhe Funksionimin e KLSH", në zbatim të Projektit dhe Programit të Auditimit nr. 386/1, datë 29.04.2022, i ndryshuar, të miratuar nga Kryetari i KLSH, nga data 04. 05. 2022 deri në datë 15.07.2022, në subjektin Spitali Bashkiak, Sarandë, për periudhën nga data 01.08.2018 deri në datën 31.12.2021, u krye auditimi "Mbi Përputhshmërinë dhe Rregullshmërinë e veprimtarisë ekonomike-financiare" nga Grupi i Auditimit me përbërje:

1. M. B, Përgjegjës Grupi
2. S. H, Auditues
3. A. T, Auditues
4. K. G, Auditues

1. Objekti i auditimit. Në objektivat dhe qëllimet e auditimit përfshihet vlerësimi objektiv i evidencave, dokumentacionit të kërkuar dhe të vënë në dispozicion, për të përcaktuar nëse të dhënat e raportuara për periudhën objekt auditimi përputhen me kriteret përkatëse të kuadrit rregullator. Objektivi i Auditimit është dhënia e opinionit nëse Spitali Sarandë, në të gjithë aspektet materiale, aktiviteti ekonomik dhe financiar, transaksionet dhe informacioni janë në përputhje ose jo me dispozitat ligjore dhe rregulloret përkatëse, me parimet e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin dhe kornizës ligjore të prokurimit publik, si dhe argumentimin e shpenzimeve të kryera në funksion të veprimtarisë së tij. Auditimi ka për qëllim promovimin e transparencës, duke ofruar raporte të besueshme për fondet nëse janë administruar, siç kërkohet në aktet ligjore.

2. Qëllimi i auditimit. Qëllimi i këtij auditimi përputhshmërie është evidentimi i devijimit nga standardet e pranuara i shkeljes së parimeve të ligjshmërisë, është dhënia e opinionit apo hartimi i raportit të auditimit mbi bazën e vlerësimeve të gjetjeve dhe dhënia e rekomandimeve për përmirësime të menaxhimit financiar me synim ndërmarrjen e masave dhe veprimeve korrigjuese nga subjekti i audituar. Auditimi i përputhshmërisë i ndërmarrë nga Kontrolli i Lartë i Shtetit, ka për qëllim promovimin e qeverisjes së mirë në sektorin publik, duke marrë parasysh rrezikun e mashtrimit në lidhje me përputhshmërinë *(sipas ISSAI 400, p 18).*

Me auditimin e përputhshmërisë, duhet të përcaktohet niveli i zbatimit të kuadrit ligjor në fuqi lidhur me realizimin e procedurave të prokurimit të realizuara në periudhën nën auditim.

3. Identifikimi i çështjes. Institucioni duhet të ketë organizimin e duhur, për të funksionuar duke respektuar aktet ligjore e nënligjore në fuqi, për rritjen e cilësisë së shërbimit ndaj qytetarëve, duke patur në konsideratë shpenzimin e fondeve me ekonomicitet, eficiençë dhe efektivitet. Projekt Raporti mbi përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike dhe financiare të Spitalin Sarandë për periudhën 01.08.2018 - 31.12.2021, ka identifikuar sipas kritereve specifike të vlerësimit, shqyrtimin dhe vlerësimin e fushave në vijim:

- Ligjshmërinë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese dhe vendimeve të marra;
- Hartimin, shqyrtimin dhe miratimin si dhe realizimin e buxhetit;
- Zbatimin e strukturës organizative dhe administrimin e marrëdhënieve të punës;
- Rregullshmërinë e kryerjes së shpenzimeve;
- Mbajtjen e evidencës kontabile dhe analiza e debitorëve e kreditorëve;
- Zbatimin e ligjshmërisë në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave; etj.

4. Përgjegjësitë e strukturave drejtuese. të subjektit të audituar lidhur me çështjen nën auditim: Strukturat drejtuese kanë për detyrë që të përgjigjen për garantimin e sistemeve të përshtatshme dhe efektive të menaxhimit financiar dhe kontrollit, në përputhje me kërkesat e kuadrit ligjor dhe rregullator përkatës. Një ndër përgjegjësitë kryesore të strukturave drejtuese është ngritja e sistemeve të kontrollit dhe marrjes së masave të sinjalizimit për veprime

korruptive të punonjësve. Hartimi i rregullave të brendshme referuar funksionit të veprimtarisë së institucionit, strukturës në dispozicion, duke përcaktuar përgjegjësitë dhe detyrimet e çdo punonjësi në zbatim të akteve ligjore në fuqi, mbi të gjitha duke shmangur dhe mbikëqyrur konfliktin e interesit. Përgjegjësi e strukturave drejtuese të institucionit është përdorimi me efektivitet dhe ligjor të fondeve, duke eliminuar shpenzimet jo efektive dhe jo në funksion të veprimtarisë, sigurisht dhe marrja e masave për njohjen e akteve ligjore që veprojnë dhe në fuqi për të gjithë punonjësit e strukturës funksionale duke programuar trajnimin e vazhdueshëm dhe mbikëqyrur integritetin e tyre.
Institucioni brenda kuadrit përkatës të parashikuar nga legjislacioni në fuqi, kryen çdo operacion financiar që lidhet drejtpërdrejtë ose tërthorazi me objektin e tij.

5. Përgjegjësitë e audituesve: Përgjegjësia jonë është që të shprehim një opinion të saktë objektiv, profesional e të pavarur, nëse aktivitetet, transaksionet financiare dhe informacioni përputhen apo jo, në të gjitha aspektet materiale, me kriteret e aplikuara mbi përputhshmërinë dhe rregullshmërinë e veprimtarisë ekonomiko financiare, në bazë të auditimit tonë.
Ne mbajmë përgjegjësi që në praktikën e auditimit si dhe në hartimin e P/Raportit të auditimit janë zbatuar procedurat në përputhje me rregulloret e miratuara dhe në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Auditimit sipas INTOSAI. Referuar këtyre Standardeve audituesi gjithashtu duhet të respektojë kërkesat etike dhe të planifikojë dhe kryejë auditimin me qëllim që të arrijë nivelin e sigurisë së kërkuar. Siguria e kërkuar i referohet një niveli të pranueshëm sigurie, por nuk garanton asnjëherë sigurinë absolute, dhe auditimi në pajtueshmëri me standardet nuk presupozohet që të zbulojë gjithnjë një gabim material kur ai ekziston. Procedurat e zgjedhura varen nga gjykimi i audituesit, duke përfshirë këtu edhe vlerësimin e rreziqeve nga gabimi material, qoftë për shkak të mashtrimit apo gabimit.

6. Kriteret e vlerësimit: Kriteret e vlerësimit të përdorura në këtë auditim e kanë burimin në legjislacionin bazë dhe dytësor, në dispozita të tjera si dhe kuadrin rregullator përkatës sipas çështjeve të auditimit: Ligji nr. 154/2014, datë 27.11.2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”; Ligji nr. 9228, datë 29.4.2004 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”, i ndryshuar; Ligji nr. 10405, datë 24.3.2011 “Për kompetencat për caktimin e pagave dhe të shpërblimeve; Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar”; Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar; Ligji nr. 7892, datë 21.12.1994 “Për Sponsorizimet”, i ndryshuar; Ligji nr. 10296, datë 8.7.2010 “Për menaxhimin financiar dhe kontrollin” i ndryshuar; Ligji nr. 7961, datë 12.07.1995 “Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar; Ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar; Ligji nr.9106, datë 17.07.2003 “Për shërbimin spitalor në RSH”, i ndryshuar, Ligji nr.105/2014 “Për barnat dhe shërbimin farmaceutik”, VKM nr. 914 datë 29.12.2014 “Rregullat e Prokurimit" i ndryshuar; VKM nr. 997, datë 10.12.2010 “Për trajtimin financiar të punonjësve që dërgohen me shërbim jashtë qendrës së punës, brenda vendit”, i ndryshuar; VKM nr.914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 “Për menaxhimin e aktiviteteve në njësitë e sektorit publik”, i ndryshuar; Urdhri i Ministrit të Shëndetësisë nr.559, datë 26.10.2009 “Për aplikimin e tarifave të shërbimeve mjekësore” , Urdhri nr.3272, datë 11.09.2007 “Mbi politikat kombëtare mbi menaxhimin e pajisjeve mjekësore në Shqipëri” dhe rregullorja e brendshme e funksionimit.

7. Standardet e auditimit. Auditimi është kryer në përputhje me procedurat e përgjithshme të pranuara të kuadrit ligjor, rregullator dhe Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit. Projekt Raporti i auditimit është hartuar në përputhje me kërkesat e Rregullores së Procedurave të Auditimit në KLSH, mbështetur në:
-Ligjin nr. 154/2014 “Për organizimin dhe funksionimin e Kontrollit të Lartë të Shtetit”;
-ISSAI 100 – *(Parimet themelore të auditimit të sektorit publik).*
-ISSAI 400 – *(Standardet e Auditimit të Përputhshmërisë).*

--ISSAI 4100 - *(Rregulloren e Procedurave të Auditimit).*
-Kodi etik i KLSH dhe Rregullorja e Brendshme.
-ISSAI 4000- Prezantim i përgjithshëm i udhëzimeve për auditimin e përputhshmërisë";
-ISSAI 1500 (ISA 500)- Objektivi i audituesit është të hartojë dhe të kryejë procedurat e auditimit në mënyrë të tillë që të mundësojë marrjen e evidencës së mjaftueshme për të nxjerrë konkluzione të arsyeshme në të cilin do të bazojë opinionin e tij;
- Manualin e Auditimit të Përputhshmërisë të Gjykatës Evropiane të Audituesve;
-Kërkesat e Udhërrëfyesit të IDI-t, INTOSAI "Për implementimin e Standardeve Ndërkombëtare të Auditimit, ISSAI mbi Auditimin e përputhshmërisë"; si dhe në praktikat më të mira të fushës.
8. Metodat e auditimit. Audituesit e KLSH, mbi bazën e evidencave të kërkuara dhe të vëna në dispozicion, intervistave, takimeve dhe konsultave me nëpunësit e Spitalit Sarandë, kanë përgatitur dokumentacionin e mjaftueshëm të auditimit, si rezultat i kuptimit të qartë të kritereve të përdorura, të fushë-veprimit të auditimit; të gjykimeve, të përfundimeve të arritura, programin e auditimit dhe natyrën, kohën, shtrirjen dhe rezultatet e procedurave të kryera; si dhe konkluzioneve lidhur me to. Në këtë mënyrë, dokumentimi i auditimit është kryer nëpërmjet letrave të punës, shënimeve, pyetësorëve, të finalizuara me akt-konstatimet dhe observacionet e subjektit, të cilat kanë shërbyer si bazë për hartimin e këtij Projekt-Raporti.
9.Dokumentimi i auditimit, është kryer bazuar në kërkesat e manualit të auditimit të përputhshmërisë, në standardet ndërkombëtare të auditimit (ISAI), për të mundësuar dhe kuptuar natyrën, kohën dhe shtrirjen e procedurave të auditimit të kryera në përputhje me standardet dhe kërkesat ligjore dhe rregullatore.

III. PËRSHKRIMI AUDITIMIT

1. Informacion i përgjithshëm mbi subjektin nën auditim

Spitali Bashkiak Sarandë, është institucion buxhetor në vartësi të Ministrisë së Shëndetësisë. Fondet e përfituara për ushtrimin e veprimtarisë janë fondet buxhetore të çelura nga fondi i sigurimit të detyrueshëm të kujdesit shëndetësor për paga, sigurime, shpenzime operative dhe nga Ministria e Shëndetësisë për investime sipas programeve dhe fondeve te miratuara me ligjet vjetore të buxhetit të shtetit. Kërkesat buxhetore përmbajnë raportet standarde të përcaktuara në udhëzimet për hartimin e PBA, si misionin, deklaratat, shpenzimet sipas programeve, artikujve, produkteve, si dhe projektet me financim të brendshëm.

Spitali funksionon sipas ligjit nr. 9106, datë 17.7.2003 "Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë", Rregullores së brendshme, shërbimi mjekësor në Spitali Sarandë ushtrohet në përputhje me: Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, ligjin nr. 7961, datë 12.07.1995 *"Kodi i Punës i Republikës së Shqipërisë"i ndryshuar,* ligjin nr. 8485 për "*Kodin e Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë*", ligjin nr. 7870, datë 13.10.1994 "*Për Sigurimet Shëndetësore*", *i ndryshuar,* ligjin nr. 8615, datë 01.06.2000 "*Për Urdhrin e Mjekut*", si dhe akte të tjera ligjore e nënligjore që lidhen me veprimtarinë e saj.

Nga auditimi i kryer pranë këtij Spitali, për periudhën 01.08.2018-31.12.2021, lidhur me përputhshmërinë e veprimtarisë ekonomike-financiare, rezultoi se, Institucioni për periudhën nën auditim paraqet të meta dhe mangësi në disa prej drejtimeve të veprimtarisë të cilat lidhen cilësisht e kryesisht me mbajtjen e sistemit të kontabilitetit, hartimit dhe plotësimit të gjurmës së auditimit, implementimin e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin, regjistri i aktiveve që ka në pronësi apo posedim, nuk është plotësuar me kërkesat që duhet të përmbajë ky regjistër. Në procedurat e prokurimeve u konstatuan mangësi në hartimin e termave të referencës, duke e bërë të paargumentuar hartimin e fondit limit dhe për pasojë ofertimin e marrë nga operatorë të tregut. Nga auditimi u konstatuan mangësi në disa raste në llogaritjen e vlerës së kontratave dhe hartimin e kritereve të kualifikimit. Në procedurat e audituara rezulton se nga komisionet e vlerësimit të ofertave nuk është shpallur fitues asnjë operator ekonomik me vlerë më të lartë, si edhe në procedurat e kryera për medikamente për llogaritjen e vlerës së kontratës grupet e ngritura për këtë qëllim, janë bazuar në çmimet e medikamenteve të miratuara nga Ministria e Shëndetësisë.

Referuar auditimit të buxhetit si dhe nevojave dhe konsumit të fondeve për periudhën objekt auditimi, ka rezultuar se nga ana e Spitalit janë kërkuar fonde brenda tavaneve të miratuara me VKM për programet e shërbimit terciar (spitalet) në një kohë që këto nevoja për fonde janë më të mëdha se tavanet e miratuara, diktuar edhe nga situata e krijuar nga pandemia Covid-19.

Rëndësia e këtij auditimi për KLSH është e përcaktuar nga pikëpamja shoqërore pasi ka të bëjë me çështje shumë sensitive të shëndetit të popullsisë dhe përballimin e sitauatës Covid -19, si dhe duke qenë se institucionet e shëndetësisë kanë probleme në drejtim të fondeve të akorduara të cilat nuk janë të mjaftueshme deri në plotësimin e nevojave të spitalit dhe kushteve optimale të trajtimit të të sëmurëve, auditimi me efektivitet dhe ekonomicitet i fondeve del shumë i rëndësishëm. Grupi i auditimit ka planifikuar auditimin e fondeve në masë të konsiderueshme duke audituar mbi 50% të transaksioneve të likuidimeve nëpërmjet bankës për auditimin e shtrirë në të 3 vitet dhe auditimin e blerjeve dhe investimeve për procedurat ku vlera e investimit apo e blerjes është e konsiderueshme.

2. Përshkrimi i auditimit sipas drejtimeve të auditimit:

2.1. Mbi zbatimin e ligjshmërisë për emërimet dhe funksionimin e strukturave drejtuese, vendimet e marra dhe zbatimi i tyre.

Drejtimi administrativ i Spitalit Sarandë është në varësi të Ministrisë së Shëndetësisë.

Organizimi i spitalit drejtohet nga Drejtori dhe sipas përcaktimit të kryer në rregulloren e brendshme, organi i vetëm ndihmës i spitalit është **Komisioni Mjekësor Spitalor,** i cili përbëhej nga mjekë dhe merrte vendime në lidhje me aktivitetin e shërbimit shëndetësor dhe ndryshimet në lidhje me këtë shërbim, si vendimet në rastin e pandemisë covid, emërtesat dhe nevojat për barnat të planifikuara në buxhetin e vitit pasardhës, etj.

Edhe pse spitali ka vetëm një organ ndihmës, në rregulloren e brendshme janë përcaktuar organet drejtuese të spitalit *"Drejtoria është organi i vetëm ekzekutiv në Spital. Ajo, nën mbikëqyrjen e Këshillit Administrativ drejton dhe organizon veprimtarinë mjekësore, administrative, financiare dhe teknike".* Nga auditimi konstatohet se Spitali nuk ka ngritur Këshill Administrimi.

-Për vitin 2018, janë marrë 76 urdhra nga Drejtori i Spitalit Bashkiak Sarandë, ***Për vitin 2019,*** janë marrë 171 urdhra, ***Për vitin 2020*** janë marrë 182 urdhra dhe ***Për vitin 2021*** janë marrë 187 urdhra. Urdhrat e marrë në përgjithësi kanë të bëjnë me emërimet e kandidatëve fitues për pozicionet e punës, lirimin nga pozicioni i punës dhe transferimin në pozicione të tjera, për nisjen e procedurave të prokurimit me vlera të vogla, për krijimin e komisionit të prokurimit, për pezullimin e procedurave të prokurimit në raste të ankesave nga OE, për përdorimin e të ardhurave dytësore, për shpërblime, etj.

Për periudhën objekt auditimi referuar urdhrave të nxjerrë nga Drejtori i institucionit (sipas periudhave) nuk u konstatuan mangësi dhe shkelje të procedurave dhe akteve ligjore e nënligjore në marrjen e vendimeve si edhe tejkalim i kompetencave të titullarit.

Titulli i gjetjes:	Spitali Bashkiak Sarandë nuk ka Këshill Administrativ.
Situata:	Nga auditimi i funksinimit të strukturave drejtuese në Spitalin Bashkiak Sarandë për periudhën 01.08.2018 deri më 31.12.2021, konstatohet se nuk është ngritur struktura e Këshillit Administrativ si një nga strukturat që drejton dhe jep mendime për mirëfunksionimin e aktivitetit spitalor.
Kriteri:	Ligji nr. 9106, datë 17.7.2003, "Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë" neni 12, dhe Rregullorja e funksionimit të institucionit, nenet 5 dhe 6.
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e Këshillit të Administrimit sjell mangësi në proceset e menaxhimit të Spitalit.
Shkaku:	Mos zbatim i dispozitave ligjore.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandim:	Drejtori i Spitalit Sarandë, të marrë masa dhe të propozojë në MSHÇS për ngritjen e strukturës drejtuese të Këshillit Administrativ, me qëllim përmirësimin, organizimin, financimin, funksionimin dhe kontrollin e veprimtarisë së shërbimit spitalor dhe rritjen e nivelit të shërbimit.

Titulli i gjetjes:	Mangësi në rregulloren e institucionit.

Situata:	Rregullorja e Brendshme e funskionimit të Institucionit nuk është e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrotjes Sociale, megjithëse është hartuar nuk është miratuar me Urdhër të Drejtorit të Spitalit Bashkiak Sarandë z.T. L. Nga shqyrtimi i librit të protokollit për vitin 2018, rezulton se me nr.246 prot., datë 20.02.2018 është dërguar shkresa për miratimin e Rregullores së Brendshme në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, por mungon kopja e shkresës përcjellëse dhe deri në datën e mbajtjes së këtij akt konstatimi nuk është kthyer përgjigje për miratimin ose jo të kësaj Rregullore e cila daton prej vitit 2018.
Kriteri:	Ligji nr. 9106, datë 17.7.2003, "Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë" Kreu III, neni 23.
Ndikimi/Efekti:	Nuk ka forcë ligjore
Shkaku:	Neglizhencë nga strukturat drejtuese
Rëndësia:	E mesme
Rekomandim:	Drejtoria e Spitalit Sarandë të marrë masa për plotësimin e kuadrit ligjor të institucionit, miratimin e rregullores së re dhe statutit duke e përshtatur dhe në koherencë me ndryshimet në strukturë dhe legjislacion, me qëllim monitorimin tekniko-administrativ, duke evidentuar problematika, përgjegjësi dhe rekomandime me afate konkrete brenda kompetencave të përshkruara në Rregulloren dhe statutin e Spitalit.

Për sa më lart ngarkohen me përgjegjësi: z.T. L, z.E. Dh dhe z.A. K.

2.2. Mbi planifikimin dhe zbatimin e buxhetit, si edhe shpenzimet administrative.

Për procedurat e ndjekura mbi zbatimin e kritereve në hartimin dhe zbatimin e buxhetit sipas ligjeve dhe udhëzimeve të Ministrisë së Financave, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
-Statuti i Spitalit Sarandë
-Rregullorja e brendshme e Spitalit Sarandë
-Akte të tjera ligjore dhe nënligjore që rregullojnë veprimtarinë e institucionit
-Dokumentacioni i PBA-ve të miratuara nga Spitali gjatë periudhës objekt auditimi
-Buxheti i miratuar dhe ndryshimet e kryera gjatë vitit
-Realizimi i shpenzimeve me planifikimet

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:

Financimi i Spitalit Sarandë (SSr) kryhet nga Fondi i Sigurimit të Detyrueshëm i Kujdesit Shëndetësor për shpenzimet për paga, sigurime, mallra e shërbime dhe për shpenzimet për investime nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.
Duke qenë se në **SSr**, nuk është i ngritur Këshilli Administrativ, i cili është organi më i lartë i administrimit, hartimi i projekt buxhetit është përgatitur nga drejtoria e institucionit duke i'u përcjellë MSHMS për miratim. Specialistët përkatës sipas detyrave dhe sektorëve që mbulojnë, ne baze te detyrave të përcaktuara në rregulloren e brendëshme të institucionit, kanë hartuar propozimet në sasi e vlerë të zërave të PBA.

Për vitin 2018

Ne zbatim të shkresës së MSHMS Nr 2855 prot,datë 07.06.2017 "***Procedura e hartimit te Projekt Buxhetit per vitit 2018 – 2020***", eshte organizuar puna per hartimin e propozimeve në sasi e vlerë të zërave të Projekt-Buxhetit për vitin 2018.
Me shkresën nr. 624 Prot., date 18.07.2017, është dërguar për miratim në FSDKSH - Vlore per propozimet per Projekt Buxhetin e periudhes 2018 - 2020 per artikujt 600, 601,602 dhe me

shkresen Nr 612 prot, date 14.07.2017 është dërguar për miratim në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, PBA për vitet 2018-2020 per shpezimet per investime - art. 230-231. Më datë 30.01.2018, me shkresën nr. 282 Prot,date 30.01.2018, është marrë aprovimi nga FSDKSH (*per shpenzimet per pagat, sigurimet shoqerore dhe shpenzimet per mallra e sherbime*) dhe me shkresën Nr 201/3 prot, date 15.02.2018 është derguar nga MSHMS buxheti i vitit 2018 për shpenzimet kapitale (art. 230-231) .
Me shkresen Nr 20407/1 prot, date 15.11.2018 te MSHMS, "***Transferim fondesh për vitin 2018***" dergon shtese fondesh financiare te art. 602 ne vleren **11,550,000** lekë.

Zërat e buxhetit të akorduar dhe realizimin për periudhën 2018.

Emërtimi Buxhetit	Buxheti fillim viti 2018	Kërkesa 2018	Shtesa 2018	Pakësime 2018	Buxheti 31.12.2018	Realizimi 2018	%
600 paga (buxhet)	132,800	145,125		889	131,911	130,331	99%
601sig.shoq shëndetësore	21,600	23,082		100	21,500	21,271	99%
606 (përdorim f.veçântë)	289	289			289	289	100%
602 (buxhet)	95,000	139,452	11,550		106,550	106,392	99.8%
231 (buxhet)	151,284	247,458			151,285	149,784	99%
Shuma buxhet	**400,973**	**555,117**	**11,550**	**989**	**411,535**	**408,067**	99%
600 paga (te ardhurat)	4,570		2,807		7,377	3,295	45%
602 (te ardhurat)	569		3,742		4,311	2,668	62%
231 (te ardhurat)	4,206		2,806		7,012	6,520	93%
Shuma e të ardhurave	**9,345**		**9,355**		**18,700**	**12,483**	**66.75%**
Shuma gjithsej	**410,318**	**555,117**	**20,905**	**989**	**430,235**	**420,550**	**97.75%**

Burimi:Spitali Sarandë

Buxheti i planifikuar për shpenzime per pagat, sigurimet shoqërore dhe shpenzime per mallra e sherbime (*me gjithë shtesat dhe pakesimet*), në total për vitin 2018 eshte planifikuar **430,235,000** lekë përfshirë edhe pjesen e te ardhurave te planifikuara per perdorim.
Në pjesën më të madhe buxheti është realizuar në masen 99 % të fondit te planifikuar, me përjashtim të fondit të pagave nga të ardhurat dytësore realizuar në masën 45%.

Në vitin 2018 nga buxheti i akorduar në art. 602 prej 95,000,000 lekë, eshte kerkuar nga MSHMS përdorimi i vlerës 28,000,000 leke per financimin e detyrimeve qe rrjedhin nga Vendime Gjyqësore të formës së prerë, keshtu që buxheti per shpenzime te pergjitheshme (*mallra dhe shërbime*) të pakësohet në 67,000,000 lekë. Ky buxhet ka qenë i pamjaftueshëm për përballimin e nevojave te institucionit gjatë vitit 2018, me gjithë shtesën e alokuar ne muajin nëntor të këtij viti në vlere 11,550,000 leke. Përdorimi i këtij fondi dhe dhënia prioritet për likuidimin e vendimeve gjyqësore bie në kundërshtim me Udhëzimin e KM nr. 1, datë 04.06.2014 "Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të njësive të qeverisjes së përgjithshme në llogari të thesarit".
Për nevojën e alokimit te fondeve shtese ne art. 602, institucioni i eshte drejtuar MSHMS me shkresat:
Nr 335 prot , date 12.03.2018, Nr 770 prot, date 19.07.2018 , Nr 1072 prot, date 05.11.2018 dhe Nr. 1196 prot, date 15.12.2018.
Si dhe FSDKSH-se me shkrese Nr 578 prot, date 18.05.2018.
Në SSr janë mbajtur në mënyrë të përmuajshme situacionet të konfirmuara nga thesari për shpenzimet dhe për të ardhurat.

Emertimi i projektit	Plan 2018	Fakti 2018	% realizimi
Ndertim i martenitetit te ri,dhe shtese dy kate per sherbimin e kirurgjise dhe patologjise ne Spitalin e Sarandes	53,174	52,024	98%

Kolaudimi dhe ndertimi i martenitetit te ri ,dhe shtese 2 kate per sherbimin e kirurgjise dhe patologjise ne Spitalin Sarande	912	883	97%
Kolaudimi dhe ndertimi i martenitetit te ri ,dhe shtese 2 kate per sherbimin e kirurgjise dhe patologjise ne Spitalin Sarande	228	181	79%
Ndertim i martenitetit te ri,dhe shtese dy kate per sherbimin e kirurgjise dhe patologjise ne Spitalin e Sarandes	41,233	41,233	100%
Supervizion per ndertimin e martenitetit te ri dhe shtese 2 kate per sherbimin e kirurgjise dhe patologjise ne Spitalin Sarande,Shtese kontrate	571	343	60%
Kolaudimi dhe ndertimi i martenitetit te ri ,dhe shtese 2 kate per sherbimin e kirurgjise dhe patologjise ne Spitalin Sarande	46	0	%
Furnizim pajisje mjekesore dhe hotelerie per kirurgjine e re dhe patologjine e Spitalit sarande	55,120	55,120	100%
Totali	**151,284**	**149,784**	**99%**

Burimi:Spitali Sarandë

Sipas tabelës së mësipërme realizimi i investimeve paraqitet në nivelin 99%.
Pamjaftueshmeria e fondeve për financimin e detyrimeve te institucionit ne art. 602, nje nga shkaqet kryesore, qe ne fund te vitit 2018, detyrimet e pashlyera të spitalit ndaj furnitoreve dhe te tretëve të arrijnë ne vlerën **24,373,341 leke**, detyrim i cili është mbartur për vitin 2019. Kjo ka ndodhur edhe për faktin se nga buxheti i akorduar për vitin 2018 art. 602 - shpenzime për mallra dhe shërbime 26,500,000 lekë janë përdorur per financimin e detyrimeve qe rrjedhin nga Vendimet Gjyqesore te formës së prerë.

-Krahas financimit nga Buxheti i Akorduar nga FSDKSH, nje burim tjeter financimi i Spitalit Sarande eshte edhe nga të **ardhurat dytësore** të realizuara nga vete institucioni ose nga dhurime te ndryshme.
Për vitin 2018 realizimi (*prodhimi*) i të ardhurave dytësore nga institucioni dhe qe mund te perdoren prej tij, janë në vlerën **9,277,900** leke

TE ARDHURAT E REALIZUARA PER VITIN 2018

1	7111004	TE ARDHURA NGA SHERBIMI SPITALOR	**9,277,900**
2	7111007	TE ARDHURA NGA PARKIMI	77,100
3	7115499	NDALESAT E PAGAVE GJOBAT	1,064,685
		TOTALI	**10,419,685**

Shuma totale e te ardhurave te trasheguara nga viti 2017 si dhe realizimi ne vitin 2018 paraqitet ne tabelen e "***Prodhimit dhe përdorimit te te ardhurave dytësore te vitit 2018***".

Prodhimi dhe Përdorimi i te ardhurave viti 2018

Nr	EMERTIMI	600	231	602	Total
1	Te ardhura mbetur pa perdorur nga nje vit me pare (nga viti 2017)	4,570,694	4,206,253	569,106	9,346,053
2	Te ardhura te vitit 2018	2,806,500	2,806,500	3,591,533	9,355,000
3	Totali te ardhura per t'u perdorur	7,377,194	7,012,753	4,160,639	18,701,053
4	*Te ardhura te perdorura ne vitin 2018*	*3,294,975*	*6,520,611*	*2,668,053*	*12,483,639*
5	Mbetur per t'u perdorur ne vitin 2019	4,082,219	492,142	1,492,586	6,217,414

Perdorimi i te ardhurave te realizuara ne vitin 2018 si dhe ato te trasheguara nga viti 2017 jane ne vleren 12,483,639 leke.

Për vitin 2019

Për vitin 2019, FSDKSH, me shkresën nr. 227/2 Prot, datë 15.02.2019, ka njoftuar **Spitalin Sarandë** për çeljen buxhetit vjetor, të detajuar per vitin 2019. Ky buxhet është miratuar me VKM nr.46, datë 30.01.2019, "***Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2019***". Vlera totale e

buxhetit të miratuar bashkë me shtesat dhe pakësimet e bëra gjate vitit 2019, është **283,859,000** lekë, përfshirë edhe të ardhurat dytësore të planifikuara për përdorim.

Të dhëna për zërat e buxhetit të akorduar dhe realizimin për vitin 2019.

Emërtimi Buxhetit	Realizimi 2018	Buxhet fillim viti 2019	Kerkesea 2019	Shtesa 2019	Buxheti 31.12.2019	Realizimi 2019	%
600 paga (buxhet)	130,331	132,200	145,125	3,600	135,800	134,646	99%
601sig.shoq shëndetësore	21,270	22,000	23,082	640	22,640	21,497	95%
606 (përdorim f.veçântë)	53,550	335	12		335	291	87%
602 (buxhet)	106,392	95,000	145,452	14,500	109,500	109,489	99.9%
231 (buxhet)	149,784		51,300				
Shuma buxhet	**461,327**	**249,535**	**364,971**	**18,740**	**268,275**	**265,923**	
600 paga (te ardhurat)	3,295	4,082		2,810	6,892	1,850	27%
602 (te ardhurat)	2,668	1,643	6,000	3,747	5,390	178	3.3%
231 (te ardhurat)	6,520	492		2,810	3,302	3,073	93%
Shuma e të ardhurave	**12,483**	**6,217**		**9,367**	**15,584**	**5,101**	**32.7%**
Shuma gjithsej	**473,810**	**255,752**		**28,107**	**283,859**	**271,024**	**95%**

Për periudhën 2019, ne zërin art. 231, nga MSHMS nuk jane akorduar fonde investimesh por nga ana e SSr eshte kerkuar nje fond ne vleren 51,300,000 leke ne PBA 2019-2021.
Në zërin 600 "*paga*" nga të ardhurat e veta, janë realizuar në masën 27 % për arsye të gjykimit të drejtimit te institucionit. Përdorimi i të ardhurave dytësore të institucionit paraqitet në nivelin 32.7%. Nga auditimi i formateve të plotësuar të projektbuxhetit rezultoi se janë plotësuar nevojat konform formateve të miratuar dhe brenda afateve të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe janë dërguar pranë MSHMS - dhe FSDKSH - se.
Mbështetur ne udhëzimin e MSHMS, dërguar me shkresen nr 2409/3 prot, datë 17.05.2018 - "*Procedurat per hartimin e Projekt Buxhetit per vitin 2019-2021*", drejtoria e institucionit ka hartuar treguesit e Projekt Buxhetit me kërkesat për fonde buxhetore për plotësimin e nevojave te sherbimit per shpenzime per paga,sigurime shoqerore e shendetesore, per shpenzime per mallra e sherbime te ndryshme dhe per investime kapitale.
Me shkresën nr. 724 prot, datë 03.07.2018, janë dërguar ne MSHMS propozimet e SSr për fonde buxhetore per vitin 2019 per paga, sigurime shoqerore dhe per mallra e sherbime te ndryshme. Me shkrese Nr 725 prot, date 03.07.2018 eshte derguar per aprovim prane MSHMS projektimet e institucionit per fonde te investime per vitin 2019.
Po kështu, me shkresën nr. 734 prot, date 05.07. 2018 eshte derguar prane FSDKSH - Vlore , nevojat e SSr për fonde per art. 600,601 - paga dhe sigurime shoqerore e shendetesore si dhe per art. 602 - shpenzime per mallra e sherbime per vitin 2019.
Ne Spitalin Sarande janë mbajtur në mënyrë të përmuajshme situacionet të konfirmuara nga thesari për shpenzimet e kryera dhe për të ardhurat e realizuara dhe të perdorura gjate periudhes ushtrimore.
Krahas financimit nga Buxheti i akorduar nga FSDKSH, nje burim tjeter financimi i **SSr** eshte edhe nga te ardhurat dytesore te realizuara nga vete institucioni ose nga dhurime te ndryshme. Per vitin 2019 realizimi (krijimi) i te ardhurave dytesore nga institucioni dhe qe mund te perdoren prej tij, jane ne vleren **9,367,200** leke

TE ARDHURAT E REALIZUARA PER PERIUDHEN DHJETOR 2019

1	7111004	TE ARDHURA NGA SHERBIMI SPITALOR	8,766,050
2	7111007	TE ARDHURA NGA PARKIMI	601,150

		TOTALI	**9,367,200**

Prodhimi dhe Përdorimi i te ardhurave viti 2019

ne leke

Nr.	EMERTIMI	600	231	602	Total
1	Te ardhura mbetur pa perdorur nga nje vit me pare	4,082,219	492,142	1,643,053	6,217,414
2	Te ardhura te vitit 2019	2,810,160	2,810,160	3,746,880	9,367,200
3	Totali te ardhura per t'u perdorur	6,892,379	3,302,302	5,389,933	15,584,614
4	*Te ardhura te perdorura ne vitin 2021*	*1,850,445*	*3,073,063*	*178,080*	*5,101,588*
5	Mbetur per t'u perdorur ne vitin 2022	5,041,934	229,239	5,211,853	10,483,026

Pra, nga totali i te ardhurave dytësore te realizuara ne vitin 2019 jane perdorur per shpenzime per paga e sigurime shoqerore 1,850,444 leke, per shpenzime mallra e sherbime 178,080 leke dhe per investime art. 231 jane perdorur 3,073,063 leke.
Siç vërehet edhe nga pasqyra e mesiperme, ne fund te vitit 2019 jane krijuar detyrime te pashlyera ndaj furnitoreve dhe te treteve ne vlerën **34,065,636** leke, detyrim qe trashëgohet per tu financuar gjate vitit 2020. Këto deyrime jane të trashëguara qysh nga viti 2018 dhe pjesa tjetër gjatë vitit 2019 si rezultat i buxhetit të pamjaftueshëm.

Për vitin 2020

Zërat e buxhetit të akorduar dhe realizimin për vitin 2020.

Emërtimi Buxhetit	Realizimi 2019	Buxhet fillim viti 2020	Kerkesa 2020	Shtesa 2020	Pakësime 2020	Buxheti 31.12.2020	Realizimi 2020	%
600 paga (buxhet)	134,646	137,900		3,876	600	141,176	141,175	99.9%
601sig.shoq shëndetësore	21,497	23,000			1,275	21,725	21,563	99.3%
606 (përdorim f.veçântë)	291	607				607	607	100%
602 (buxhet)	109,489	95,000		10,000		105,000	105,000	100%
231 (buxhet)						0		
Shuma buxhet	**265,923**	**256,507**		**13,876**	**1,875**	**268,508**	**268,345**	
600 paga (te ardhurat)	1,850	4,911		2,805		7,716	1,759	22.8%
602 (te ardhurat)	178	5,038		3,741		8,779	417	5%
231 (te ardhurat)	3,073	533		2,805		3,338	1,116	33%
Shuma e të ardhurave	**5,101**	**10,482**		**9,351**		**19,833**	**3,292**	**16.6%**
Shuma gjithsej	**271,024**	**266,989**		**23,227**	**1,875**	**288,341**	**271,637**	**94%**

Për vitin 2020, FSDKSH, me shkresën nr. 216 Prot, datë 03.02.2020, ka njoftuar SSr, për çeljen buxhetit vjetor, të detajuar ne strukture : art. 600 - **137,900,000** leke, art. 601- **23,000,000** leke, art. 602 - **95,000,000** leke dhe ne total **255,900,000** leke. Ky buxhet është miratuar me VKM nr.42, datë 22.01.2020, "*Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2020*".
Gjithashtu me shkresën nr. 1798 Prot., datë 27.02.2019, FSDKSH, ka akorduar fondin shtesë për art. 602 - mallra e shërbime në vlerën 2,000,000 lekë.
Po me shkresen nr 8123/6 prot, date 16.11.2020 nga FSDKSH , ka derguar ndryshim buxheti ; art. 600 - pakësim **600,000 leke**, art. 601 pakësim **1,275,000** leke dhe art. 600 shtese **8,000,000** leke.

Në zbatim të shkresës nr. 3139 prot, date 10.06.2019 "*Procedurat per hartimin e Projekt Buxhetit afatmesem 2020-2022"*, dërguar nga MSHMS, janë llogaritur treguesit sasior dhe financiar të nevojave te institucionit per fonde buxhetore per parballimin e nevojave te sherbimit per periudhen.
Me shkresen nr 826 prot, date 10.07.2019, janë derguar per miratim ne MSHMS dhe prane FSDKSH-se, propozimet e institucionit per akordimin e fondeve buxhetore per shpenzimet per pagat, sigurimet shoqerore, mallra e sherbime dhe shpenzime kapitale art. 230-231. Pasqyrat e planifikimit te nevojave të projektbuxhetit 2020-2022, janë plotësuar konform formateve të miratuar dhe brenda afateve të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe jane derguar prane MSHMS dhe FSDKSH.
Ne institucion janë përpiluar çdo muaj në mënyrë progresive situacionet financiare të konfirmuara nga thesari për shpenzimet e kryera dhe per te ardhurat dytesore te realizuara dhe te perdorura gjate periudhes ushtrimore.
Krahas financimit nga Buxheti i alokuar nga FSDKSH, nje burim tjeter financimi i SSr eshte edhe nga te ardhurat dytesore te realizuara nga vete institucioni ose nga dhurime te ndryshme. Per vitin 2020 realizimi (krijimi) i te ardhurave dytesore nga institucioni dhe qe mund te perdoren prej tij , jane ne vleren **9,352,550** leke.

TE ARDHURAT E REALIZUARA PER VITIN 2020

1	7111004	TE ARDHURA NGA SHERBIMI SPITALOR	8,584,100
2	7111007	TE ARDHURA NGA PARKIMI	768,450
3	7115499	NDALESAT E PAGAVE **GJOBAT**	25,327
		TOTALI	**9,377,877**

Prodhimi dhe Perdorimi i te ardhurave

Nr.	EMERTIMI	600	231	602	Total
1	Te ardhura pa perdorur nga (viti 2019)	4,911,433	533,740	5,037,853	10,483,026
2	Te ardhura te vitit 2020	2,805,765	2,805,765	3,741,020	9,352,550
3	Totali te ardhura per t'u perdorur	7,717,198	3,339,505	8,778,873	19,835,576
4	Te ardhura te perdorura ne vitin 2020	1,758,640	1,116,025	762,960	3,637,625
5	Mbetur per t'u perdorur ne vitin 2021	5,958,558	2,223,480	8,361,393	16,543,431

Në fund te vitit 2020 detyrimet e pashlyera ndaj furnitoreve dhe te treteve janë në vleren **35,077,639** leke, detyrim qe trashegohet per tu financuar gjate vitit 2021, keto deyrime jane nje pjese te trasheguara nga viti 2019, dhe pjesa tjeter te krijuara gjate vitit 2020 si rezultat i buxhetit te pamjftueshem, i tejkalimit te konsumit te disa mallrave të domosdoshme mbi sasinë e planifikuar (oksigjen, energji elektrike etj).
Spitali Sarandë lidhur me pamjaftueshmerine e buxhetit te alokur per vitin 2020, ka kerkuar vazhdimisht rishikimin e tij nga MSHMS dhe FSDKSH me shkresat:
-Shkresa Nr 236 prot, date 12.02.2020 "Dërgohet kerkese per rishikim te buxhetit te vitit 2020 art. 602.
-Shkresa Nr 985 prot, date 14.08.2020 "Kërkohen fonde perinvestimeart. 231, rikonstruksioni pjesor i sistemit te gaazrave mjekesorene spitalin sarande ne kushtet e masave kunder Covid-19-emergjente "
-Shkresa Nr 999prot, date 17.08.2020 "Dërgohet kerkese per alokim fonde shtese ".
-Shkresa Nr 1080 prot, date 04.09.2020 "Dërgohet kerkese per fonde shtese art, 602 per vitin 2020" kerkohen 32,000,000 leke shtese.
-Shkresa Nr 1080 prot, date 04.09.2020 "Dërgohet kerkese per fonde shtese art, 602 per vitin 2020".

-Shkresa Nr 1090 prot, date 10.11.2020 "Dërgohet kerkese per fonde shtese art, 602 per vitin 2020", Kërkohen 46,000,000 lekë shtesë.

Zërat e buxhetit të akorduar dhe realizimin për vitin 2021.

Emërtimi Buxhetit	Realizimi 2020	Buxhet fillim viti 2021	Kerkesa 2021	Shtesa 2021	Pakesime 2021	Buxheti 31.12.2021	Realizimi 2021	%
600 paga (buxhet)	141,000	147,000	147,019	34,019	3,000	178,019	177,514	99.7%
601sig.shoq shëndetësore	21,563	22,200	23,419	4,600	1,900	24,900	24,798	99.6%
606 (përdorim f.veçântë)	607	131				131	131	100%
602 (buxhet)	105,000	100,000	120,921	52,443		152,443	152,443	100%
231 (buxhet)					0	0		
Shuma buxhet	**268,170**	**269,331**	**291,359**	**91,062**	**4,900**	**355,493**	**354,886**	
600 paga (te ardhurat)	1,759	5,776		2,693		8,469	1,328	16%
602 (te ardhurat)	417	4,741		3,591		8,332		
231 (te ardhurat)	1,116	6,027		2,693		8,720	5,851	67%
Shuma e të ardhurave	**3,292**	**16,544**	**0**	**8,977**	**0**	**25,521**	**7,179**	**28%**
Shuma gjithsej	**271,462**	**285,875**	**291,359**	**100,039**	**4,900**	**381,014**	**362,065**	**95%**

Për vitin 2021, FSDKSH, me shkresën nr. 331 Prot, datë 03.02.2021, ka njoftuar **spitalin Sarande**, për çeljen buxhetit vjetor, të detajuar ne strukture : art. 600 – **147,000,000** leke, art. 601- **22,200,000** leke, art. 602 - **100,000,000** leke dhe ne total **269,200,000** leke. Ky buxhet është miratuar me VKM nr.20, datë 20.01.2021, "*Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2021*".

Gjithashtu me shkresën nr. 2922/12 Prot., datë 26.05.2021, FSDKSH, ka akorduar fondin shtesë për art. 602 – mallra e shërbime në vlerën **6,443,000** lekë "*për përballimin e shërbimit të PPP të laboratorëve*".

Po me shkresen nr 489 prot, date 12.04.2021 – FSDKSH-ja , ka derguar ndryshim buxheti; art. 600 - shtesë **29,200,000** leke.

Ne zbatim të shkreses Nr 2880 prot, date 17.06.2020 "*Procedurat e hartimit te Projekt Buxhetit per vitin 2021 – 2023"*, derguar nga MSHMS, eshte organizuar pune per llogaritjen e treguesve sasior dhe financiar te nevojave te institucionit per fonde buxhetore per përballimin e nevojave te shërbimit per periudhen qe planifikohet.

Me shkresen Nr 862 prot, date 07.07.2020 "*Dergohet Projekt Buxheti viti 2021-2023*,MSHMS, FSDKSH - Vlore dhe DROSHKSH –Vlore.

Pasqyrat e planifikimit te nevojave të projektbuxhetit 2021-2023, janë plotësuar konform formateve të miratuar dhe brenda afateve të përcaktuar në udhëzimin e Ministrisë së Financave dhe jane derguar prane MSHMS dhe FSDKSH.

Ne institucion jane perpiluar çdo muaj dhe progresivisht situacionet financiare të konfirmuara nga thesari për shpenzimet e kryera dhe per te ardhurat dytesore te realizuara dhe te përdorura gjate periudhes ushtrimore.

TE ARDHURAT E REALIZUARA PER VITIN 2021

1	7111004	TE ARDHURA NGA SHERBIMI SPITALOR	8,977,532
2	7111007	TE ARDHURA NGA PARKIMI	1,300
		Totali	**8,978,832**

Prodhimi dhe Perdorimi i te ardhurave viti 2021

Nr	EMERTIMI	600	231	602	Total
1	Te ardhura mbetur pa perdorur nga nje vit me pare (nga viti 2020)	5,775,867	6,026,685	4,740,879	16,543,431

2	Te ardhura te vitit 2021	2,693,650	2,693,650	3,591,533	8,978,832
3	Totali te ardhura per t'u perdorur	8,469,517	8,720,335	8,332,412	25,522,263
4	Te ardhura te perdorura ne vitin 2021	1,328,276	5,850,725	-	7,179,001
5	Mbetur per t'u perdorur ne vitin 2022	7,141,241	2,869,610	8,332,412	18,343,262

Në fund te vitit 2021 detyrimet e pashlyera ndaj furnitoreve dhe të treteve janë në vleren **18,534,991** leke, detyrim qe trashegohet per tu financuar gjate viti 2022. Keto deyrime jane nje pjese te trasheguara nga viti 2020, dhe pjesa tjeter te krijuara gjate vitit 2021 si rezultat i buxhetit te pamjaftueshëm dhe nga tejkalimi i konsumit të disa mallrave mbi sasinë e planifikuar (oksigjen, energji elektrike etj).
Edhe gjate vitit 2021, Spitali Sarandë lidhur me pamjaftueshmerine e buxhetit te alokuar per vitin 2021, ka kerkuar vazhdimisht rishikimin e tij nga ana e MSHMS dhe FSDKSH me shkresat:
-Shkresa Nr 45 prot, date 13.01.2021 "Dërgohet kërkesë për fonde shtesë art, 602 për shlyerjen e detyrimeve te prapambetura te vitit 2020", kerkohen 32,700,.000 leke shtese.
-Shkresa Nr 524 prot, date 09.04.2021"Dërgohet kerkese per fonde shtese art, 602 per shlyerjen e detyrimeve te prapambetura te vitit 2020", kërkohen 44,025,666 lekë shtesë.

Referuar realizimit të buxhetit për vitet 2018-2021, konstatohet se nga Spitali Sarandë përveç pamjaftueshmërisë së fondeve dhe mosplotësimit të kërkesave në rritje për shtesë fondesh rezultojnë edhe tejkalime tej parashikimit në mallra të ndryshëm, zëra për të cilët nuk është treguar vemendje prioritare që në planifikimin e viteve të ardhshëm të bazohen në arritjet e një viti më parë si edhe në pritshmëritë referuar sëmundjeve dhe epidemive në qarkullim, duke rritur kërkesat për artikujt të cilët rezultojnë me tejkalim dhe minimizimin e shpenzimeve të tjera me qëllim uljen e detyrimeve të papaguara të cilat deri në vitin 2021 kanë qenë në nivel të lartë.

Titulli i Gjetjes	Mos argumentim dhe mos mbajtje e gjurmës së auditimit për planifikimin e nevojave për barna.
Situata:	Referuar realizimit të buxhetit për vitet 2018-2021, konstatohet se nga Spitali Sarandë përveç pamjaftueshmërisë së fondeve dhe mosplotësimit të kërkesave në rritje për shtesë fondesh rezultojnë edhe tejkalime tej parashikimit në mallra të ndryshëm, zëra për të cilët nuk është treguar vemendje prioritare që në planifikimin e viteve të ardhshëm të bazohen në arritjet e një viti më parë si edhe në pritshmëritë referuar sëmundjeve dhe epidemive në qarkullim, duke rritur kërkesat për artikujt të cilët rezultojnë me tejkalim dhe minimizimin e shpenzimeve të tjera me qëllim uljen e detyrimeve të papaguara të cilat deri në vitin 2021 kanë qenë në nivel të lartë. Nga auditimi ka rezultuar se, për planifikimin e nevojave vjetore për barna dhe materiale mjekësore nga Shërbimet mjekësore, gjatë hartimit të projektbuxhetit dhe planit buxhetor (pas miratimit), nuk bëhet analizë mbi gjendjen e ilaçeve, sasinë e konsumit të tyre vjetore, në mënyrë që të justifikojnë dhe argumentojnë listën për nevojat e këtyre barnave. Rritja e sasive të barnave të porositura nuk është e shoqëruar me relacione shpjeguese dhe argumentuese për justifikimin e sasive shtesë.
Kriteri:	Ligji nr. 10 296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Neni 4, pika 19 dhe neni 16, *ku citohet: "Gjurma e auditimit" përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur*

	me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimin, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve. Neni 16 Detyrimi për përgatitjen dhe dokumentimin e gjurmës së auditimit, 1. Ministri i Financave është përgjegjës për miratimin e gjurmëve standarde të auditimit, që lidhen me procedurat e unifikuara për të gjitha njësitë e sektorit publik. 2. Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. 3. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi. Udhëzimi nr. 7, "Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA" datë 28.02.2018, pika 6. Metodologjia e përcaktimit të politikave ekzistuese dhe politikave të reja ku citohet: *Mallrat dhe shërbimet (602).Gjatë përgatitjes së kostos për vitin bazë për blerjen e mallrave dhe shërbimeve, NJQQ duhet të udhëhiqen nga parimet e mëposhtme: Analizimi i informacionit rreth shpenzimeve për aktivitetet aktuale dhe punën për mirëmbajtjen të dy deri në tre vitet e fundit; -Analizimi i dinamikës për të vlerësuar kostot e nevojshme për të ruajtur sasinë dhe cilësinë gjatë vitit të ardhshëm buxhetor.- Të dhënat historike mund të ndryshojnë nga njëri viti në tjetrin për shkak të përfundimit të projekteve, fillimit të disa shërbimeve të reja, ndryshimeve dhe iniciativave të tjera. Kjo, për shembull, i referohet përshtatjes së shpenzimeve operative dhe të mirëmbajtjes për investimet e përfunduara në ciklet e ardhshme të buxhetit; -Gjatë përgatitjes së parashikimeve për këto zëra, kërkohet informacion për koston për njësi, parametra të çmimit të vendosur nga ministria përgjegjëse për financat, si dhe parametra të përfitimeve nga efiçenca.*
Ndikimi/Efekti:	Mos argumentimi i nevojave sjell rriskun e krijimit të barnave stok dhe kalimin e afatit të skadencës.
Shkaku:	Mos vlerësim sa dhe si duhet nga organet drejtuese.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandim:	Strukturat drejtuese në vazhdimësi të marrin masa për ndjekjen e procedurave të hartimit të PBA, duke siguruar që planifikimet të kryhen mbështetur në analiza të dinamikës të vlerësimit të kostove të nevojshme për ruajtjen e sasisë dhe cilësisë të shërbimeve të ofruara, vlerësimin e të dhënave historike të shpenzimeve, kostove për njësi, si edhe në pritshmëritë referuar sëmundjeve dhe epidemive në qarkullim, duke rritur kërkesat për artikujt të cilët rezultojnë me tejkalim dhe minimizimin e shpenzimeve të tjera me qëllim uljen e detyrimeve të papaguara të cilat deri në vitin 2021 kanë qenë në nivel të lartë.

Përsa më sipër ngarkohen me përgjegjësi: z. F. S me detyrë zv/drejtor ekonomik, z. E. Dh, ish drejtor i SSr, T. L, ish drejtor dhe z.F. Ll, ish zv/drejtor ekonomik.

2.3. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore për strukturën organizative, marrëdhëniet e punës dhe pagave.

Për zbatimin e strukturës organizative, pagave dhe rekrutimeve, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

-Rregullore e brendshme e funksionimit të shoqërisë.

-Dokumentacioni mbi rekrutimin e punonjësve.
-Vendimet e drejtorisë mbi përcaktimin e strukturës, pagave, etj.
-Listë pagesat e pagave dhe llogaritjet për kontributetet e sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore.
-Dosje personeli, etj.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:

Struktura organizative e planifikuar për vitin 2018, shkresa me Nr.1367/1 datë 15.03.2017 ka të planifikuar 197 punonjes, nga të cilët 128 personel mjekesor dhe 69 personel mbështetës. Struktura organizative me siper ka pësuar ndryshime të pjesëshme si pasojë e nevojave të Shërbimit Spitalor, përkatësisht shkresa me Nr.3332/1 datë 01.06.2018, është pakësuar pozicioni "Teknik" me 1 punonjës dhe është shtuar pozicioni "Specialist Jurist" me një punonjës, si dhe me shkresën Nr.5721/2 prot, datë 14.12.2018, është pakësuar pozicioni "Oksigjenist" me 1 punonjës dhe është shtuar pozicioni "Specialist Ekonomist" me 1 punonjës. Gjatë vitit 2019 dhe vitit 2020 Drejtoria e Shërbimit Spitalor Sarandë ka funksionuar me të njëjtën Strukturë Organizative, të cituar më sipër.
Struktura organizative e vitit 2019 është 197 punonjës 128 personel mjekësor dhe 69 personel mbështetës.
Struktura organizative e vitit 2020 ka të planifikuar 197 punonjës,ndër të cilët 128 personel mjekësor dhe 69 personel mbështetës.
Struktura organizative e vitit 2021 ka të planifikuar 197 punonjës,ndër të cilët 125 personel mjekësor dhe 72 personel mbështetës.
Për periudhën objekt auditimi numri i punonjësve referuar evidencave të sektorit të Personelit, paraqitet si më poshtë:

Vitet	Numri i punonjësve i miratuar	Realizuar
2018	197	196
2019	197	192
2020	197	192
2021	197	197

Sipas tabelës së mësipërme rezulton se nuk ka tejkalim të numrit të punonjësve nga numri i miratuar sipas strukturës, për çdo sektor dhe administratën duke përfshirë edhe shtesat për turne, kategori, vështirësi, etj.
Referuar numrit të punonjësve të miratuar konstatohet se është respektuar numri i punonjësve në fakt krahasuar me numrin e punonjësve të miratuar.

Gjatë periudhës ***Gusht 2018-Dhjetor 2018***, janë realizuar 3 procedura rekrutimi për personel mbështetës.
-*Zv.Drejtor Ekonomik*, 1 punonjës -shkresa MSHMS Nr.5577/4, datë 06.12.2018.
-*Përgjegjës i sektorit të Financës*, -Procedurë Konkurimi nëpërmjet shpalljes në APP.
-*Punonjës Parkimi* -Shkresa e MSHMS Nr.100/278, datë 26.10.2018.
Gjatë periudhës Gusht 2018-Dhjetor 2018, janë realizuar edhe 4 procedura lirimi, 1 personel mjekësor dhe 3 personel mbështetës sipas kërkesës së tyre dhe 2 dalje në pension.
Gjatë periudhës ***Janar 2019-Dhjetor 2019***, janë realizuar 27 procedura rekrutimi nga të cilat 20 personel mjekësor dhe 7 personel mbështetës. Rekrutimet për personel mjekësor janë bazuar në kërkesat në rritje për mjekë dhe infermierë, nga të cilët janë rekrutuar ***1 mjek***, me shkresën e MSHMS Nr.642/1, datë 15.02.2019 "Mbi lidhjen e kontratës me bonus me mjekun Anestezist-Tranimator për shërbimet mjekësore të munguara", ***4 Specialistë*** në zbatim të kontratave individuale të shërbimit në kuadër të përfundimit të ciklit 4-vjeçar të specializimit afatgjatë, me shkresë Nr.1057/116 datë 22.02.2019,shkresë me Nr,1057/101 datë 22.02.2019,shkresë me Nr.1057/42 datë 21.02.2019,shkresë me Nr.1057/47 datë 21.02.2019, ***1 mjek i përgjithshëm*** sipas shpalljes në Buletinin Nr.15 dstë 15.04.2019 të APP,në zbatim të

urdhërit Nr.511 datë 13.12.2011 të Ministrit të Shëndetësisë "Për Kriteret e punësimit në Shërbimin shëndetësor Publik", ***12 infermierë,*** rekrutuar sipas udhëzimit Nr.493 datë 13.11.2017 "Për miratimin e rregullores për organizimin e testimit për profesionet e shkencave mjekësore teknike për vendet vakante në Institucionet Shëndetësore Publike në RSH" , si dhe Udhëzimit nr.481, datë 27.06.2019 "Për procedurat e punësimit për profesionet e shkencave mjekësore teknike në Institucionet Shëndetëaore Publike në Republikën e Shqipërisë", V.K.M nr .419, datë 04.07.2018 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të OSHKSH", ***2 laborant*** sipas shkresës së MSHMS nr.548 prot, datë 16.04.2019 për "Emërimin e kandidatit fitues për pozicionet e shkencave mjekësore teknike", si dhe shkresës me nr. 1304 prot, datë 17.07. 2019 "Miratim për emërim personeli". Po kështu janë rekrutuar edhe 7 punonjës personel mbështetës, ***1 Drejtor,*** sipas shkresës me Nr.1266/2 prot datë 25.11.2019 të OSHKSH Drejtoria Qëndrore, ***1 Zv.Drejtor,*** sipas shkresës nr.2814/1, datë 24.05.2019 të MSHMS dhe 5 punonjës të tjerë në zbatim të Udhëzimit të Ministrit të Shëndetësisë nr.511datë 13.12.2011 "Për Kriteret e Punësimit në Shërbimin Shëndetësor Publik", sipas shpalljes në Buletinin nr.4 të datës 28.01.2019 të APP, Udhëzimit Nr.673 datë 02.10.2019 të Ministrit të Shëndetësisë dhe shkresës nr.2914/1, datë 10.12.2019 të DROSHKSH "Miratim kërkese për vazhdimin e procedurave për emërim personeli".
Gjatë këtij viti, janë realizuar edhe 25 procedura lirimi nga detyra, 19 personel mjekësor dhe 6 personel mbështetës sipas kërkesës së tyre dhe 2 dalje në pension.
Gjatë periudhës ***Janar 2020-Dhjetor 2020***, janë realizuar 13 procedura rekrutimi nga të cilat 10 personel mjekësor dhe 3 personel mbështetës. Gjatë këtij viti janë realizuar 17 procedura Lirimi nga detyra, 14 personel mjekësor dhe 3 personel mbështetës.
Gjatë periudhës ***Janar 2021-Dhjetor 2021***, janë realizuar 26 procedura rekrutimi nga të cilat 16 personel mjekësor dhe 10 personel mbështetës. Gjatë këtij viti janë realizuar 17 procedura Lirimi nga detyra, 14 personel mjekësor dhe 3 personel mbështetës. Rekrutimet për personel mjekësor janë kryer sipas V.K.M Nr .419 datë 04.07.2018 "Për krijimin, mënyrën e organizimit dhe të funksionimit të OSHKSH", si dhe Udhëzimin Nr.481 datë 27.06.2019 "Për procedurat e punësimit për profesionet e shkencave mjekësore teknike në Institucionet Shëndetëaore Publike në Republikën e Shqipërisë", nëpërmjet portalit "Infermier Per Shqipërinë". Gjatë këtij viti janë realizuar 26 procedura Lirimi nga detyra, 12 personel mjekësor dhe 14 personel mbështetës. Dosjet e personelit ishin të plotësuara me dokumentacionin e kërkuar të inventarizuara dhe të azhornuara me lëvizjet referuar urdhrave të titullarit. Janë mbajtur dhe derdhur çdo muaj kontributet për sigurime shoqërore dhe shëndetësore si edhe nga auditimi i 2/3-mujorëve të listë pagesave nuk u konstatuan mangësi.
Nga auditimi i dokumenacionit nuk u konstatuan mangësi ose shkelje të dispozitave ligjore.

2.4. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në mbajtjen e evidencës kontabël, ndjekjen e debitorëve, kreditorëve si edhe menaxhimin e aktiveve të spitalit.

Në zbatim të pikës 4 të programit të auditimit "*Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në mbajtjen e evidencës kontabile, ndjekjen e debitorëve e kreditorëve, si dhe menaxhimin e aktiveve të spitalit"* dhe konkretisht, ligjin nr.24/2018, datë 10.05.2018 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare" si dhe Udhëzimit të MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme"
4.1. *Plotësia dhe saktësia në pasqyrimin e përmbajtjes së ngjarjeve ekonomike*; Nënpika 2. Plotësia e shënimeve në pasqyrat financiare për të dhënë një pamje të përgjithshme të pozicionit financiar, performancës financiare dhe fluksit të parasë; Nënpika 3. Opinioni mbi pasqyrat financiare;

U shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:

1. Pasqyrat financiare të vitit 2021 të shoqëruar me formatet 1-9.
2.Dokumente kontabël si: ditarët e bankës, magazinës, pagave, të veprimeve të ndryshme, debitorëve, kreditorëve, furnitorëve, etj, centralizatori, bilanci vërtetues.
3. Dokumentacioni i kryerjes së inventareve të aktiveve 2021, libri i aktiveve.
4. Urdhër-shpenzimet dhe dokumentacioni bashkëlidhur për vitin 2021-5-mujori i parë 2022.
6. Akt-rakordimet me Degën e Thesarit në mbyllje të vitit buxhetor 2021.
8. Të tjera dokumente mbështetëse (databaze të ndryshme ne programet "excel"si: për vendimet gjyqësore, për investimet,per ditaret,shpenzimet te ardhurat, etj).

- ***Baza ligjore për mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare është:***

Për vitin 2021 nga njësia shpenzuese Drejtoria e Sherbimit Spitalor Sarandë për hartimin e pasqyrave financiare dhe përgatitjen e llogarive vjetore është mbështetur në ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", të ndryshuar, Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar me Udhëzimin nr.5 datë 21.02.2022.

- ***Hartimi i pasqyrave financiare të konsoliduara.***

Drejtoria e Shërbimit Spitalor Sarandë për vitin 2021 ka hartuar Pasqyrat Financiare vetëm njësinë shpenzuese Drejtoria e Shërbimit Spitalor Sarandë, pasi nuk ka në varësi njësi të tjera shpenzuese.

- ***Afatet dhe konfirmimi i pasqyrave financiare***

Pasqyrat financiare janë të firmosura nga NA dhe NZ si dhe janë të dërguara në Degën e Thesarit Sarandë për vitin ushtrimor 2021 me shkresë përcjellëse nr.prot. nr.prot.317, datë 25.03.2022. Në cilësinë e Nëpunësit Autorizues është Drejtori i Shërbimit Spitalor Sarandë dhe në cilësinë e Nëpunësit Zbatues është Përgjegjësi i Degës se Financës. Pra, në këtë rast nuk kemi delegime të këtyre detyrave.

- ***Rakordimi i pasqyrave financiare me thesarin dhe bankat e nivelit të dytë si dhe me treguesit e realizimit të buxhetit.***

Nga verifikimi për çdo muaj i ditarit të bankës i mbajtur sipas natyrës dhe sipas destinacionit rezulton të jetë i rakorduar me dokumentin e nxjerrjes së llogarisë nga thesari për çdo muaj (ekstrakt banke) për shumat për çdo llogari dhe në total mujor e vjetor dhe nuk ka diferenca.

- ***Mënyra e mbajtjes së kontabilitetit dhe dokumentacionit bazë e justifikues si dhe sigurimi i informacionit kontabël, përgatitjen e llogarive për vlerësimin e gjendjes pasurore, financiare dhe rezultatit.***

Për tu siguruar nëse, regjistrimet kontabël janë kryer në përputhshmëri ligjore dhe me saktësi u kryen testime në regjistrimet në ditarët kontabël në lidhje me:
- mbështetjen në dokumente justifikuese, të verifikuara përsa i përket vlefshmërisë për t'u pranuar në kontabilitet (vlerësimi kontabël);
- mos ndryshueshmëria e regjistrimeve tashmë të kryera dhe e mbartësve të tyre;
- tërësinë e regjistrimeve në mënyrë kronologjike dhe sistematike deri në mbyllje të të ushtrimit vjetor.

Nëse informacioni kontabël mundëson, në të gjithë ciklin e tij, kontrollin rrjedhës dhe të mëvonshëm nëpërmjet:
- shqyrtimit të vlefshmërisë së një regjistrimi fillestar duke e krahasuar me dokumentin bazë justifikues;
- kontrollit të vlefshmërisë të një regjistrimi të kryer me anë të një dokumenti duke e krahasuar këtë dokument me dokumentet bazë justifikuese mbi të cilat është përgatitur;
- verifikimit të pajtueshmërisë së shumave të nxjerra nga regjistrimet kronologjike me regjistrimet në llogari (barazimi i lëvizjeve të ditarëve me ato të librit të llogarive) dhe verifikimit të pajtueshmërive të tjera aritmetike.

- ***Pohimet e testeve të kryera rreth mbajtjes së kontabilitetit të Aparatit Bashkisë***

Si rezultat i testeve të kryera pohojmë se:

- Kontabiliteti është mbajtur i plotë për të gjitha veprimet kontabël të rezultuara nga kryerja e veprimeve ekonomike, mbi bazën e dokumentacionit bazë dhe justifikues.
- Në këtë institucion, kontabiliteti është organizuar dhe mbahet në mënyrë informatike në program "Excel"

Konkluzion: Nuk janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin.

Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë në mënyrë kronologjke dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave, etj, por nuk janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitore. Nuk është mbajtur libri i madh apo libri centrilizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, për të kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël. Gjithashtu nuk është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemimeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentat vërtetuese. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar, Kreu III, **pika 3.2** "Procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme" në të cilën përcaktohet: *Mbyllja e llogarive vjetore nga ana e njësive të qeverisjes së përgjithshme është një proces i domosdoshëm, i cili duhet të bëhet përpara përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore, duke ndjekur rradhën kronologjike si më poshtë vijon:* ***Nënpika 43.*** *Fillimisht, njësitë e qeverisjes së përgjithshme (në varësi të mënyrës së mbajtjes së kontabilitetit) përgatisin dokumentin përmbledhës të transaksioneve dhe veprimeve që rezultojnë nga mbajtja e kontabilitetit në ditarët përkatës kronologjik, gjatë periudhës ushtrimore vjetore.* ***Nënpika 44****. Këto njësi, në fillim të vitit ushtrimor, duhet të saktësojnë pozicionin e çeljes së llogarive nga viti i mëparshëm dhe të realizojnë transaksionin e transferimit të tepricës së llogarisë 85 "Rezultat i veprimtarisë ushtrimore" në llogarinë 12 "Rezultat i mbartur".* ***Nënpika 45****. Pas verifikimit paraprak të pozicionit të llogarive, të cilat duhet të jenë të balancuara, hartuesi i pasqyrave financiare duhet të realizojë veprimet e mbylljes së llogarive, deri në pozicionin përfundimtar të tyre, për periudhën ushtrimore që raportohet.*

- Në tërësi organizimi i mbajtjes së kontabilitetit ka mundësuar nxjerrjen e gjendjeve të llogarive sipas klasave, nisur nga dokumentet bazë justifikuese, të cilat janë të dhëna bazë të hyra në kontabilitet.
- Plotësimi i dokumenteve bazë e justifikues është bërë në mënyrë të plotë, pasi përshkruajnë me vertetesi veprimin ose ngjarjen, përmban te dhëna për shkakun e veprimit, datën dhe vendin e kryerjes, objektin, treguesit sasiore dhe ato të vlerës, personat që kanë urdhëruar dhe ekzekutuar veprimin me të dhenat e nevojshme që i japin dokumentit forcën e një prove ligjore ose administrative. Kështu, dokumentet vërtetues si Urdhër-shpenzimi, fletë hyrje-daljet, mandat arketimet e pagesat, janë të hartuara me të gjitha elementet që kërkon formati i miratuar. Këto dokumente shoqërohen nga dokumente autorizues si me urdhrat apo vendimet e organeve drejtuese, kontratat, dokumentet kryesore të procedurave të prokurimit, akt-marrëveshjet,etj. Bashkëlidhur këtij dokumentacioni janë dokumentet vërtetues të shpenzimit si faturat, listëpagesat, situacionet e shpenzimeve, procesverbalet, shkresat etj.
- Informacioni kontabël është përgatitur mbi bazën e një kontabiliteti të quajtur të angazhimeve (ose në bazë të të drejtave të konstatuara), duke dhënë elementet e nevojshme për të vlerësuar gjendjen pasurore, gjendjen financiare dhe rezultatet e njësisë ekonomike.

Titulli i Gjetjes	Mangësi në procedurat e mbajtjes së kontabilitetit
Situata:	-Nuk janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin. -Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë mbajtur kronologjikisht dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, të arkës, magazinës, të pagave, etj, por nuk janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitore. -Nuk është mbajtur libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, për të kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël. -Nuk është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemimeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese.
Kriteri:	Udhëzimi MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar, Kreu III, pika 3.2 "Procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme" *Nënpikat 43, 44 dhe 45.*
Ndikimi/Efekti:	Ndikon në pasqyrimin e drejt të veprimeve financiare.
Shkaku:	Sektori i Financës nuk ka vepruar referuar procedurave për mbajtjen e kontabilitetit.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandim:	Sektori i Financës të marrë masë që në mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare, të zbatojë parimet e kontabilitetit në procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare duke ndjekur fazat në mënyrë logjike, që nga mbajtja e dokumenteve përmbledhës të transaksioneve dhe veprimeve që rezultojnë nga mbajtja e kontabilitetit në ditarët përkatës kronologjik, saktësimin e pozicionit të çeljes së llogarive nga viti i mëparshëm dhe pas verifikimit paraprak të pozicionit të llogarive, të cilat duhet të jenë të balancuara, dhe në fund kryerjen e veprimeve të mbylljes së llogarive, deri në pozicionin përfundimtar të tyre, duke evidentuar edhe në librin e veprimeve të ndryshme sistemimet me të gjitha të dhënat e kryera në llogaritë e ndryshme sipas rastit.

- ***Baza e dhënies së opinionit së Raportimit Financiar. Pohimet mbi saktësinë e paraqitjes së zërave të pasqyrave financiare.***

Për dhënien e opinionit mbi pasqyrat financiare, u analizuan treguesit e pasqyrave financaiare të Spitalit Sarandë për aktivitetin ekonomiko - financiar 01.01.2021 deri më datën 31.12.2021. Pasqyrat financiare janë përgatitur nga Sektori i Financës. **Gjatë fazës së ekzekutimit në terren, u kryen teste të detajeve dhe teste thelbësore, nga ku u konstatua se, janë mbartur saktë tepricat e llogarive dhe se tepricat në çelje për vitin 2021, rakordojnë me tepricat në mbyllje të vitit 2020.**

Nga verifikimi i gjendjes së llogarive të bilancit të vitit ushtrimor 2021 rezulton se, llogaritë e Aktivit dhe të Pasivit kuadrojnë me formatet anekse pjesë e PF, si dhe llogaritë sintetike kuadrojnë me ato analitike;

Totali i Aktivit për vitin 2020 është në vlerën 617,594,432 lekë dhe për vitin 2021 është 581,241,066 lekë , i paraqitur në formatin 1 dhe i zbërthyer në llogari si më poshtë:

Formati nr.1 Aktivi i Bilancit 2021

Nr. Reshti	Referenca e Logarive	E M E R T I M I	Ushtrimi I Mbyllur	Ushtrimi Paraardhes
1	**A**	**A K T I V E T**	**581.241.066**	**617.594.432**
2		**I.Aktivet Afat shkurtra**	**102.543.675**	**121.781.197**
3		**1.Mjete monetare dhe ekuivalent te tyre**	**31.625.431**	**29.763.500**
4	531	Mjrete monetare ne Arke		
5	512,56	Mjete monetare ne Banke		
6	520	Disponibilitete ne Thesar	31.625.431	29.763.500
7	50	Letra me vlere		
8	532	Vlera te tjera		
9	54	Akreditiva dhe paradhenie		
10	59	Provigjone zhvlersimi letra me vlere (-)		
11		**2.Gjendje Inventari qarkullues**	**30.638.126**	**31.913.704**
12	31	Materiale	18.262.829	19.538.407
13	32	Inventar I imet	12.375.297	12.375.297
14	33	Prodhim nre proces		
15	34	Produkte		
16	35	Mallra		
17	36	Kafshe ne rritje e majmeri		
18	37	Gjendje te pa mbritura,ose prane te treteve		
19	38	Diferenca nga cmimet e magazinimit		
20	39	Provigjone perzhvlersimin e inventarit (-)		
21		**3.Llogari te Arketushme**	**34.474.732**	**26.427.484**
22	411	Kliente e llogari te ngjashme		
23	423.429	Personeli, paradhenie, deficite, gjoba		
24	431	Tatim e Taksa		
25	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
26	433	Fatkeqsi natyrore qe mbulohen nga shteti		
27	435	Sigurime Shoqerore		
28	436	Sigurime Shendetsore		
29	437,438,	Organizma te tjere shteterore		
30	44	Institucione te tjera publike		
31	465	Efekte per tu arketuar nga shitja e letrave me vlere		
32	468	Debitore te ndryshem	129.248	129.248
33	4342	Operacione me shtetin (Te drejta)	34.345.484	26.298.236
34	45	Mardhenie midis institucioneve apo njesive ekonomike		
35	49	Shuma te parashikuara per xhvleresim(-)		
36		**4.Te tjera aktive afatshkurtra**	**5.805.386**	**33.676.509**
37	409	Parapagime		
38	473	Llogari e pritjes te mardhenieve me thesarin		
39	477	Diferenca konvertimi aktive		
40	481	Shpenzime per t'u shperndare ne disa ushtrime		
41	486	Shpenzime te periudhave te ardhshme	5.805.386	33.676.509
42		**II.Aktivet Afat gjata**	**478.697.391**	**495.813.235**
43	**20**	**1.Aktive Afatgjata jo materiale**	**10.639.223**	**10.639.223**
44	201	Prime te emisionit dhe Rimbursimit te huave		
45	202	Studime dhe kerkime	10.411.705	10.411.705
46	203	Koncesione,Patenta,Licenca e te ngjashme	227.518	227.518
47	**21**	**2.Aktive Afatgjata materiale**	**468.058.168**	**485.174.012**
48	210	Toka, T,roje, Terene		0
49	211	Pyje, Plantacione		0
50	212	Ndertesa e Konstruksione	411.435.781	425.875.698
51	213	Rruge, rrjete, vepra ujore		0
52	214	Iinstalime teknike, makineri e paisje	37.459.894	38.862.568
53	215	Mjete Transporti	16.670.557	17.113.164
54	216	Rezerva Shteterore		0
55	217	Kafshe pune e prodhimi		0
56	218	Inventar ekonomik	2.491.936	3.322.582
57	24	Aktive afatgjata te demtuara		0
58	28	Caktime te Aktiveve Afatgjata		0
59	25-26	**3.Aktive Afatgjata Financiare**	**0**	**0**
60	25	Huadhenie e Nenhuadhenie		
61	26	Pjesmarrje ne kapitalin e vet		
62		**4.Investime**	**0**	**0**
63	230	Per Aktive Afatgjata jo materiale		
64	231	Per Aktive Afatgjata materiale		0

A. AKTIVE AFATSHKURTRA.

Klasa 5 "Mjete monetare dhe ekuivalentet e tyre" në mbyllje të vitit 2020 është në vlerën 29.763.500 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 është në vlerën 31.625.431 lekë**,** të cilat rakordojnë me rubrikën V "Teprica ne fillim te vitit ushtrimor" dhe rubrikën VI "Teprica e Likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor" në Formatin nr.3 "Pasqyra e flukseve monetare (CASH-FLOË) sipas metodës direkte".

- ***Gjendja e llogarisë 520 "Disponibilitete në Thesar"*** sipas bilancit në mbyllje të vitit 2020 është në vlerën 29,763,500 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 është në vlerën 31,625,431 lekë, gjendje të cilat rakordojnë me realizimin në fakt të fondeve sipas akt-rakordimit me Degën e Thesarit, por nuk rakordon me rubrikën analoge "Tepricën e likuiditeteve në fund të vitit ushtrimor" të Formatit nr.3 "Pasqyrë e flukseve monetare viti 2021" të paraqitur në tabelën e mëposhtme: (Aneksin B/8).

Nr. Reshti	Nr Rubrike	PERMBAJTJA	Periudha Raportuse	Periudha Paraardhese
(a)	(b)	(c)	(1)	(2)
1	I	**VEPRIMTARITE E SHFRYTEZIMIT**	**8.320.354**	**7.363.629**
2	1	**Akordim Fonde Buxhetore per shpenzime korente (+)**	355.493.000	267.901.000
3	2	**Arketime e te hyra(Cash), gjate vitit ushtrimor**	**9.040.932**	**9.377.877**
4		Te Hyra nga Tatimet e Doganat tatimore e Doganore(+)		
5		Te hyra nga Kontributet e Sig. shoq. e shendets(+)		
6		Te hyra nga ardhurat jotatimore (+)	8.978.832	
7		Te hyra, Sponsorizime nga te trete,(+)		9.377.877
8		Te hyra, nga kredi e huamarrje afatshkurter(+)		
9		Te hyra nga Mjetet ne ruajtje(+)	62.100	
10		Te tjera, arketuar(+)		
11	3	**Pagesa per Detyrime e Shpenzime korente**	**-356.213.578**	**-269.915.248**
12		Per detryrime e Shpenzime nga vitet e kaluara(-)		
13		Per detryrime e Shpenzime te viti ushtrimor(-)	-356.213.578	-269.915.248
14		Pagesat per mjetet ne ruajtje(-)		
15		Interesi I paguar(-)		
16		Tatime te paguara(-)		
17		Te tjera te paguara (-)		
18	II	**VEPRIMTARITE E INVESTIMEVE**	**-5.850.725**	**-1.116.025**
19		Akordim Fonde Buxhetore per shpenzime Kapitale (+)		
20		Te hyra nga Kredi dhe e huamarrje afatgjata(+)		
21		Te hyra nga shitja e Aktiveve Afatgjata (+)		
22		Te hyra nga interesat e huadhenies dhe nenhuadhenies(+)		
23		Pagesa per detryrime e Investime nga vitet e kaluara(-)		
24		Per detryrime e Investime te viti ushtrimor(-)	-5.850.725	-1.116.025
25		Huadhenie e Nenhuadhenie(-)		
26		Pjesmarrje ne kapitalin e vet(-)		
27		Dividente te paguar(-)		
28	III	**TRANSFERTA E TE TJERA**	**-607.698**	**-187.199**
29		Derdhje e Transferime te te Ardhurave ne Buxhet(-)		-25.327
30		Transferime ne buxhet te Fondevete pa perdorura(-)	-607.698	-161.872
31		Levizje e brendshme e transferta te tjera(+-)		
32	IV	**Rritja /Renia neto e Mjeteve monetare**	**1.861.931**	**6.060.405**
33	V	**Teprica ne fillim te vitit ushtrimor**	**29.763.500**	**23.703.095**
34	VI	**Teprica e Likujditeteve ne fund te vitit ushtrimor**	**31.625.431**	**29.763.500**

Në klasën 3 "Gjendja e inventarit qarkullues" të aktiveve qarkulluese paraqiten në mbyllje të vitit 2020 në vlerën **31,913,704** lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën **30,638,126** lekë, ku diferenca e tyre në zbritje në vlerën prej **-1,275,578** lekë, e cila nuk rakordon me gjendjen e llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjeve të inventarit" në vlerën **30,638,126 lekë** të paraqitur në formatin nr.2 "Pasqyra e performancës financiare".Llogaritë analitike paraqiten më poshtë:

- ***Gjendja e llogarisë 31 "Materiale"*** paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 19.538.407 lekë dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 në vlerën 18,262,829 lekë, me një diferencë në zbritje për vitin ushtrimor prej **-1,275,578 lekë**, e cila përfaqëson pakësim te gjendjes se mallrave ne fund te vitit 2021.

- ***Gjendja e llogarisë 32* "*Inventari i imët"*** paraqitet si në mbyllje të vitit 2020 dhe në mbyllje të vitit ushtrimor 2021 në vlerën 12,375,297 lekë.
Klasa 4 "Llogari të arkëtueshme" paraqiten në mbyllje të vitit 2020 në vlerën **26,427,484** lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën **30,638,126** lekë, ku kemi rritje duke e krahasuar me vitin paraardhës, i cili ka ardhur si rezultat i rritjes së detyrimeve të shtetit ndaj të tretëve.
- ***Gjendja e llogarisë 468 "Debitorë të ndryshëm",*** e cila përfaqëson shumën e të drejtave të arkëtueshme nga të tretët, si në mbyllje të vitit 2020 dhe në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën 129,248 lekë. ***Kjo vlerë është e pa analizuar dhe nuk dihet se cfarë përfaqëson, e cila është trashëguar në vite.***

- ***Gjendja e llogarisë 4342*** "Të tjera operacione me shtetin (të drejta)" në aktiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2021 në shumën 34.345.484 lekë, e cila përfaqëson detyrimet afatshkurtra për muajin dhjetor 2021, që trashëgohen në vitin 2022. Gjendja në fund të vitit 2021 e llog. *4342* "Të tjera operacione me shtetin (të drejta)" në vlerën 34.345.484 lekë kuadron me shumën e gjendjeve të llogarive në pasivin e bilancit: llog. 401-404 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" në vlerën 18.556.689 lekë për faturat e fundvitit 2021, llog.42 "Detyrime ndaj personelit" për vlerën 11.159.742 lekë, llog.431 "Detyrime ndaj shtetit për tatim taksa" për vlerën 1,077,438 lekë, llog.435 "Sigurime shoqërore" për vlerën 3,111,701 lekë, llog.436 "Sigurime shëndetësore" për vlerën 439,914 lekë.

Klasa 4 "Të tjera aktive afatshkurtra" e cila përbëhet nga :
Gjendja e llogarisë ***486 "Shpenzime të periudhave të ardhshme"*** paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 33,676,509 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 5.805.386 lekë, kjo gjendje rakordon me gjendjen e llog. 467 "kreditorë të ndryshëm" kundërparti në pasiv të bilancit.

II. AKTIVE AFATGJATA MATERIALE

Auditimi i aktiveve afatgjata materiale
Objektivat e auditimit të aktiveve afatgjata materiale, janë që të sigurohemi se:
Aktivet egzistojnë; ato i përkasin subjektit; janë të vlerësuara në mënyrë korrekte; janë regjistruar në mënyrë korrekte; është bërë mirë ndarja midis shpenzimeve dhe aktiveve të qëndrueshme; informacionet që ndodhen në aneksin përkatës janë të plota dhe korrekte.
2. Kontrolle të përgjithshme të llogarive dhe dokumenteve:
- Për auditimin e aktiveve **afatgjata materiale**, u kryen një numër kontrollesh të përgjithshme:
- U verifikua tabela e lëvizjeve të aktiveve **afatgjata materiale** në raport me gjendjet dhe ndryshimin e tyre gjatë periudhës ushtrimore;
- U ekzaminua tabela e lëvizjeve, nëse ka ndodhur ndonjë variacion anormal mbi aktivet **afatgjata materiale**;
- U ekzaminuan të gjitha shpjegimet që janë paraqitur lidhur me shmangiet dhe përjashtimet e veçanta;
- U verifikua nëse parimet kontabël të ndjekura prej subjektit për vlerësimin dhe kontabilizimin janë konform parimeve të përgjithshme të pranuara dhe udhëzimeve përkatëse.
- U verifikua nëse shifrat e çeljes rakordojnë me ato të mbylljes së ushtrimit të mëparshëm;
- U krahasuan investimet e realizuara gjate ushtrimit me ato të planifikuara në buxhet.
3. Disa nga parimet e zbatuara për auditimin e aktiveve afatgjata materiale:
a. Gjatë hyrjes se aktiveve në pronësinë e subjektit, duhet të sigurohemi se veprimet janë kryer në zbatim të kërkesave te UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Mbi menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".
- Për Aktivet e blera janë kryer teste për 5 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabël nëse janë kontabilizuar sipas vlerës së tyre të marrjes. (çmimit të blerjes shtuar shpenzimet e tjera të nevojshme për vënien në gjendje përdorimi të pasurisë);

- Për Aktivet e marra falas janë kryer teste për 4 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabël nëse janë kontabilizuar duke i vlerësuar ato me vlerën e shitjes;
- Aktivet e sjella në subjekt (kalim kapital) janë kryer teste për 2 kampione në dokumentet bazë të hyrjes dhe kartelat analitike kontabël nga të tretët nëse kontabilizohen me vlerën e tyre të sjelljes.

b. Për inventarin, janë kryer teste për tu siguruar që subjekti:
- Procedon për regjistrimin dhe vlerësimin e aktiveve të saj të qëndrueshme sipas rregullave kontabël përgjithësisht të pranuara;
- Përdor referencat ose tekN. t më të përshtatshme për natyrën e pasurisë (çmimi i tregut, tabelat e publikuara, treguesit specifike, etj);
- Ka ruajtur të njëjtat rregulla vlerësimi nga një inventar në tjetrin.

Në formatin nr. 1 **"Aktivet Afatgjata" në aktiv të bilancit** paraqiten në vlerën neto, duke zbritur investimet në proces (gjendjen e llog 23I "Investime"). Gjendja në total paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 495.813.235 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 478.697.391 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" paraqiten në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 684.807.986 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 882.283.981 lekë, të cilat janë të pasqyruara më poshtë sipas llogarive analitike.

Klasa 20 "Aktive Afatgjata jo materiale" që përbëhet nga**:**

- **Gjendja e llogarisë 202 *"Studime dhe kërkime"*** paraqitet e njëjtë (në vlerë neto) si në mbyllje të vitit 2020 dhe në mbyllje të vitit 2021 në svlerën prej **10.639.223** lekë. Sipas Formatit 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" gjendja paraqitet e njëjtë si në mbyllje të vitit 2020 dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën **10.639.223** lekë. Kjo gjendje është e pa analizuar dhe nu ka të dhëna se cfarë përfaqëson. Sipas të dhënave kontabël, kjo llogari është e analizuar si vijon. ***Kjo vlerë është e pa analizuar dhe nuk dihet se cfarë përfaqëson, e cila është trashëguar në vite.***

Inventari i llogarisë 202 "Studime dhe kërkime"

Llog.	Nr	Emërtimi i aktiveve	Gjendja me 31.12.2020	Shtesa gjate vitit 2021	Pakësime gjate vitit 2021	Gjendja më 31.12.2021
202		**Studime dhe kerkime**	10,411,705			10,411,705
203		**Koncesione, patenta,licenca e tjera ngjashme**	227.518			227.518
		TOTALI	**10,639,223**			**10,639,223**

Konkluzion: Vlera e mbetur në fund të vitit 2021 prej 10,411,705 lekë e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e *llogarisë 202 "Studime dhe Kërkime",* është e pa analizuar dhe nu ka të dhëna se cfarë përfaqëson.Vlera e projekt-studimeve për investime të kryera nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Për këtë vlerë nuk ekziston inventar kontabël dhe fizik dhe nuk dihet se ku janë ruajtur, nëse janë bërë hyrje në arkiv në çdo dosje teknike të tenderave sipas investimit të kryer në aktivet materiale afatgjatë. Për këto vlera duhet të kryhen veprimet kontabël për kalimin e vlerës së tyre si vlerë e shtuar çdo aktivi afatgjatë material mbi të cilën është kryer investimi mbi bazën e këtyre projekt-studimeve. Gjithashtu për këto aktive nuk është llogaritur amortizim. Kjo procedurë e ndjekur është në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Kreu III. "Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", pika 36 i cili përcakton se: *"Për aktivet afatgjata jo materialë, amortizimi të llogaritet me metodën lineare me normë amortizimi 15%"*.

Aneksi 1 "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik **"Pika 2. Klasa 2,** "Aktivet afatgjata" (përbërja dhe trajtimi kontabël) e cila përcakton: *"Trajtimet kontabël për AAGJM-në, lidhen me njohjen fillestare të aktivit, si dhe vlerësimin e mëpasshëm:*

a) Njohja fillestare - AAGJM-ja, duhet të plotësojnë kriteret e njohjes në pasqyrën e pozicionit financiar, pra, duhet të vlerësohen me kosto që janë:
- Kostoja e blerjes së bashku me taksat e importit;
*- Kosto të tjera të drejtpërdrejta deri në sjelljen e aktivit në vendndodhje apo dhe kosto të tjera qëi shtohen nga prodhimi i elementeve të aktivit (**kosto projektimi**, paga dhe kontribute për prodhimin e elementeve të aktivit, materiale të përdorura për këto elemente, kosto transporti, kosto instalimi, kosto testimi etj.).*
***Aktivet afatgjata jo materiale përcaktohen dhe klasifikohen të tilla si**: programet kompjuterike, markat, patentat, licencat, të drejtat e përdoruesit etj. Mund të ketë aktive me karakteristika si të AAGJM-së ashtu edhe të AAGJ/JM-së. Në këto raste, ato klasifikohen në varësi të karakteristikave dominuese. Shembull, një program kompjuterik (soft) përfshihet në AAGJM, nëse është pjesë përbërëse e pajisjeve kompjuterike, në të kundërt (pra, kur nuk është pjesë), trajtohet si AAGJ/JM"*
Kreu II. "Parimet dhe rregullat e organizimit dhe të mbajtjes se kontabilitetit publik në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" **Pika 16/b.d** të cilat përcaktojnë: "*Për regjistrimin në kontabilitet të operacioneve të funksionimit, ndiqet procedura e mëposhtme:*
b) Për shpenzimet e njohura të investimeve bëhet regjistrimi kontabël si më poshtë:
- Debitohet llogaria përkatëse e investimeve (të grupit 23); dhe
- Kreditohet llogaria përkatëse e detyrimeve (klasa 4).
d) Në rastin e kapitalizimit të aktiveve afatgjata, të përfituara nëpërmjet shpenzimeve të investimeve (të regjistruar sipas pikës "b" më sipër), bëhet regjistrimi kontabël si më poshtë:
- Debitohet llogaria përkatëse e grupit 20 ose 21 të aktiveve afatgjata; dhe - Kreditohet llogaria përkatëse e investimeve (grupi 23).

Titulli i Gjetjes	Devijime në kontabilizimet e aktiveve jo materiale në llogarinë 202 "Studime dhe Kërkime"
Situata:	-Për aktivet afatgjata jomateriale (Klasa20), konstatohet se Vlera e mbetur në fund të vitit 2021 prej ***10,411,705 lekë*** e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e *llogarisë 202 "Studime dhe Kërkime",* është e pa analizuar dhe nuk ka të dhëna se çfarë përfaqëson. -Vlera e projekt-studimeve për investime të kryera nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Për këtë vlerë nuk ekziston inventar kontabël dhe fizik dhe nuk dihet se ku janë ruajtur, nëse janë bërë hyrje në arkiv në çdo dosje teknike të tenderave sipas investimit të kryer në aktivet materiale afatgjatë.
Kriteri:	Udhëzimi i MFE nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Kreu III. "Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", pika 36.
Ndikimi/Efekti:	Në paraqitjen dhe raportimin e pasqyrave financiare
Shkaku:	Nga Sektori i Financës nuk janë marrë masat e nevojshme për saktësimin në kontabilitet të operacioneve të funksionimit në lidhje me procesin e kapitalizmit të aktiveve. Gjithashtu nuk janë kryer veprimet e llogaritjes së amortizimit për aktivet afatgjata jo materiale dhe të kryerjes së veprimeve kontabël përkatëse.
Rëndësia:	E lartë

Rekomandim:	Sektori i Financës të analizojë vlerën 10,639,223 lekë me emërtesat përkatëse të projekt-studimeve dhe të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës të studim-projektimeve sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij, duke kredituar llog. 202 "Studime dhe Kërkime "dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura koresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë. Gjithashtu të bëjë korrektimet e duhura për llogaritjen e amortizimit të tyre dhe sistemimet kontabël përkatëse.

U zhvilluan teste kontrolli dhe teste të detajeve të posteve Aktiveve materiale të llogarive sintetike dhe analitike të bilancit kontabël për vitin 2021.

Në formatin nr. 1 (Aktiv i bilancit) "Aktivet afatgjata materiale" paraqiten me vlerë neto në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 485.174.012 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në shumën totale prej 468.058.168 lekë. Ndërsa sipas Formatit 7/b "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" paraqiten në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 674.168.763 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 871.644.758 lekë. Kjo llogari sintetike e analizuar paraqitet në llogaritë e mëposhtme:

- Gjendja e Llogarisë 212 "Ndërtesa Konstruksione" paraqitet në vlerë neto në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 425.875.698 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 411.435.781 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)"paraqiten në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 485.961.573 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 519.157.765 lekë. Pra kemi rritje në vlerën 33,196,192 lekë, nga të cilat 5,850,727 lekë janë shtesa me pagesë që përfaqëson blerjen e AAGJM "Rikonstruksion i Godinës së Pediatrisë" dhe 27,345,465 lekë lëvizje brenda sistemit, ***për të cilën nuk ka shpjegime se çfarë përfaqëson kjo vlerë si dhe nuk ka evidentim të veprimeve kontabël të kryera për çdo aktiv brenda këtij grupi aktivesh. (mungon libri i veprimeve të ndryshme).*** Analiza e gjendjes së kësaj llogarie dhe ndryshimet nga viti 2020 në vitin 2021 paraqiten në Aneksin nr.B/1.

Inventari kontabël i llogarisë 212 "Ndërtesa " me 31.12.2021

Nr	Emërtimii i aktiveve	Gjendja 31.12.2020	Shtesa gjatë vitit 2021	Gjendja 31.12.2021
1	Spitali dhe Poliklinika	91,107,012		91,107,012
2	Materniteti vjetër	34,575,900		34,575,900
3	Ndërtimi urgjenca e re	47,202,728		47,202,728
4	Depo oksigjeni	978000		978000
5	Sheshi para Urgjencës	5695366		5695366
6	Adaptim ashensori	1180000		1180000
7	Projekt materniteti	5390000		5390000
8	Ndërtim i murit mbajtës tek urgjenca	5489742		5489742
9	Rikonstruksioni i ambienteve te skanerit	1669530		1669530
10	Projekt preventiv i rikonstruksionit te spitalit	2976000		2976000
11	Poliklinika- shtese kati	12195473		12195473
12	Projekti per depon e ujit	200000		200000
13	Ndërtimi i ambienteve te imazherise	3270151		3270151
14	Projekt per shtese kati dhe ndërtim materniteti mbi urgjence	3996000		3996000
15	Rikonstruksioni i ambienteve te katit te pare per përshtatjeje farmacisë	2714049		2714049
16	Ndërtimi i maternitetit te ri	268779026		268779026
17	supervizioni per ndërtimin e materniteti	650000		650000
18	pagesa leje ndërtimi	5725000		5725000
19	Depo uji	4470000		4470000
20	Hidroizolim tarace	209800		209800
21	Pike lidhje oshee	510705		510705
22	Vlera TVsh projekti	6709624		6709624
23	Kosto lokale per projektin	3019791		3019791
24	Rrethimi i spitalit	330184		330184
25	Rikonstruksion kati pare poliklinike	359646		359646

26	Hidroizolim tarace	71640		71640
27	Punime shtresash ne Kirurgji	598,800		598,800
28	Rikonstruksion arkive	648,000		648,000
29	Zëvendësim i portave te brendshme kirurgji	871,200		871,200
30	Vendosje barriera elektronike	632800		632800
31	Rikonstruksion i urgjencës	1080871		1080871
32	Rikonstruksion i Pediatrisë		5,850,727	5850727
33	**Totali** (në vlerë historike)	**513,307,038**		**519,157,765**

Konkluzion: Gjendja e llogarisë 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" në vlerë neto paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 38.862.568 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në shumën 37.459.894 lekë. Ndërsa në vlerë historike (vlerë bruto) paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 147,569,642 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën 243.833.407 lekë, pra kemi shtesë në vlerën 96,263,765 lekë, ku 540,454 lekë është shtesë pa pagesë për të cilën nuk ka emërtim dhe nga ka ardhur dhe vlera prej 95,723,311 lekë nga lëvizjet brenda aktiveve, vlerë për të cilën nuk ka snjë të dhënë se cfarë veprime sistemimi kontabël janë kryer, pasi nuk është mbajtur ditari i veprimeve të ndryshme dhe nuk ka sqarime për to në formatin e Pasqyrave financiare të të dhënave shpjeguese. Mungon analiza sipas llojeve të aktiveve që përbëjnë këtë grup aktivesh, me emërtesat aktiv për aktiv dhe vlerat përkatëse, duke munguar kështu inventari kontabël dhe fizik për këtë grup aktivesh. Këto veprime janë në kundërshtim me këto veprime janë në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75; Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Kreu II pika 5 dhe Kreu III, pika 3.1 "Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", **nënpika 30** në të cilën përcaktohet: "30. *Çdo njësi e qeverisjes së përgjithshme kryen verifikimin fizik të aktiveve dhe elementëve të tjerë, konform kritereve të përcaktuara në aktet ligjore e nënligjore, si dhe saktëson vërtetësinë e llogarive të të drejtave e të detyrimeve ndaj të tretëve. Mbi këtë bazë, në kontabilitet, bëhen veprimet për sistemimin e diferencave të gjendjes fizike me gjendjen kontabile për llogari të vitit kontabël që mbyllet."*

Titulli i Gjetjes	Mbi kontabilizimet në llog. 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune" në vlerën 243,833,407 lekë, gjendje të cilat nuk janë të analizuara.
Situata:	***-Gjendja e llogarisë 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune"*** në vlerë neto paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 38,862,568 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në shumën 37,459,894 lekë. Ndërsa në vlerë historike (vlerë bruto) paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 147,569,642 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën 243,833,407 lekë, pra kemi shtesë në vlerën 96,263,765 lekë, ku 540,454 lekë është shtesë pa pagesë për të cilën nuk ka emërtim dhe analizë se nga ka ardhur, po kështu edhe vlera prej 95,723,311 lekë, nga lëvizjet brenda aktiveve, vlerë për të cilën nuk ka asnjë të dhënë se çfarë veprime sistemimi kontabël janë kryer, pasi nuk është mbajtur ditari i veprimeve të ndryshme dhe nuk ka sqarime për to në formatin e Pasqyrave financiare të të dhënave shpjeguese. -Mungon analiza sipas llojeve të aktiveve që përbëjnë këtë grup aktivesh, me emërtesat aktiv për aktiv dhe vlerat përkatëse, duke munguar kështu inventari kontabël dhe fizik për këtë grup aktivesh.
Kriteri:	- UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75; -Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e

	qeverisjes së përgjithshme" Kreu II pika 5 dhe Kreu III, pika 3.1 "Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", nënpika 30.
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e analizës për vlerën ***243,833,407 lekë*** ka ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, duke paraqitur risk në sigurinë e arsyeshme dhe besueshmërinë e evidencës kontabël për përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.
Shkaku:	Nga Sektori i Financës nuk janë marrë masat e nevojshme për analizimin dhe saktësimin në kontabilitet të këtyre aktiveve, duke mbledhur e evidentuar të dhënat nga gjithë dokumentacioni financiar i trashëguar në vite.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandim:	Titullari i Institucionit të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llog. *log.* ***214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune"*** dhe nëpërmjet Sektorit të Financës të kryejë zbërthimin e dokumentacionit të financiar të trashëguar për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në PF e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet dhe në inventarin fizik.

- Gjendja e llogarisë 215 "Mjete Transporti" në vlerën neto paraqite në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 17.113.164 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 16.670.557 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" paraqiten në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 19.069.440 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 58.673.247 lekë, pra kemi shtesë në vlerën 39.603.807 lekë, e cila ka ardhur nga lëvizja brenda aktiveve, ***për të cilën nuk ka shpjegime se cfarë përfaqëson kjo vlerë si dhe nuk ka evidentim të veprimeve kontabël të kryera për cdo aktiv brenda këtij grupi aktivesh. (mungon libri i veprimeve të ndryshme).*** Analiza e gjendjes së kësaj llogarie dhe lëvizjet e këtyre aktiveve nga viti 2020 deri në fund të vitit 2021 paraqiten në tabelën e mëposhtme:

Inventari kontabël i llogarisë 215 "Mjete transporti "me datë 31.12.2020

Nr	Emërtimi i Aktiveve	Gjendja me 31.12.2020	Gjendja me 31.12.2021
1	A...Y- Autoambulance-Mercedez Benc	10,516,335	10,516,335
2	A...Y - Autoambulance-Mercedez Benc	7,610,024	7,610,024
3	A...B - Autoambulance-Mercedez Benc	7,610,024	7,610,024
4	A...Y - Autoambulance-Mercedez Benc	7,610,024	7,610,024
5	A...Y Autoveture mercedes Benc	1,490,000	1,490,000
6	A. Autoambulance Volksëagen	5,546,575	5,546,575
7	A...V Autoambulance Ford0	6545700	6545700
8	SR...B Autoambulance Iveco	1,500,000	1,500,000
9	SR...B - Autoambulance-Mercedez Benc	2,861,045	2,861,045
10	SR...B	1,000,000	1,000,000
11	**A...F** - Autoambulance Land Rover	6,383,520	6,383,520
	Totali	**58,673,247**	**58,673,247**

- Gjendja e llogarisë 218 "Inventar Ekonomik" në vlerën neto paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 3,322,582 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 2,49,936 lekë. Ndërsa sipas Formatit nr.7/B "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 21.568.108 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën kontabël 49.980.339 lekë, pra kemi shtesa në vlerën 28.412.231 lekë, e cila ka ardhur nga lëvizja brenda aktiveve për të cilat nuk ka shpjegime se cfarë përfaqëson kjo vlerë si dhe nuk ka evidentim të veprimeve kontabël të kryera për cdo aktiv brenda këtij grupi aktivesh. (mungon libri i veprimeve të ndryshme).

- **Gjendja e aktiveve afatgjata** në vlerën bruto dhe neto si dhe ndryshimet per vitin 2021 paraqiten në Formatin nr.7/B "Gjendja dhe ndryshimet e aktiveve afatgjata (kosto historike)" të PF si më poshtë:

Formati 7/B

GJENDJA DHE NDRYSHIMET E AKTIVEVE AFATGJATA **në lekë**

Nr. Referen	E M E R T I M I	Teprica ne fillim			Shtesat gjate vitit		Paksimet gjate vitit		Teprica ne Fund		
		Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim	Kosto Historike	Amortizim Akumuluar	Teprica Neto
	c	1	2	3	4	5	6	7	8	9	10
20	**I. AAGJ/JO MATERIALE**	**10.639.223**	**0**	**10.639.223**	**0**	**0**	**0**	**0**	**10.639.223**	**0**	**10.639.223**
202	Studime dhe kerkime	10.411.705	0	10.411.705					10.411.705	0	10.411.705
203	Koncesi, patenta,licenca e tj ngjash	227.518	0	227.518					227.518	0	227.518
21- 28	**II. AAGJ/ MATERIALE**	**674.168.763**	**188.994.751**	**485.174.012**	**197.475.995**	**215.889.183**	**0**	**1.297.344**	**871.644.758**	**403.586.590**	**468.058.168**
210	Toka,troje,Terene	-	-	-					-	-	-
211	Pyje,Kullota Plantacione	-	-	-					-	-	-
212	Ndertime e Konstruksione	485.961.573	60.085.875	425.875.698	33.196.192	47.636.109			519.157.765	107.721.984	411.435.781
213	Rruge,rrjete,vepra ujore	-	-	-					-	-	-
214	Instal teknik,makine,paisje,vegla pun	147.569.642	108.707.074	38.862.568	96.263.765	97.666.439			243.833.407	206.373.513	37.459.894
215	Mjete transporti	19.069.440	1.956.276	17.113.164	39.603.807	41.343.758		1.297.344	58.673.247	42.002.690	16.670.557
216	Rezerva shtetrore	-	-	-					-	-	-
217	Kafshe pune e prodhimi	-	-	-					-	-	-
218	Inventar ekonomik	21.568.108	18.245.526	3.322.582	28.412.231	29.242.877			49.980.339	47.488.403	2.491.936
	T O T A L I (I + II)	**684.807.986**	**188.994.751**	**495.813.235**	**197.475.995**	**215.889.183**	**0**	**1.297.344**	**882.283.981**	**403.586.590**	**478.697.391**

Testi substancial i amortizimit

Amortizimi i AQ të Trupëzuara dhe të Patrupëzuara është llogaritur sipas normave ligjore të miratuara në përputhje me UMF nr.8, datë 9.3.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme" pika 36. Për aktivet e llogarisë 218 "Inventar Ekonomik", në të cilat përfshihen pajisjet kompjuterike llogaritja e amortizimit është bërë në grup dhe jo aktiv për aktiv dhe nuk mund të verifikoheshin se si janë grupuar dhe llogaritur amortizimi për pajisjet kompjuterike.

Vlerat e akumuluara të amortizimit sipas llogarive dhe veprimeve në kontabilitet paraqiten në tabelën e mësipërme.

Inventarizimi i aktiveve për vitet 2019, 2020 dhe 2021

Në lidhje me zbatimin e dispozitave ligjore për kryerjen e procedurave të inventarizimit të aktiveve të qëndrueshme të trupëzuara dhe qarkulluese rezultoi se:

Në bazë të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve në fund të çdo viti për Spitalin Sarandë. Nga Titullari për kryerjen e procesit të inventarizimit për vitet 2019, 2020 dhe 2021 janë nxjerrë urdhrat përkatës me nr.135, datë 11.12.2019 "Për ngritjen e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit për vitin 2019", nr. 145, datë 18.12.2020 "Për ngritjen e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit për vitin 2020" dhe nr. 185, datë 14.12.2021 "Për ngritjen e komisionit të inventarizimit dhe vlerësimit për vitin 2021".

Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për kryerjen e inventarizimit, rezultoi se komisionet e inventarizimit kanë hartuar fletët e inventarëve me gjendjen fizike të aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara e të trupëzuara dhe gjendjen kontabël sipas llogarive. Fletët e inventarëve janë të konfirmuara nga komisioni dhe përgjegjësit material brenda muajit dhjetor të viteve 2019, 2020 dhe 2021.

Referuar dokumentacionit të mbajtur nga komisioni konstatohet se për disa njësi kryerja e inventarizimit paraqet mangësi dhe shkelje të dispozitave ligjore, pasi komisioni ka konstatuar mungesa në artikuj të ndryshëm ka kryer diferencat nga gjendja fizike dhe i ka kaluar brenda ditës së inventarizimit në listën "mallra për jashtë përdorimit dhe funksionit", si mëposhtë:

Për vitin 2020

Për objektin "Recepsion", komisioni (i përbërë nga L. I, A. K dhe L. M), ka konstatuar diferenca në 2 artikuj në shumën 109,600 lekë. Përgjegjës material A. V dhe L. C.

Për objektin "Kaldaja", komisioni (i përbërë nga L. I, A. K dhe L. M), ka konstatuar diferenca në 1 artikull në shumën 4,089,700 lekë. Përgjegjës material M. H.

Për objektin "Patologjia", komisioni (i përbërë nga L. I, A. K dhe L. M), ka konstatuar diferenca në 11 artikuj në shumën 68,598 lekë. Përgjegjës material A. Q.

Për objektin "Lavanteri", komisioni (i përbërë nga L. I, A. K dhe L. M), ka konstatuar diferenca në 6 artikuj në shumën 562,300 lekë. Përgjegjës material F. S.
Për objektin "Guzhina", komisioni (i përbërë nga L. I, A. K dhe L. M), ka konstatuar diferenca në 4 artikuj në shumën 19,700 lekë. Përgjegjës material S. H.
Për objektin "Lulishtari", komisioni (i përbërë nga L. I, A. K dhe L. M), ka konstatuar diferenca në 5 artikuj në shumën 90,720 lekë. Përgjegjës material Y. Ç.
Për objektin "Infektivi", komisioni (i përbërë nga L. I, A. K dhe L. M), ka konstatuar diferenca në 4 artikuj në shumën 9, 018 lekë. Përgjegjës material K. N.
Për objektin "Poliklinika", komisioni (i përbërë nga S. D, S. G dhe V. C), ka konstatuar diferenca në 10 artikuj në shumën 387,754 lekë. Përgjegjës material K. N.
Për objektin "Urgjenca", komisioni (i përbërë nga S. D, S. G dhe V. C), ka konstatuar diferenca në 7 artikuj në shumën 2,147,854 lekë. Përgjegjës material L. M.
Për objektin "Pediatria", komisioni (i përbërë nga M. Z, A. D dhe V. M), ka konstatuar diferenca në 1 artikull në shumën 18,000 lekë. Përgjegjës material L. M.
Për vitin 2021
Për objektin "Recepsion", komisioni (i përbërë nga L. I, J. S dhe L. M), ka konstatuar diferenca në 2 artikuj në shumën 109,600 lekë. Përgjegjës material A. V, A. Ll dhe L. C.
Për objektin "Kaldaja", komisioni (i përbërë nga L. I, J. S dhe L. M), ka konstatuar diferenca në 1 artikull në shumën 4,089,700 lekë. Përgjegjës material M. H dhe H. D.
Për objektin "Parkimi", komisioni (i përbërë nga L. I, J. S dhe L. M), ka konstatuar diferenca në 1 artikull në shumën 35,154 lekë. Përgjegjës material H. D.
Për objektin "Lulishtari", komisioni (i përbërë nga L. I, J. S dhe L. M), ka konstatuar diferenca në 5 artikuj në shumën 90,720 lekë. Përgjegjës material L. Th.
Për objektin "Infektivi", komisioni (i përbërë nga L. I, J. S dhe L. M), ka konstatuar diferenca në 8 artikuj në shumën 97, 617 lekë. Përgjegjës material K. N.
Për objektin "Patologjia", komisioni (i përbërë nga L. I, J. S dhe L. M), ka konstatuar diferenca në 15 artikuj në shumën 81,847 lekë. Përgjegjës material A. Q.
Për objektin "Lavanteri", komisioni (i përbërë nga L. I, J. S dhe L. M), ka konstatuar diferenca në 6 artikuj në shumën 562,300 lekë. Përgjegjës material F. S.
Për objektin Guzhina, komisioni i përbërë nga L. I, J. S dhe L. M, ka konstatuar diferenca në 13 artikuj në shumën 33,120 lekë. Përgjegjës material S. H, M. C, M. D dhe M. H.
Për objektin "Inventari zyrave Financa" komisioni (i përbërë nga F. S, M. Z dhe M. M), ka konstatuar diferenca në 2 artikuj në shumën 108,000 lekë. Përgjegjës material S. D.
Për objektin "Inventari zyrave Llogaria" komisioni (i përbërë nga F. S, M. Z dhe M. M), ka konstatuar diferenca në 2 artikuj në shumën 38,000 lekë. Përgjegjës material F. S dhe V. D.
Për objektin "Inventari zyrave Financa" komisioni (i përbërë nga F. S, M. Z dhe M. M), ka konstatuar diferenca në 2 artikuj në shumën 73,800 lekë. Përgjegjës material J. S.
Për objektin "Mjeku Nefrolog" komisioni (i përbërë nga L. H, S. G dhe V. C), ka konstatuar diferenca në 1 artikull në shumën 5,000 lekë. Përgjegjës material G. N.
Për objektin "Laboratori biokimik" komisioni (i përbërë nga L. H, S. G dhe V. C), ka konstatuar diferenca në 14 artikuj në shumën 55,500 lekë. Përgjegjës material G. H.
Për objektin "Mjeku Kardiolog" komisioni (i përbërë nga L. H, S. G dhe V. C), ka konstatuar diferenca në 6 artikuj në shumën 32,124 lekë. Përgjegjës material G. H.
Shuma e diferencave të artikujve për gjendjen fizike krahasuar me gjendjen e kontabilitetit e konstatuar nga inventarët e kryer për vitin 2020 është 7,503,244 *lekë dhe* ***shuma për vitin 2021 është 5,412,482*** lekë, për të cilat nuk janë zbatuar drejt procedurat e inventarizimit si edhe nuk janë nxjerrë urdhër zhdëmtimet për personat përgjegjës në rastet e diferencave të gjendjes fizike.
Vlera e propozuar për nxjerrje jashtë përdorimi e mallrave dhe materialeve që kanë humbur vlefshmërinë e përdorimit në spitalin Bashkiak Sarandë është **21,844,733 lekë,** për të cilën prej

vitit 2019 nuk është vepruar nga strukturat drejtuese dhe nuk janë marrë masa për asgjësimin e tyre si ngritja e komisioneve të vlerësimit, komisionet e asgjësimit, etj.
Veprimet e kryera janë në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njesitë e sektorit publik" Kreu IV "Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve" Inventarizimi i aktiveve, "Përgjegjësitë për iventarizimin" pikat 85,86,87 dhe 89, "Procesi i vlerësimit të aktiveve" pika 96 dhe 98 dhe "Lista e aktiveve të identifikuara për vlerësim" pikat 102,103 dhe 104 dhe ngarkojnë me përgjegjësi z. E. Dh, ish drejtor i Spitalit, zj. A. K ish shefe finance (për periudhën 2019-2020), zj.J. S, me detyrë përgjegjëse e sektorit të financës, z.A. K, me detyrë drejtor i spitalit (për periudhën Maj 2021- e në vazhdim), z. F. S, me detyrë zv Drejtor Ekonomik (për periudhën Qershor 2019 - e në vazhdim), si edhe kryetarët e komisionit të inventrarizimit zj.L. I, V. C, F. S dhe zj. S. D.

Titulli i Gjetjes	Mangësi në procesin e inventarizimit
Situata:	-Në bazë të UMF nr. 30 datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" është kryer procesi i inventarizimit të aktiveve në fund të çdo viti për Spitalin Sarandë. Nga Titullari për kryerjen e procesit të inventarizimit për vitet 2019, 2020 dhe 2021 janë nxjerrë urdhrat përkatës. Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për kryerjen e inventarizimit, rezultoi se komisionet e inventarizimit kanë hartuar fletët e inventarëve me gjendjen fizike të aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara e të trupëzuara dhe gjendjen kontabël sipas llogarive. Fletët e inventarëve janë të konfirmuara nga komisioni dhe përgjegjësit material brenda afateve të përcaktuara për kryerjen e inventarëve. Referuar dokumentacionit të mbajtur nga komisioni konstatohet se për disa njësi kryerja e inventarizimit paraqet mangësi dhe shkelje të dispozitave ligjore, pasi komisioni ka konstatuar mungesa në artikuj të ndryshëm ka kryer diferencat nga gjendja fizike dhe i ka kaluar brenda ditës së inventarizimit në listën "mallra për jashtë përdorimit dhe funksionit". Shuma e diferencave të artikujve për gjendjen fizike krahasuar me gjendjen e kontabilitetit e konstatuar nga inventarët e kryer **për vitin 2020 është 7,503,244** lekë dhe **shuma për vitin 2021 është 5,412,482** lekë, për të cilat nuk janë zbatuar drejt procedurat e inventarizimit si edhe nuk janë nxjerrë urdhër zhdëmtimet për personat përgjegjës në rastet e diferencave të gjendjes fizike. -Vlera e propozuar për nxjerrje jashtë përdorimi e mallrave dhe materialeve që kanë humbur vlefshmërinë e përdorimit në spitalin Bashkiak Sarandë është **21,844,733 lekë,** për të cilën prej vitit 2019 nuk është vepruar nga strukturat drejtuese dhe nuk janë marrë masa për asgjësimin e tyre si ngritja e komisioneve të vlerësimit, komisionet e asgjësimit, etj. -Në proces verbal nuk janë argumentuar arsyet e vlerësimit të artikujve nëse janë të nevojshëm ose jo për veprimtarinë e njësisë, vlerësimin e gjendjes fizike dhe mundësinë e përdorimit të mëtejshëm në njësi të tjera si dhe nëse do të nxirret përfundimisht jashtë përdorimit ndërmjet shitjes si material, mbeturinë apo asgjësimit përfundimtar. -Vlerësimi i aktiveve nuk është bërë sipas kritereve si plotësimi i kohë së shfrytëzimit në bazë të normave të amortizimit, afatit të skadencës, nëse ka, dhe nuk mund të riparohen, kur vlera e riparimit ose e përshtatjes për t'i kthyer në gjendje pune është e barabartë ose më e madhe se vlera e tregut për blerjen e një aktivi të ngjashëm, kur ka kaluar afati i

	vlefshmërisë së tyre dhe nuk mund të përdoren si të zhvleftësuara, kur kanë humbur cilësitë e tyre të caktuara në standardet shtetërore ose në kushtet teknike dhe nuk mund të përdoren si të zhvleftësuar a ose për qëllim tjetër në formën që janë ose në formë tjetër, megjithëse nuk ka kaluar afati i vlefshmërisë, etj. -Relacioni i vlerësimit nuk përmbante procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës.
Kriteri:	-Udhëzimi nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njesitë e sektorit publik" Kreu IV "Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve" Inventarizimi i aktiveve, "Përgjegjësitë për iventarizimin" pikat 85, 86, 87 dhe 89, "Procesi i vlerësimit të aktiveve" pikat 96, 98 dhe "Lista e aktiveve të identifikuara për vlerësim" pikat 102,103 dhe 104.
Ndikimi/Efekti:	Pasqyrim i gabuar i gjendjes së mallrave dhe nxjerrje jashtë përdorimi e paargumentuar.
Shkaku:	Dega e financës dhe komisioni inventarizimit kanë vepruar në kundërshtim me dispozitat ligjore.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandim:	-Drejtori i institucionit të marrë masa për ngritjen e komisionit të inventarizimit me qëllim verifikimin e diferencave të gjendjes fizike të mallrave të paraqitura nga inventarizimet e viteve 2019-2020 dhe 2021 në shumën ***5,412,482 lekë,*** për të cilat nëse rezultojnë me diferenca të nxirren urdhër zhdëmtimet për personat përgjegjës. -Drejtori i institucionit të marrë masa për ngritjen e komisionit të vlerësimit të mallrave që kanë humbur vlefshmërinë e përdorimit vlerësuar prej vitit 2019 në shumën **21,844,733 lekë,** si edhe të kryej procedurat e nxjerrjes jashtë përdorimit të mallrave që do të klasifikohen jashtë funksionit, duke kryer analizat dhe argumentimet e bazuara në kriteret përkatëse dhe me relacionet shoqëruese.

Analiza e Llogarive të Pasivit të Bilancit Kontabël:

në lekë

Nr rreshti	Referenca e llogarive	Emërtimi	Ushtrimi I mbyllur 2021	Ushtrimi Paraardhës 2020
65	**B**	**PASIVET(DETYRIMET)**	**53.562.287**	**73.324.062**
66		**I. Pasivet Afat shkurtra**	**53.562.287**	**73.324.062**
67		**1. Llogari te Pagueshme**	**53.562.287**	**73.324.062**
68	401-408	Furnitorë e llogari te lidhura me to	18.556.689	12.209.486
69	42	Detyrime ndaj personelit	11.159.742	9.495.013
70	16,17,18	Hua Afat shkurtra		
71	460	Huadhënës		
72	431	Detyrime ndaj shtetit per tatim taksa	1.077.438	1.563.971
73	432	Tatime, mbledhur per llogari pushtetit lokal		
74	433	Detyrime, shteti fatkeqësi natyrore		
75	435	Sigurime Shoqërore	3.111.701	2.632.562
76	436	Sigurime shëndetësore	439.914	372.204
77	437,438,	Organizma te tjerë shtetërorë		
78	44	Institucione te tjera publike		
79	45	Marrëdhënie midis institucioneve apo njësive ekonomike		
80	464	Det.per tu paguar per bl.letrave me vlere		
81	466	Kreditore per mjete ne ruajtje	13.282.169	13.220.069
82	467	Kreditore te ndryshem	5.805.386	33.701.509
83	4341	Operacione me shtetin(detyrime	129.248	129.248
84	49	Shuma te parashikuara per zhvlerësim(-)		
85		**2.Te tjera pasive afatshkurtra**	**0**	**0**
86	419	Kreditore, Parapagime		
87	475	Te ardhura per t'u regjistruar vitet pasardhëse		

88	478	Diferenca konvertimi pasive		
89	480	Te ardhura per tu klasifikuar ose rregulluar		
90	487	Te ardhura te arkëtuara para nxjerrjes se titullit		
91		**II. Pasivet Afat Gjata**	**0**	**0**
92	Klase 4	Llogari te pagueshme		
93	16.17,18	Huate Afat gjata		
94		Provigjonet afatgjata		
95	Klasa 4	Te tjera		
96	**C**	**AKTIVET NETO/ FONDET (A-B)**	**527.678.779**	**544.270.370**
97	**D**	**FONDI I KONSOLIDUAR :**	**527.678.779**	**544.270.370**
98	101	Teprica(Fondi I akumuluar)/Deficiti I akumuluar	509.335.517	518.747.010
99	12	Rezultatet e mbartura	16.543.431	10.483.026
100	85	Rezultati I Veprimtarisë Ushtrimore	1.799.831	15.040.334
101	111	Rezerva		
102	115	Nga Fondet e veta te investimeve		
	15	Shuma te parashikuara per rreziqe e Zhvlerësime		
103	105	Teprica e Granteve kapitale Te brendshme		
104	106	Teprica e Granteve kapitale Te Huaja		
105	107	Vlera e mjeteve te caktuara ne përdorim		
106	109	Rezerva nga Rivlerësimi I Aktiveve Afatgjata		
107		Te Tjera		
108	**E**	**TOTALI I PASIVEVE(B+C)**	**581,241,066**	**617,594,432**

Pasivet afatshkurtra. Sipas pasqyrave financiare gjendja e llogarive kreditore në total paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën **73,324,062** lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën **53.562.287** lekë dhe përbëhet nga llogaritë si vijon:

- Gjendja e llogarisë 401- 408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" përfaqëson detyrimet ndaj të tretëve për fatura të palikuiduara. Kjo gjendje në pasiv të bilancit paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 12,209,486 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 18,556,689 lekë., pra ka rritje të detyrimeve ndaj të tretëve nga viti paraardhës në vitin ushtrimor 2021 në vlerën 6,347,203 lekë, ***duke u marrë anagazhime pa patur fondet në dispozicion.*** Sipas analizës së gjendjes së kësaj llogarie rezulton se ajo përbëhet nga 24 fatura të palikuiduara për mallra dhe shërbime të 14 furnitorëve në vlerën 26,826,386 lekë. Ky borxh është krijuar nga marsi i vitit 2018 deri në dhjetor të vitit 2021 sipas bilancit, në mënyrë të detajuar paraqitet në tabelën e mëposhtme:

Analiza e gjendjes së llogarisë 401- 408 "Furnitorë e llogari të lidhura me to"

Nr	Emertimi I Furnitorit	Pershkrimi	Data	Vlera e pa likuiduar
1	R.F	medikamente	2019	33,666
2	V.	sherbime te tjera	28/03/2018	2,190
3	F. SHPK	kompjutera	07/08/2018	390,000
4	S. SHPK	sherbime te tjera	10/09/2018	14,000
5	V.	protoksid azoti	13/09/2018	45,684
6	Q.	mirmbatje paisje mjekesore	19/03/2019	9,900
7	S.T. SHPK	artikuj ushqimore	31/03/2019	9,532
8	Q.	mirmbatje paisje mjekesore	10/04/2019	6,600
9	Q.	mirmbatje paisje mjekesore	10/04/2019	6,600
10	Q.	mirmbatje paisje mjekesore	10/04/2019	6,600
11	P.S. SHPK	kancelari	02/05/2019	323,760
12	Q.	mirmbatje paisje mjekesore	02/05/2019	16,500
13	Q.	mirmbatje paisje mjekesore	01/08/2019	6,600
14	Q.	mirmbatje paisje mjekesore	22/08/2019	7,000
15	Q.	mirmbatje paisje mjekesore	22/08/2019	3,300
16	M. SHPK	medikamente	18/09/2019	30,150
17	Q.	mirmbatje paisje mjekesore	01/10/2019	13,200
18	M...I 2.	siguria e objk. te spitalit	01/04/2020	316,021
19	E. M.	TARIFE SHERBIMI PERMBARIMORE	18/11/2020	18,000
20	V. R.	MBETJE SPITALORE	10/02/2021	108,892
21	I. G.	siguria e objk. te spitalit	28/02/2021	326,236
22	N.	artikuj ushqimore	12/03/2021	19,884
23	E.	medikamente	31/03/2021	32,294
24	I. G.	siguria e objk. te spitalit	31/03/2021	326,236
25	N.	artikuj ushqimore	01/04/2021	25,020
26	V. R.	MBETJE SPITALORE	10/04/2021	137,863
27	N.	artikuj ushqimore	11/04/2021	12,150
28	I. G.	siguria e objk. te spitalit	30/04/2021	326,236
29	V. R.	MBETJE SPITALORE	07/05/2021	131,800

30	V. R.	MBETJE SPITALORE	07/05/2021	146,315
31	I. G.	siguria e objk. te spitalit	15/05/2021	147,365
32	A. K.	supervizimi i pediatrise	24/05/2021	74,000
33	A.	mirembajtja automjeteve	12/06/2021	67,200
34	K.	gazoil	12/06/2021	919,380
35	N.	artikuj ushqimore	31/07/2021	13,926
36	V. R.	MBETJE SPITALORE	04/08/2021	151,903
37	C. C.	ANTIVIRUS	11/08/2021	85,200
38	V. R.	MBETJE SPITALORE	30/08/2021	179,438
39	M. A. G.	oksigjen	01/09/2021	49,766
40	A.	mirembajtja automjeteve	12/09/2021	25,800
41	M. A. G.	oksigjen	13/09/2021	99,533
42	N.	mirembjatje sitemi hidraulik	13/09/2021	329,580
43	M. A. G.	oksigjen	16/09/2021	49,766
44	N.	artikuj ushqimore	20/09/2021	44,976
45	N.	artikuj ushqimore	20/09/2021	44,976
46	M. A. G.	oksigjen	21/09/2021	49,766
47	N.	artikuj ushqimore	22/09/2021	105,996
48	S. C.	materiale konsumi	22/09/2021	75,600
49	M. A. G.	oksigjen	24/09/2021	99,533
50	A.	mirembajtja automjeteve	18/10/2021	117,600
51	V. R.	MBETJE SPITALORE	26/10/2021	107,325
52	D. D.	artikuj ushqimore	29/10/2021	71,688
53	M. C.	artikuj ushqimore	29/10/2021	32,472
54	M. C.	artikuj ushqimore	29/10/2021	10,368
55	A.	mirembajtja automjeteve	15/11/2021	44,880
56	M.	medikamente	18/11/2021	240,000
57	K.	gazoil	22/11/2021	364,704
58	V. R.	MBETJE SPITALORE	22/11/2021	80,632
59	F. A.	medikamente	24/11/2021	24,725
60	V. R.	MBETJE SPITALORE	24/11/2021	171,976
61	M. C.	artikuj ushqimore	30/11/2021	29,304
62	M. C.	artikuj ushqimore	30/11/2021	10,368
63	N.	artikuj ushqimore	30/11/2021	50,568
64	D. D.	artikuj ushqimore	30/11/2021	68,760
65	L. N. 2.	laburatori	06/12/2021	2,313,568
66	E.	medikamente	06/12/2021	356,760
67	M. A. G.	oksigjen	06/12/2021	176,947
68	M. A. G.	oksigjen	09/12/2021	116,122
69	V. R.	MBETJE SPITALORE	09/12/2021	99,297
70	E. F.	medikamente	12/12/2021	48,200
71	E. F.	medikamente	12/12/2021	227,000
72	M.	medikamente	21/12/2021	5,508
73	M. A. G.	oksigjen	13/12/2021	127,180
74	A.	mirembajtja automjeteve	16/12/2021	58,680
75	A.	mirembajtja automjeteve	13/12/2021	66,960
76	A.	mirembajtja automjeteve	24/12/2021	21,600
77	A.	mirembajtja automjeteve	30/12/2021	19,200
78	A.	mirembajtja automjeteve	20/12/2021	68,640
79	O. D.	medikamente	14/12/2021	136,320
80	B.	medikamente	15/12/2021	288,420
81	E. F.	medikamente	15/12/2021	48,200
82	V. R.	MBETJE SPITALORE	15/12/2021	104,736
83	M. A. G.	oksigjen	17/12/2021	127,181
84	D.	Sherbim lavanteri	22/12/2021	478,395
85	O. D.	medikamente	22/12/2021	678,048
86	A. N. F.	medikamente	24/12/2021	64,106
87	M. A. G.	oksigjen	24/12/2021	127,181
88	N.	artikuj ushqimore	24/12/2021	45,780
89	N.	artikuj ushqimore	24/12/2021	91,425
90	M. A. G.	oksigjen	28/12/2021	49,766
91	M. C.	artikuj ushqimore	29/12/2021	60,984
92	M. C.	artikuj ushqimore	29/12/2021	15,552
93	M. A. G.	oksigjen	29/12/2021	116,121
94	M.	mirembajtja skanerit	31/12/2021	273,539
95	DIETA NENTOR-DHJETOR 2021	URDHER SHERBIME		1,222,184
96	FSHU	ENERGJI ELEKTRIKE	31/12/2021	1,345,608
97	F. P	mirembajtje mjete transporti	21/10/2021	151,800
98	F. P	mirembajtje mjete transporti	21/10/2021	33,240
99	F. P	mirembajtje mjete transporti	22/11/2021	852,000
100	ONE	shpenzime telefoni	01/09/2022	12,420
101	N.	MIREMBAJTJE ELEKTRIKE	29/12/2021	261,156
102	D. N.	MIREMBAJTJE PAJISJE	07/12/2021	84,500

103	N. 8.	MIREMBAJTE NDERTIMORE	31/12/2021	361,560
104	I. G.	siguria e objk. te spitalit	01/12/2021	368,982
105	I. G.	siguria e objk. te spitalit	31/12/2021	425,748
106	UJESJELLES KANALIZIME	UJI	01.12.2021	134,772
	Shuma			**18,556,689**

Konkluzion: Referuar analizës së gjendjes së llog.401-404 "Furnitorë e llogari të lidhura me to", ku në fund vitin 2021 rezulton me një gjendje prej 18,556,689 lekë në të cilën janë akumuluar fatura të palikuiduara të viteve 2019, 2020 dhe 2021, të cilave u ka kaluar afatin 30-ditor i pagesës së këtyre faturave në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 52[2], ligjin nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" neni 6 "Afati".

- *Gjendja e llogarisë 42 "Detyrime ndaj personelit"* paraqitet në fund të vitit 2021 në vlerën 11.159.742 lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë pagesave të punonjësve të muajit Dhjetor për pagat që do të paguhen në Janar të vitit 2022.

- *Gjendja e llogarisë 431 "Detyrimet ndaj shtetit për tatim taksat"* paraqitet në fund të vitit 2021 në vlerën kontabël 1.077.438lekë, e cila rakordon me vlerën sipas listë-pagesave të punonjësve të muajit dhjetor 2021 për detyrimet tatimit mbi pagën, që do të paguhen në janar të vitit 2022.

- *Gjendja e llogarisë 435 "Sigurime shoqërore"* paraqitet në fund të vitit 2021 në vlerën 3.111.701 lekë, të llogaritura për tu paguar në muajin pasardhës.

b. Sigurimet shoqërore 15% punëdhënësi vlera 1,897,519 lekë.

- *Gjendja e llogarisë* 436 "*Sigurime shëndetësore*" në fund të vitit 2021 është në vlerën kontabël 439.914 lekë.

a. Sigurimet shëndetësore 1.7% punëmarrësi vlera 219,957 lekë

b. Sigurimet shëndetësore 1.7% punëdhënësi vlera 219,957 lekë.

- *Gjendja e llogarisë 4341 "Operacione me shtetin (detyrime)"* paraqitet e njëjtë si në mbyllje të vitit 2020 dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 129.248 lekë, duke rakorduar me gjendjen e llogarisë kundërparti në aktiv të bilancit. 468 "Debitorë të ndryshëm".

- Gjendja e llogarisë 466 "*Kreditorë për mjete në ruajtje*" përfshin garancitë e ngurtësuara për investime të kryera. Gjendja e kësaj llogarie paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 13.220.069 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 13.282.169 lekë. Për këtë gjendje të llog. 466 është bërë raportimi në degën e Thesarit Sarandë në mënyrë analitike, e cila paraqitet në Aneksin nr.B/4.

Tabela përmbledhëse e 5% i ngurtësimit të vlerës së investimit deri 31.12.2021 e palikuiduar

Nr.	Emërtimi i Investimit	Gjendja me 31.12.2020	Paguar deri me 31.12.2021	Ngurtësuar 2021	Gjendje 31.12.2021
1.	Ndërtimi i maternitetit te ri	13,220,069	0	0	13.220.069
2.	Rikonstruksion i pediatrisë			62,100	62,100
	Totali				**13,282,169**

- Gjendja e llogarisë 467 *"Kreditorë të ndryshëm"* paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 33.701.509 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën 5,805,386 lekë. Kjo gjendje përfaqëson detyrime të prapambetura ndaj të tretëve, për shpenzime, shërbime apo investime të kryera e të pa financuara, për shkak të mungesës së fondeve. Nga analiza e gjendjes së kësaj llogarie konstatohet se ka një trend ulje nga viti paraardhës në vitin ushtrimor 2021 si rezultat i pagesave të kryera për shlyerjen e detyrimeve ndaj të tretëve. Analiza e kësaj llogarie paraqitet në tabelën e Aneksi nr. B/5.

[2]në të cilën përcaktohet se*: "Nëpunësit zbatues të njësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik."*

Analiza e llogarisë 467 "Kreditorë të ndryshëm"

Nr.	Subjekti	Përshkrimi I kontratës	Data e faturës faturës	Shtuar gjatë vitit 2020	Gjendje per në 31.12.2020	Pagesat gjate vitit 2021	Shtuar gjatë vitit 2021	Gjendje me datë 31.12.2021
1	M...I 2.	ROJE PRIVATE	03/02/2020	316021	316021	316021		
2	M...I 2.	ROJE PRIVATE	02/03/2020	316021	316021	316021		
3	G. K.	KANCELARI	10/03/2020	250800	250800	250800		
4	M...I 2.	ROJE PRIVATE	01/04/2020	316021	316021			316021
5	N. SHPK	MATERIALE PASTRIMI	14/04/2020	939600	939600	939600		
6	M...I 2.	ROJE PRIVATE	04/05/2020	316021	316021	316021		
7	4. SHPK	USHQIME	31/05/2020	202320	202320	202320		
8	M...I 2.	ROJE PRIVATE	01/06/2020	150239	150239	150239		
9	O. D.	MEDIKAMENTE	02/06/2020	727890	727890	727890		
10	A. SHPK	TERMOMETER DIXHITAL	03/06/2020	72000	72000	72000		
11	B.	MEDIKAMENTE	05/06/2020	214686	214686	214686		
12	M.	MEDIKAMENTE	09/06/2020	127800	127800	127800		
13	M.	MEDIKAMENTE	09/06/2020	134130	134130	134130		
14	A. F.	MEDIKAMENTE	18/06/2020	427497	427497	427497		
15	E.	MEDIKAMENTE	18/06/2020	571000	571000	571000		
16	M.	MEDIKAMENTE	19/06/2020	47770	47770	47770		
17	M.	MEDIKAMENTE	19/06/2020	376442	376442	376442		
18	A. N. F.	MEDIKAMENTE	24/06/2020	18810	18810	18810		
19	A. N. F.	MEDIKAMENTE	24/06/2020	224115	224115	224115		
20	M.	MEDIKAMENTE	25/06/2020	170227	170227	170227		
21	R.F	MEDIKAMENTE	25/06/2020	45135	45135	45135		
22	R.F	MEDIKAMENTE	25/06/2020	228315	228315	228315		
23	A.	MEDIKAMENTE	30/06/2020	155250	155250	155250		
24	A.	MEDIKAMENTE	30/06/2020	1012100	1012100	1012100		
25	I. SHPK	MEDIKAMENTE	30/06/2020	173834	173834	173834		
26	R.F	MEDIKAMENTE	30/06/2020	57315	57315	57315		
27	M.	MEDIKAMENTE	01/07/2020	214799	214799	214799		
28	V. R.	EVADIM MBETJ SPITALORE	01/07/2020	300000	300000	300000		
29	M.	MEDIKAMENTE	02/07/2020	42600	42600	42600		
30	A. F.	MEDIKAMENTE	07/07/2020	407813	407813	407813		
31	A. F.	MEDIKAMENTE	07/07/2020	282825	282825	282825		
32	I. SHPK	MEDIKAMENTE	07/07/2020	21853	21853	21853		
33	I.	MEDIKAMENTE	08/07/2020	20400	20400	20400		
34	I.	MEDIKAMENTE	08/07/2020	118800	118800	118800		
35	I.	MEDIKAMENTE	08/07/2020	46700	46700	46700		
36	I.	MEDIKAMENTE	08/07/2020	259200	259200	259200		
37	I.	MEDIKAMENTE	08/07/2020	40096	40096	40096		
38	M.	MEDIKAMENTE	08/07/2020	21700	21700	21700		
39	F.	MEDIKAMENTE	09/07/2020	27586	27586	27586		
40	F.	MEDIKAMENTE	09/07/2020	339900	339900	339900		
41	S. M.	ARTIKUJ USHQIMORE	10/07/2020	6048	6048	6048		
42	A. N. F.	MEDIKAMENTE	13/07/2020	96400	96400	96400		
43	S. M.	MISH PULE	15/07/2020	65100	65100	65100		
44	T.	MEDIKAMENTE	16/07/2020	294895	294895	294895		
45	T.	MEDIKAMENTE	16/07/2020	46700	46700	46700		
46	T.	MEDIKAMENTE	16/07/2020	36000	36000	36000		
47	T.	MEDIKAMENTE	16/07/2020	95569	95569	95569		
48	F. A.	MEDIKAMENTE	17/07/2020	179100	179100	179100		
49	F.	MEDIKAMENTE	17/07/2020	52118	52118	52118		
50	F.	MEDIKAMENTE	17/07/2020	54080	54080	54080		
51	F.	MEDIKAMENTE	17/07/2020	38880	38880	38880		
52	E.	MEDIKAMENTE	20/07/2020	228315	228315	228315		
53	E.	MEDIKAMENTE	20/07/2020	362700	362700	362700		
54	E.	MEDIKAMENTE	22/07/2020	99959	99959	99959		
55	E.	MEDIKAMENTE	22/07/2020	48200	48200	48200		
56	E.	MEDIKAMENTE	22/07/2020	1179220	1179220	1179220		
57	I.	MEDIKAMENTE	22/07/2020	36904	36904	36904		
58	M.	MEDIKAMENTE	22/07/2020	195799	195799	195799		
59	M. SHPK	MIRB SKANERIT	30/07/2020	151899	151899	151899		
60	A. F.	MEDIKAMENTE	31/07/2020	105000	105000	105000		
61	H. SHPK	BUKE GRURI	31/07/2020	13947	13947	13947		
62	I. G. SH.A	ROJE PRIVATE	31/07/2020	326235	326235	326235		
63	M.	MEDIKAMENTE	04/08/2020	845341	845341	845341		
64	H. SHPK	BUKE GRURI	10/08/2020	35258	35258	35258		
65	H. SHPK	BUKE GRURI	10/08/2020	35258	35258	35258		
66	N. SHPK	ARTIKUJ USHQIMORE	10/08/2020	46230	46230	46230		
67	V. R.	MBETJE SPITALORE	10/08/2020	425712	425712	425712		

68	B. A.	MEDIKAMENTE	11/08/2020	928461	928461	928461		
69	N. SHPK	ARTIKUJ USHQIMORE	11/08/2020	216336	216336	216336		
70	E.	MEDIKAMENTE	20/08/2020	476700	476700	476700		
71	E.	MEDIKAMENTE	20/08/2020	7965	7965	7965		
72	E. SHPK	MONITORIM MJEDISI	27/08/2020	66000	66000	66000		
73	I. G. SH.A	ROJE PRIVATE	31/08/2020	326235	326235	326235		
74	M. A. G.	OKSIGJEN	02/09/2020	110592	110592	110592		
75	E. SHPK	MEDIKAMENTE	03/09/2020	312718	312718	312718		
76	T.	MEDIKAMENTE	04/09/2020	158400	158400	158400		
77	V. R.	EVADIM MBETJ SPITALORE	08/09/2020	67326	67326	67326		
78	E. SHPK	MEDIKAMENTE	11/09/2020	192000	192000	192000		
79	M. A. G.	OKSIGJEN	11/09/2020	110593	110593	110593		
80	E.	MEDIKAMENTE	16/09/2020	59328	59328	59328		
81	F.	MEDIKAMENTE	16/09/2020	114400	114400	114400		
82	R.F	MEDIKAMENTE	17/09/2020	70065	70065	70065		
83	M. A. G.	OKSIGJEN	18/09/2020	110592	110592	110592		
84	M. SHPK	MIRB SKANERIT	25/09/2020	147152	147152	147152		
85	M.	MEDIKAMENTE	28/09/2020	654000	654000	654000		
86	M. A. G.	OKSIGJEN	28/09/2020	110592	110592	110592		
87	M.	MEDIKAMENTE	29/09/2020	10668	10668	10668		
88	S...D	MEDIKAMENTE	29/09/2020	395364	395364	395364		
89	4.	MISH PULE	30/09/2020	10080	10080	10080		
90	4.	ARTIKUJ USHQIMORE	30/09/2020	135528	135528	135528		
91	N. SHPK	ARTIKUJ USHQIMORE	30/09/2020	46230	46230	46230		
92	I. G. SH.A	ROJE PRIVATE	05/10/2020	326235	326235	326235		
93	M. A. G.	OKSIGJEN	07/10/2020	88473	88473	88473		
94	V. R.	MBETJE SPITALORE	07/10/2020	261954	261954	261954		
95	M. A. G.	OKSIGJEN	12/10/2020	110592	110592	110592		
96	I. SHPK	MEDIKAMENTE	13/10/2020	93805	93805	93805		
97	A. N. F.	MEDIKAMENTE	14/10/2020	100350	100350	100350		
98	M.	MEDIKAMENTE	14/10/2020	158840	158840	158840		
99	G.	MEDIKAMENTE	16/10/2020	72600	72600	72600		
100	F.	MEDIKAMENTE	19/10/2020	13392	13392	13392		
101	A. F.	MEDIKAMENTE	21/10/2020	145780	145780	145780		
102	A. F.	MEDIKAMENTE	21/10/2020	914065	914065	914065		
103	M. A. G.	OKSIGJEN	21/10/2020	110592	110592	110592		
104	M.	MEDIKAMENTE	22/10/2020	68388	68388	68388		
105	R.F	MEDIKAMENTE	22/10/2020	23570	23570	23570		
106	E.	MEDIKAMENTE	26/10/2020	24100	24100	24100		
107	M. SHPK	MIRB SKANERIT	26/10/2020	147152	147152	147152		
108	M. SHPK	MIREMBATJA SKANERIT	26/10/2020	147152	147152	147152		
109	A. N. F.	MEDIKAMENTE	27/10/2020	48200	48200	48200		
110	A. F.	MEDIKAMENTE	27/10/2020	608400	608400	608400		
111	A. F.	MEDIKAMENTE	28/10/2020	327600	327600	327600		
112	R.F	MEDIKAMENTE	28/10/2020	46655	46655	46655		
113	M. A. G.	MEDIKAMENTE	29/10/2020	88473	88473	88473		
114	4.	MISH PULE	30/10/2020	25872	25872	25872		
115	4.	BUKE GRURI	30/10/2020	20295	20295	20295		
116	4.	ARTIKUJ USHQIMORE	30/10/2020	101784	101784	101784		
117	I. G.	SIGURIA E OBJEKTIT	31/10/2020	326235	326235	326235		
118	POSTA	POSTA	31/10/2020	2905	2905	2905		
119	N. SHPK	ARTIKUJ USHQIMORE	02/11/2020	33582	33582	33582		
120	D.	LAVANTERI	05/11/2020	2738203	2738203	2738203		
121	M. A. G.	OKSIGJEN	06/11/2020	88473	88473	88473		
122	V. R.	MBETJE SPITALORE	11/11/2020	199038	199038	199038		
123	M. A. G.	OKSIGJEN	12/11/2020	110592	110592	110592		
124	A. SHPK	PELLET DRURI	18/11/2020	220500	220500	220500		
125	E. M.	TARIF SHERBI PERMBARIM	18/11/2020	18000	18000			18000
126	M. A. G.	OKSIGJEN	20/11/2020	105062	105062	105062		
127	DIETA	URDHER SHERBIME	MAJ-NENTO	5023710	5023710	5023710		
128	V.	MEDIKAMENTE	06/11/2020	386	386	386		
129	E. SHPK	MEDIKAMENTE	06/11/2020	211200	211200	211200		
130	E. SHPK	MEDIKAMENTE	06/11/2020	334612	334612	334612		
131	E.	MEDIKAMENTE	27/10/2020	28850	28850	28850		
132	R.F	MEDIKAMENTE	2019	33666	33666			33666
133	E.	MEDIKAMENTE	09/11/2020	136200	136200	136200		
134	E.	MEDIKAMENTE	09/11/2020	12000	12000	12000		
135	E.	MEDIKAMENTE	09/11/2020	72300	72300	72300		
136	F. A.	MEDIKAMENTE	12/11/2020	29670	29670	29670		
137	S...K	UJE	30/11/2020	203183	203183	203183		

138	R.F	MEDIKAMENTE	2019					
139	V.	SHERBIME TE TJERA	28/03/2018				2,190	2,190
140	F. SHPK	KOMPJUTERA	07/08/2018				390,000	390,000
141	S. SHPK	SHERBIME TE TJERA	10/09/2018				14,000	14,000
142	V.	PROTOKSID AZOTI	13/09/2018				45,684	45,684
143	Q.	MIREMB PAJIS MJEKES	19/03/2019				9,900	9,900
144	S. T	ARTIKUJ USHQIMORE	31/03/2019				9,532	9,532
145	Q.	MIREMB PAJIS MJEKES	10/04/2019				6,600	6,600
146	Q.	MIREMB PAJIS MJEKES	10/04/2019				6,600	6,600
147	Q.	MIREMB PAJIS MJEKES	10/04/2019				6,600	6,600
148	P.S. SHPK	MIREMB PAJIS MJEKES	02/05/2019				323,760	323,760
149	Q.	MIREMB PAJIS MJEKES	02/05/2019				16,500	16,500
150	Q.	MIREMB PAJIS MJEKES	01/08/2019				6,600	6,600
151	Q.	MIREMB PAJIS MJEKES	22/08/2019				7,000	7,000
152	Q.	MIREMB PAJIS MJEKES	22/08/2019				3,300	3,300
153	M.	MEDIKAMENTE	18/09/2019				30,150	30,150
154	Q.	MIREMB PAJIS MJEKES	01/10/2019				13,200	13,200
155	V. R.	MBETJE SPITALORE	10/02/2021				108,892	108,892
156	I. G.	SIGURIA E OBJEKTIT	28/02/2021				326,236	326,236
157	N.	ARTIKUJ USHQIMORE	12/03/2021				19,884	19,884
158	E.	MEDIKAMENTE	31/03/2021				32,294	32,294
159	I. G.	SIGURIA E OBJEKTIT	31/03/2021				326,236	326,236
160	N.	ARTIKUJ USHQIMORE	01/04/2021				25,020	25,020
161	V. R.	MBETJE SPITALORE	10/04/2021				137,863	137,863
162	N.	ARTIKUJ USHQIMORE	11/04/2021				12,150	12,150
163	I. G.	SIGURIA E OBJEKTIT	30/04/2021				326,236	326,236
164	V. R.	MBETJE SPITALORE	07/05/2021				131,800	131,800
165	V. R.	MBETJE SPITALORE	07/05/2021				146,315	146,315
166	I. G.	SIGURIA E OBJEKTIT	15/05/2021				147,365	147,365
167	A. K.	SUPERVIZ I PEDIATRIS	24/05/2021				74,000	74,000
168	A.	MIREMBAJ AUTOMJETI	12/06/2021				67,200	67,200
169	K.	GAZOIL	12/06/2021				919,380	919,380
170	N.	ARTIKUJ USHQIMORE	31/07/2021				13,926	13,926
171	V. R.	MBETJE SPITALORE	04/08/2021				151,903	151,903
172	C. C.	ANTIVIRUS	11/08/2021				85,200	85,200
173	V. R.	MBETJE SPITALORE	30/08/2021				179,438	179,438
174	M. A. G.	OKSIGJEN	01/09/2021				49,766	49,766
175	A.	MIREMBAJ AUTOMJETI	12/09/2021				25,800	25,800
176	M. A. G.	OKSIGJEN	13/09/2021				99,533	99,533
177	N.	MIREMB SIST HIDRAU	13/09/2021				329,580	329,580
178	M. A. G.	OKSIGJEN	16/09/2021				49,766	49,766
179	N.	ARTIKUJ USHQIMORE	20/09/2021				44,976	44,976
180	N.	ARTIKUJ USHQIMORE	20/09/2021				44,976	44,976
181	M. A. G.	OKSIGJEN	21/09/2021				49,766	49,766
182	N.	OKSIGJEN	22/09/2021				105,996	105,996
183	S. C.	MATERIALE KONSUMI	22/09/2021				75,600	75,600
184	M. A. G.	OKSIGJEN	24/09/2021				99,533	99,533
185	A.	MIREMBAJ AUTOMJETI	18/10/2021				117,600	117,600
186	V. R.	MBETJE SPITALORE	26/10/2021				107,325	107,325
187	D. D.	ARTIKUJ USHQIMORE	29/10/2021				71,688	71,688
188	M. C.	ARTIKUJ USHQIMORE	29/10/2021				32,472	32,472
189	M. C.	ARTIKUJ USHQIMORE	29/10/2021				10,368	10,368
	Shuma			**33,676,509**	**33,676,509**	**33,308,822**	**5,437,699**	**5,805,386**

Referuar analizës së gjendjes së llogarive të klasës 4 të detyrimeve afatshkurtra ku në fund vitin 2021 rezulton me një gjendje si: llog.401-404 "Furnitorë e llogari të lidhura me to" në vlerën prej 18,556,689 lekë dhe llog. 467 "Kreditorë të ndryshëm" në vlerën prej 5,805,386 lekë, në total 24,362,075 lekë, pavarësisht se ka një trend ulje e vitit ushtrimor 2021 në krahasim me vitin paraardhës 2020, përsëri gjendja e detyrimeve ndaj të tretëve e mbetur në fund të vitit 2021 është e knsiderueshme, e cila ka ardhur si rezultat i mungesës së fondeve apo kryerjes me vonesë të procedurave të prokurimit, të ardhjes me vonesë të faturave si dhe vendosjes së limiteve të arkës nga Thesari.

Titulli i Gjetjes	Mbi pagesat nëpërmjet bankës të faturave të mbërritura mbi afatin 30 ditor.
Situata:	Referuar analizës së gjendjes së llog.401- 404 "Furnitorë e llogari të lidhura me to", në fund vitin 2021 rezulton me një gjendje prej ***18,556,689 lekë*** në të cilën janë akumuluar fatura të palikuiduara të viteve 2019, 2020 dhe 2021, të cilave u ka kaluar afati 30-ditor i pagesës së këtyre faturave.
Kriteri:	-ligji nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 52[3], -ligji nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" neni 6 "Afati".
Ndikimi/Efekti:	Vonesat në likuidime për shpenzimet sjellin akumulim të borxhit të institucionit për fatura të pa likuiduara.
Shkaku:	Likuidimi me vonesë i faturave në tejkalim të afatit ligjor prej 30 ditësh i pjesës më të madhe të rasteve ka rezultuar nga vetë institucioni për mungesë likuiditetesh. Një pjesë e rasteve ka ardhur edhe si rezultat i vendosjes së limit të kufizuar të arkës për likuidim nga MFE në fund të viteve ushtrimore 2020-2021,duke shtyrë radhën e likuidimeve.
Rëndësia:	I mesëm
Rekomandim:	Spitali Sarandë të marrë masa për sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos krijojë kufizime limiti të arkës *(përjashtuar kufizimet e MFE)*, për likuidimin e faturave në kohë, me qëllim mos krijimin e borxhit për fatura të pa likuiduara dhe futjen e institucionit në vështirësi financiare.

Analizë e llogarive sipas zërave të të ardhurave dhe shpenzimeve me klasifikim sipas natyrës ekonomike të pasqyruara në Formatin nr.2 "Pasqyra e përformancës financiare"(Aneksi nr.B/9) të PF të vitit 2021 paraqitet më poshtë:

Formati nr.2 "Pasqyra e përformancës financiare"

Nr. rreshti	Nr. Llogarise	P E R S H K R I M I I OPERACIONEVE	VITI USHTRIMOR 2021	VITI I MEPARSHEM 2020
a	b	c	1	2
1	**A**	**TE ARDHURAT**	**339.897.950**	**289.589.577**
2	***70***	***I.TE ARDHURAT NGA TAKSAT E TATIMET***	**0**	**0**
34	***71***	***III.TE ARDHURA JO TATIMORE***	**8.978.832**	**9.352.550**
39	**711**	**2.Sherbimet Administrative dhe te Ardhura Sekondare**	**8.978.832**	**9.352.550**
40	7110	Tarifa administrative dhe rregullatore		
41	7111	Te ardhura sekondare e pagesa shërbimesh	8.978.832	9.352.550
47	**719**	**3.Te tjera te ardhura jo tatimore**		
48	***76***	***IV.TE ARDHURA FINANCIARE***	**0**	**0**
55	7200	Nga Buxheti per NJQP(Qendrore)	290.768.248	220.262.282
61	7206	Financim I pritshëm nga buxheti	40.150.870	59.974.745
64	**721**	**2.Grant korrent I Huaj**	**0**	**0**
67		***VI.TE ARDHURA TE TJERA***	0	0
73	***73***	***VII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT TE PRODUKTEVE***		**0**
74	**B**	**SHPENZIMET**	**338.098.119**	**274.549.243**
75	**600**	**I.PAGAT DHE PERFITIMET E PUNONJSEVE**	**180.650.154**	**141.242.006**
76	6001	Paga, personel I përhershëm	162.360.708	134.986.662
77	6002	Paga personel I Përkohshëm	422.909	806.011
78	6003	Shpërblime	17.866.537	5.449.333

[3]në të cilën përcaktohet se*: "Nëpunësit zbatues të njësive shpenzuese të qeverisjes së përgjithshme paraqesin në strukturën përgjegjëse të thesarit dokumentacionin justifikues të shpenzimeve për rastet e pagesave ndaj operatorëve ekonomikë, brenda 30 ditëve nga data e faturës origjinale të operatorit ekonomik."*

79	6009	Shpenzime te tjera per personelin	0	0
80	**601**	**II.KONTRIBUTE TE SIGURIMEVE**	**25.122.307**	**21.567.832**
81	6010	Kontributi I Sigurimeve Shoqërore	22.508.442	19.328.060
82	6011	Kontributi I Sigurimeve Shëndetësore	2.613.865	2.239.772
83	**602**	**III.BLERJE MALLRA E SHERBIME**	**130.919.080**	**116.820.359**
84	602	Mallra dhe shërbime te tjera	0	0
85	6020	Materiale zyre e te përgjithshme	2.447.640	5.228.467
86	6021	Materiale dhe shërbime speciale	41.397.701	29.894.563
87	6022	Shërbime nga te trete	52.716.590	57.576.873
88	6023	Shpenzime transporti	10.536.045	8.750.016
89	6024	Shpenzime udhëtimi	13.030.040	8.575.668
90	6025	Shpenzime per mirëmbajtje te zakonshme	9.956.064	6.236.422
94	6029	Shpenzime te tjera operative	835.000	558.350
95	**603**	**IV.SUBVECIONE**	**0**	**0**
101		**V.TRANSFERIME KORENTE**	**131.000**	**606.830**
112	**606**	**3.Transferime per Buxhetet familjare e Individë**	**131.000**	**606.830**
113	6060	Transferta Te paguara nga ISSH e ISKSH		
114	6061	Transferta Paguara nga Inst.Tjera e Org.Pusht.Vendor	131.000	606.830
115		**VI.SHPENZIME FINANCIARE**	**0**	**0**
130	***63***	***VIII.NDRYSHIMI I GJENDJES SE INVENTARIT***	**30.638.126**	**-5.687.784**
131		***IX.SHPENZIME TE TJERA***	**0**	
132	***85***	**TEPRICA OSE DEFICITI I PERIUDHES** ***(Rezultati I Veprimtarise se vitit Ushtrimor)***	**1.799.831**	**15.040.334**

<u>Analiza e llogarive të të ardhurave</u> për vitin 2021, të cilat në total janë në vlerën 339,897,950.lekë, si dhe referuar akt-rakordimit me Degën e Thesarit Sarandë paraqitet më poshtë:

- Gjendja e llogarisë ***711*** "***Shërbimet Administrative dhe të Ardhura Sekondare"*** paraqitet në vlerën 8,978,832 lekë. Kjo vlerë rakordon me akt-rakordimin me Thesarin në këtë zë të ardhurash sipas kodifikimit të Thesarit.
- Gjendja e llogarisë ***7200 "Nga Buxheti per NJQP (Qendrore)"*** paraqitet në vlerën 290.768.248 lekë, e cila përfshin fondet e akorduara nga Ministria e Shëndetësisë.

Konkluzion: Gjendja e llogarisë së fondeve ***7206 "Financim i pritshëm nga buxheti"*** në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën prej 40.150.870 lekë, e cila nuk rakordon me gjendjen në vlerën 34.345.484 lekë të llogarisë analoge 4342 *"Operacione me shtetin (të drejta)"* në bilancit. Këto veprime janë në kundërshtim me detyrimet në pasiv të bilancit janë të sakta dhe reale. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Aneksi 1 "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik" **Pika 3.3** "Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4) nënpika 8 "Llogaritë e marrëdhënieve me shtetin" në të cilën përcaktohet se: *Llogaria 4342, "Operacione me shtetin (të drejta)" është një llogari që në PF të sektorit publik paraqitet në rubrikën e të drejtave dhe përfaqëson detyrimin që shteti i ka institucionit për shpenzime të konstatuara gjatë periudhës ushtrimore, por ende të papaguara (grantet korrente apo kapitale merren nga buxheti i shtetit). Raste specifike të tilla mund të jenë këto (por jo vetëm) si: pagat dhe sigurimet shoqërore e shëndetësore apo ndonjë detyrim për tatimin mbi të ardhurat që konstatohen si shpenzime në muajin dhjetor të vitit, por paguhen nga buxheti i vitit të ardhshëm. Veprimet kontabël në lidhje me këtë llogari janë si më poshtë:*

a) Gjatë konstatimit të shpenzimit është bërë veprimi: - Debitohen llogaritë respektive të klasës 6, "Shpenzime sipas natyrës"; - Kreditohen llogaritë e detyrimeve për konstatimin e detyrimit (42, 43, 40 e të tjera).

b) Në fund të periudhës duhet të bëhet veprimi: Debitohet llogaria 4342, "Operacione me shtetin (të drejta)"; Kreditohet llogaria 7206, "Financim i pritshëm nga buxheti".

c) Me akordimin e fondeve vitin e ardhshëm dhe ekzekutimin e pagesës bëhet veprimi: - Debitohen llogaritë përkatëse të detyrimeve (klasa 4); - Kreditohet llogaria 520, "Disponibilitete në thesar".

Titulli i Gjetjes	Pozicionimi dhe veprimet e gabuara kontabël
Situata:	Gjendja e llogarisë së fondeve ***7206 "Financim i pritshëm nga buxheti"*** në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 40,150,870 lekë, e cila nuk rakordon me gjendjen në vlerën 34,345,484lekë të llogarisë analoge 4342 *"Operacione me shtetin (të drejta)"* të bilancit.
Kriteri:	-Udhëzimi i MFE nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Aneksi 1 "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik" **Pika 3.3** "Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4) nënpika 8 "Llogaritë e marrëdhënieve me shtetin".
Ndikimi/Efekti:	Pozicionimi dhe veprimet e gabuara kontabël në llogaritë e fondeve, të cilat nuk rakordojnë me llogaritë e detyrimeve që ka shtet afatshkurtra në pasiv të bilancit kanë sjellë një ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e njësive shpenzuese në marrëdhënie me shtetin, duke paraqitur risk në besueshmërinë dhe përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.
Shkaku:	Drejtoria e Financës nuk ka marrë masat e nevojshme për mbajtjen e evidencës kontabël në përputhje me parimet e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandim:	Drejtoria e Financës të kryejë veprimet e sistemimit kontabël të llogarisë së gjendjes fondeve ***7206 "Financim i pritshëm nga buxheti"*** në fund të vitit 2021, të paraqitur gabim në pasqyrën e performancës, duke e rakorduar me gjendjen llogarisë 4342 *"Operacione me shtetin (të drejta)"*në aktiv të bilancit. Këto veprime ti kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2021 si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2022 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël.

<u>Analiza e llogarive të shpenzimeve</u> në vitin 2021, të cilat në total janë në vlerën 338,098,119 lekë paraqitet më poshtë:
- Gjendja e llogarisë ***600 'Paga, shpërblime e të tjera personeli"*** paraqitet në vlerën **180,650,154** lekë, e cila përputhet me akt-rakordimin me thesarin për këtë artikull shpenzimesh.
- Gjendja e l0logarisë ***601 'Kontribute për sigurime"*** paraqitet në vlerën 25,122,307 lekë, e cila përputhet me akt-rakordimin me thesarin për këtë artikull shpenzimesh.
- Gjendja e llogarisë ***602 "Blerje mallra e shërbime"*** paraqitet në vlerën 130,919,080 lekë , e cila përputhet me akt-rakordimin me thesarin për këtë artikull shpenzimesh.

Per vitin 2021 totali i te ardhurave ne vlere është 339,897,950 lekë dhe totali shpenzimeve eshte 338,098,119 .lekë. Diferenca e tyre ne vlerën 1,799,831 lekë rakordon me gjendjen e llog.85 "Rezultatin e ushtrimit".

Konkluzion: Gjendja e llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit" paraqitet në vlerën **30,638,126 lekë** e cila nuk rakordon me ndryshimin e gjendjeve të llogarive të klasës 3 **"Gjendja e inventarit qarkullues"** të aktiveve qarkulluese në formatin 1 të bilancit, të cilat paraqiten në mbyllje të vitit 2020 në vlerën **31,913,704** lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën **30,638,126** lekë, ku diferenca e tyre në zbritje është në vlerën prej **-1,275,578** lekë, duke

ndikuar në saktësinë e informacionit kontabël të ofruar. Këto veprime janë në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar, **Aneksi 1.** "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik"**, pika 4** " Shpenzimet, të ardhurat dhe operacionet që lidhen me to në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" (Përbërja dhe trajtimi kontabël i llogarive të klasave 6, 7 dhe 8)."

Llogaria 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit. *Kjo kategori ka veçori për sektorin publik, se nuk është element që ndikon në rezultat, por nëpërmjet operacioneve të transferimit ndikon sipas rastit në shtesë apo pakësim të fondeve bazë të institucioneve. Funksionimi kontabël është si më poshtë:*

a) Kur blihen, bëhen hyrje materialet:

- *Debitohet klasa 3 "Gjendje inventari qarkullues";*
- *Kreditohet 63 "ndryshimi i gjendjes së inventarit".*

b) Kur bëhen dalje materialet: • *Debitohet 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit";*

- *Kreditohet klasa 3 "Gjendje inventari qarkullues".*

Titulli i Gjetjes	Gjendja e llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventait"
Situata:	***Gjendja e llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit"*** paraqitet në vlerën **30,638,126 lekë** e cila nuk rakordon me ndryshimin e gjendjeve të llogarive të klasës 3 "Gjendja e inventarit qarkullues" të aktiveve qarkulluese në formatin 1 të bilancit, të cilat paraqiten në mbyllje të vitit 2020 në vlerën **31,913,704** lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën **30,638,126** lekë, ku diferenca e tyre në zbritje është në vlerën prej - **1,275,578** lekë, duke ndikuar në saktësinë e informacionit kontabël të ofruar.
Kriteri:	Udhëzimi i MFE nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar, Aneksi 1. "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik", pika 4 "Shpenzimet, të ardhurat dhe operacionet që lidhen me to në njësitë e qeverisjes së përgjithshme (Përbërja dhe trajtimi kontabël i llogarive të klasave 6, 7 dhe 8)."
Ndikimi/Efekti:	Paraqitje dhe raportim jo i saktë në pasqyrat financiare.
Shkaku:	Nga Sektori i Financës nuk janë marrë masat e nevojshme për analizimin dhe saktësimin në kontabilitet duke mbledhur e evidentuar të dhënat nga gjithë dokumentacioni financiar i trashëguar në vite.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandim:	Drejtoria e Financës të kryejë veprimet e sistemimit kontabël të ***llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit",*** nëpërmjet saktësimit të gendjeve të llogarive të klasës e të inventarit qarkullues. Këto veprime ti kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2021 si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2022 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë të llogarisë të ndryshimit të gjendjeve dhe të efekteve që shkaktojnë në llogaritë e fondeve bazë

<u>Nga testi kontrollit për vitin 2021 në lidhje me veprimet me arkë dhe me bankë:</u>
<u>Rregullariteti i veprimeve me arkë</u> nga ku rezultoi se:

Veprimet me arkë kryhen vetëm për rastet e arkëtimit të taksave dhe tarifave vendore në njësinë administrative dhe pagesat e kopshteve dhe çerdheve. Gjendja e arkës nuk e kalon limitin e

arkës. Për të gjitha arkëtimet ditore bëheshin derdhjet në bankë në llogarinë likuiduese të institucionit.
Nga auditimi u konstatua se dokumentet ishin plotësuar konform nenit 4, pika 6, 25 dhe 26 të ligjit nr.10296, datë 08.07.2010 *"Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"* dhe kreut III pika 34 dhe 35 germat a, b dhe c të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 *"Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik"* dhe në përmbushje të kërkesave të pikës 3 të ligjit nr.290, datë 14.06.1993 *"Për limitin e arkës"*.

Ligjshmëria dhe saktësia e veprimeve dhe ngjarjeve të kryera nëpërmjet bankës në lekë
Transaksionet financiare të kryera nëpërmjet bankës janë regjistruar në mënyrë kronologjike në ditarin e bankës në bazë të urdhër-shpenzimeve të cilat ishin të nënshkruara nga nëpunësi autorizues dhe zbatues të konfirmuar nga nëpunësi i Thesarit dhe të vulosura nga të dy palët.
Përpilimi i urdhër-shpenzimeve ishte i bazuar në dokumentet vërtetues dhe autorizues sipas natyrës së shpenzimit si urdhër prokurimi, procesverbale, oferta, kontrata, fatura e furnitorit, preventiva, situacione, fletëhyrje, listpagesa, deklarimet e tatimit mbi të ardhurat, formularët e përllogaritjeve të kontributeve të sigurimeve shoqërore dhe shëndetësore si nga punëdhënësi dhe nga punonjësi, etj.Vlerat e shënuara në urdhër-shpenzim përputhen me vlerat e këtyre dokumenteve financiare që mbështesin këtë shpenzim.
Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës është bërë në mënyrë të saktë sipas destinacionit dhe sipas natyrës së shpenzimeve. Veprimet regjistrohen në programin Exel.
Për periudhën objekt auditimi nëpërmjet bankës janë kryer pagesa në vlerën 31,227 lekë, gjoba nga tatimet për deklarime të vonuara të sigurimeve shëndetësore.
Totali i shpenzimeve mujore dhe progresive kuadronin me konfermat bankare mujore. Nga verifikimi një për një i shumave të urdhër-shpenzimeve për periudhën 12-mujore rezultoi se totali është i barabartë me shumën e totale të shpenzimeve të akt-rakordimit përfundimtar të shpenzimeve me thesarin. Kontabilizimi i veprimeve ekonomike nëpërmjet bankës sipas destinacionit dhe natyrës së shpenzimeve është bërë i saktë. Në fund të çdo viti ushtrimor është bërë rakordimi i llogarive që preken dhe është bërë prerja e artikujve kontabël.

Mbi zbatimin e rregullshmërisë dhe ligjshmërisë në administrimin dhe qarkullimin e vlerave materiale.

Veprimet nëpërmjet magazinës
-Mbajtja e kontabilitetit për hyrjet dhe daljet e materialeve bëhej në ditarin e magazinës, në formë dokumentare dhe informatike. Çdo regjistrim kontabël bëhej sipas dokumentacionit bazë si flet-hyrjeve dhe fletë-daljeve të magazinës dhe faturave të shitësit. Dokumentacioni bazë ishte i konfirmuar nga magazinieri dhe marrësi në dorëzim. Nga verifikimi i disa veprimeve me zgjedhje rezultoi se veprimet ishin kontabilizuar saktë.
-Fletë daljet e magazinës janë hartuar dhe firmosur nga magazinieri, ku për mallra të ndryshëm ishin të shoqëruara me autorizim e plan-shpërndarje të miratuara.
-Nuk janë mbajtur të dhëna për aktivet për një pjesë të tyre si: viti i krijimit, shtesat dhe pakësimet për to, pra nuk është mbajtur një libër i mirëfilltë historik me të gjitha të dhënat e aktiveve të trupëzuara sipas modelit klasik të trajtuar më lart, domosdoshmëri kjo për të patur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit në përputhje me kap III pika 30, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".
- Janë hapur kartela e zyrave për inventarin ekonomik dhe objektet e inventarit të tërhequr nga magazina, në mënyrë që sektori ekonomik të sigurojë kontrollin e këtyre vlerave materiale gjatë kohës, që ata i kanë në ngarkim dhe të evidentojë nxjerrjen e përgjegjësisë në çdo rast të lëvizjeve, të shpërdorimeve, të dëmtimeve apo humbjeve.

Titulli i Gjetjes	Mbi mbajtjen e regjistrit historik të aktiveve dhe llogaritjen e amortizimit të tyre.

Situata:	- Nuk janë mbajtur të dhëna për aktivet për një pjesë të tyre si: viti i krijimit, shtesat dhe pakësimet për to, pra nuk është mbajtur një libër i mirëfilltë historik me të gjitha të dhënat e aktiveve të trupëzuara sipas modelit klasik të trajtuar më lart, domosdoshmëri kjo për të patur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit
Kriteri:	UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" kap III, pika 30.
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e informacionit të plotë për AAGJM në lidhje me vlerën fillestare shtesat, pakësimet, amortizimin e akumuluar dhe vlera e mbetur (neto) aktiv për aktiv me ndikim në informacionin kontabël që ofrojnë pasqyrat financiare në lidhje me plotësinë e vlerave të Aktiveve Afatgjata Materiale, duke paraqitur risk në sigurinë e arsyeshme dhe besueshmërinë e evidencës kontabël për përdorimin e tyre nga subjektet e interesuara.
Shkaku:	Nga Sektori i Financës nuk janë marrë masat e nevojshme për mbajtjen e regjistrit historik të AAGJM,kryerjen e procedurave të plota të inventarizimit si dhe llogaritjen e amortizimit aktiv për aktiv mbi bazë historiku të krijimit të tij.
Rëndësia:	E lartë
Rekomandim:	Sektori i Financës të hartojë një regjistër të plotë historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, vend-ndodhjen, përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur. Mbi bazën e tij të llogarisë amortizimin aktiv për aktiv si edhe të realizojë inventar fizik për të gjithë AAGJ, për verifikimin e ekzistencës fizike e tyre.

-*Mbi rregullshmërinë e veprimeve të kryera nëpërmjet bankës*, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
- Veprimet e kryera nga Banka, dokumentacioni justifikues.
- Urdhër shpenzimet me dokumentet shoqërues.
- Ditari i bankës, etj

Janë audituar veprimet e bankës për vitin 3- mujorin e IV të vitit dhe 3- mujori I i vitit 2021, 3- mujori I dhe II i vitit 2019 dhe 3-mujori II dhe IV i viti 2020, nga ku u konstatua se pagesat janë kryer bazuar në urdhrat e titullarit si për blerje, shërbime, etj, bashkëlidhur dokumentacioni justifikues.
Dokumentacioni i bankës është i plotësuar dhe veprimet janë pasqyruar kronologjikisht. Urdhër shpenzimet janë të shoqëruara me dokumentacionin vërtetues dhe justifikues.
Veprimet financiare janë kontabilizuar në ditarët e hyrjeve dhe daljeve të llogarisë bankare, sipas kërkesave të kontabilitetit. Çdo muaj është bërë kuadrimi i ditarit të bankës dhe urdhërpagesat janë pasqyruar drejt nëpër llogaritë sintetike e analitike, sipas natyrës së shpenzimit, duke vepruar konform me Ligjin nr. 9228, datë 29.04.2004 "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", i ndryshuar, dhe me Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik", i ndryshuar, kreu III "Regjistrimi i aktiveve dhe dokumentimi i lëvizjes së tyre"/"Dokumentimi i lëvizjes së aktiveve".

Titulli i Gjetjes	Mos plotësimi i dokumenteve kontabël në përputhje me ligjin.
Situata:	Nga departamenti i financës, regjistrimet e veprimeve kontabël, janë

	kryer me regjistra ose në programin Excel dhe jo me "Bartës informatikë", të cilët janë programe informatike të pa manipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë, gjë e cila ndikon në pasaktësi gjatë procesit të regjistrimit të dokumenteve financiarë, si dhe gabime gjatë kuadrimit të veprimeve kontabël.
Kriteri:	ligji nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 3, pika 14 që përcakton mënyrën se si mbahet dokumenti kontabël dhe pikën 15 për "Bartësit kontabël" Neni 3 Përkufizime, neni 7. Dokumenti kontabël dhe neni 8.
Ndikimi/Efekti:	Mungesa e programit kompjuterik në hedhjen e të dhënave në shërbimin kontabël, ndikon në ngadalësimin e marrjes dhe përpunimit të informacioneve financiare, si dhe në cilësinë dhe saktësinë e evidencave kontabile dhe të pasqyrave financiare.
Shkaku:	Sektori Financës dhe strukturat drejtuese nuk kanë vlerësuar pajisjen me program kompjuterik.
Rëndësia:	E mesme
Rekomandim:	Strukturat drejtuese të Spitalit Sarandë të marrin masa për evidentimin më të saktë të veprimeve në kontabilitet, nëpërmjet prokurimit të një programi financiar me qëllim përmirësimin e mbajtjes së skedave të kontabilitetit, për të rritur cilësinë e regjistrimit, përpunimit dhe hartimit të pasqyrave financiare.

2.5. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në prokurimet e fondeve publike, lidhjen dhe zbatimin e kontratave të mallrave, shërbimeve dhe punimeve civile.

Programimi i nevojave, përgatitja e regjistrit të prokurimeve

Nevojat për prokurime janë realizuar duke marrë për bazë kërkesat nga secili sektor përfitues malli/shërbimi apo planit të investimeve të parashikuara për vitin ushtrimore. Programi i nevojave është bërë mbi bazën e një studimi të nevojave reale që ka çdo pavion i spitalit për medikamente, materilae mjekimi, shërbime e punë të ndryshme duke marë për bazë konsumin e viteve të mëparshme, raportin e statisikave të spitalit si dhe kërkesat nga çdo pavion.

1. Mbi auditimin e procedurës së prokurimit "Blerje lëndë djegëse për ngrohje-Pellet, për vitin 2019".

Blerja e lëndës djegëse është argumentuar në nevojën e spitalit për këtë produkt, në mungesë të alternativave të tjera për ujë të ngrohtë. Sasia 57240 kg për blerje, është përllogaritur mbi bazën e konsumit në periudha të mëparshme, për periudhën 1 janar deri 15 mars dhe 15 nëntor deri 31 dhjetor. Fondi është parashikuar në buxhetin e institucionit.
Për përllogaritjen e fondit limit është mbajtur procesverbali datë 07.01.2019, nga komisioni i përbërë nga z. M. B, znj. S. G dhe znj. L. I. Çmimi 49 lekë/kg i aplikuar është bazuar në kontratën e mëparshme të lidhur me autoritetin kontraktor, konkretisht për vitin 2018. Në përllogaritjen e fondit limit nuk janë marrë për bazë alternativat e tjera siç janë çmimet e botuara nga INSTAT apo, çmimet e tregut, pasi në çmimin e vendosur krahas materialit pellet, është përfshirë edhe shërbimi i kaldajës i cili duhet të sigurohet nga operatori ekonomik.
Nga ana e institucionit nuk është bërë asnjë studim mbi mundësinë e prokurimit të materialit pellet më vehte dhe shërbimit të kaldajës më vehte, për të rritur konkurueshmërinë dhe prokurimin me sa më ekonomicitet, por janë prokuruar edhe blerja edhe shërbimi së bashku, proces i cili kryhet nga një numër i kufizuar operatorësh.

Në tender janë ftuar për të marrë pjesë në tender subjektet: “A. M.”, “I. P. ”, “A. ”, “N. M. ” dhe “I. “.

Tenderi ka të dhënat si më poshtë:

Procedura e Prokurimit: “Blerje lëndë djegëse për ngrohje-Pellet”.				
1. Urdhër Prokurimi nr. 34, datë 10.01.2019 2. lloji i Procedurës së Prokurimit Kërkesë për propozim	**3. njësia e prokurimit** M. B L. I (inxhinier) S. G		**4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave sipas Urdhrit nr. 41 prot., datë 14.01.2019.** F. Ll A. K V. D	
5. Fondi Limit (pa tvsh) 2,804,760 lekë	6. Oferta Fituese (pa tvsh) 2,804,760 lekë		**7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh)** 540,138 lekë	
8. Data e hapjes së ofertave 25.01.2019	**9. Burimi i Financimit** Financim nga buxheti		**10. Operatorët Ekonomikë** **1.** Shoqëria “L. P. ” nuk ka paraqitur ofertë ekonomike. **2.** OE “K. & C.” me ofertë me vlerë 2,804,760 lekë. **b.** Skualifikuar – 1 OE	
11. Ankimime -	**12. Përgjigje e ankesës nga AK** -		**13. Përgjigje ankesës nga KPP** -	
b.Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave				
14. lidhje e kontratës nr. 262 prot., datë 15.02.2019	**15. Vlera e kontratës (me tvsh)** 3,365,712 lekë		**16. Likuiduar** - lekë Pa likuiduar: - lekë	
17. Situacioni përfundimtar/faturë malli/shërbimi`	**18. Afati i kontratës në ditë.** Parashikuar 12 muaj Zbatuar: 12 muaj		**19. Zgjatja e kontratës me ditë** **Shkresa (amendamenti) nr. Datë** -	
20. Mbikëqyrësi i punimeve	**Licencë nr.**	**Kontrata**	**Likuiduar** **.....**	**Pa likuiduar** **lekë**
21. Kolaudatori i punimeve	**Licencë nr.**	**Kontrata**	**Likuiduar** **.....**	**Pa likuiduar** **.....**
22. Aktkolaudimi	**23. Akti i marrjes në dorëzim.**		**24. Fletë Hyrja**	

Titulli i gjetjes:	Komision i ngritur pa patur në përberje specialist të fushës.
Situata:	Sipas Urdhrit të Prokurimit nr. 34 prot., datë 10.01.2019, të titullarit të AK z. T. L, njësia e prokurimit përbëhet nga z. M. B me profesion financier, znj. L. I me profesion inxhinier elektrik dhe znj. S. G me profesion jursit. Ngritja e njësisë së prokurimit është bërë pa patur në përbërje një specialist të fushës. Komisioni i vlerësimit të ofertave për këtë procedurë është ngritur sipas Urdhrit të Titullarit të AK z. T. L nr. 41 prt., datë 14.01.2019, i përbërë nga z. F. Ll, znj. A. K dhe znj. V. D me profesion ekonomistë, pa patur në përbërje një specialist të fushës.
Kriteri:	VKM nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” (shfuqizuar) neni 57, pika 4, neni 58.
Ndikimi:	Nuk ka siguri, për trajtimin e çështjeve teknike, të cilat dalin gjatë zbatimit të procedurave.
Shkaku	Mos respektimi i akteve ligjore e nënligjore të prokurimit publik.
Rëndësia:	E mesme.

Rekomandim:	Drejtoria e Shëbimit Spitalor Sarandë, të marrë masa për krijimin e komisioneve me përbërje të paktën një specialist i fushës, në mënyrë që t'i japë zgjidhje problemeve teknike që lindin gjatë zbatimit të procedurave të prokurimit për realizimin e tyre me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet.

Ngarkohet me përgjegjësi ish-Titullari i AK z. T. L.

Titulli i gjetjes:	Kritere në kundërshtim me ligjin.
Situata:	Bazuar në procesverbalin për përcaktimin e specifikimeve dhe kritereve teknike të mbajtur nga njësia e prokurimit me datë 14.01.2019, në kriteret e përgjithshme është vendosur përcaktimi "Kërkohet që ofertuesi të paraqesë kontratë të ngjashme (me një vlerë deri në 40 % të vlerës së fondit limit që prokurohet), të realizuara gjatë tre viteve të fundit nga data e zhvillimit të procedurës së prokurimit. Vendosja e këtij kriteri, ofron mundësinë e plotësimit të tij edhe nga operatorë ekonomikë të cilat kanë eksperiencë shumë të vogël, duke nisur nga 1 %, duke vënë në dyshim zbatimin e kontratës. Ky veprim është në kundërshtim me dokumentet standard të tenderit, pasi kufiri i vlerës së punimeve të ngjashme nuk duhet të vendoset më i lartë se 40 % e vlerës së fondit limit. Vlera që duhet të paraqesin operatorët ekonomik nuk duhet të jetë më i vogël se kufiri i përcaktuar. Në kriteret teknike pika 2, është përcaktuar që OE duhet të ketë gjendje dy kaldaja për pellet (me fuqi 480 -500 KË) me disa nga karakteristikat të tilla si: Tipi KN-AT, fuqia motorike 1100 Ë, dimensionet (2750 mm x 2180 mm x 1720 mm), pesha 1850 kg, kapaciteti ditor i silozit 1.5 m^3. Në kriteret teknike pika 3, është kërkuar të ketë gjendje dy bruciatorë për pellet me karakteristika: Modeli BP 500 kË, dimensionet (380 x 420 x 1250 mm), shneku me diametër, 125 mm, fuqia e motorit të shnekut 190 W dhe dimensioni i tubit të shkarkarkimit 75 mm. Vendosja e specifikimeve si më sipër kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit, pasi për makineri të ndryshme dhe me dimensione të ndryshme nga ato të këkruara, mund të realizohet i njëjti proces, me të njëjtën prodhueshmëri, apo kapacitet.
Kriteri:	Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" (i shfuqizuar), neni 23, pika 2.
Ndikimi:	Nuk ka siguri, për trajtimin e çështjeve teknike, të cilat dalin gjatë zbtimit të procedurave.
Shkaku	Mos respektimi i akteve ligjore e nënligjore të prokurimit publik.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	Drejtoria e Shëbimit Spitalor Sarandë, të marrë masa për trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve që angazhohen me zbatimin e procedrurave të prokurimit, me synim realizimin e tyre me sa më ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet.

Ngarkohet me përgjegjësi Njësia e prokurimit e përbërë nga: z. M. B, znj. S. G dhe znj. L. I.

Titulli i gjetjes:	Kualifikim i OE, pa plotësuar dokumentet e tenderit.
Situata:	Në tender kanë marrë pjesë 2 OE, nga të cilët vetëm njëri OE ka paraqitur dokumentacion. OE "A." SHPK, shpallur fitues nuk ka paraqitur dokumentacion që të vërtetojë përputhshmërinë e

	specifikimeve teknike sa i takon dimensioneve të kaldajës, kapacitetit ditor të silozit, dimensionin e tubit të shkarkimit etj. Mangësitë e mësipërme ndikojnë në garancinë që jep makineria për përballimin e nevojave sipas kapacitetit të parashikuar.
Kriteri:	Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" (i shfuqizuar), neni 46, pika 1.
Ndikimi:	Nuk konsiderohet se ka patur ndikim, pasi kontrata është realizuar me sukses.
Shkaku	Mos respektimi i akteve ligjore e nënligjore të prokurimit publik.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandimi:	Drejtoria e Shëbimit Spitalor Sarandë, të marrë masa për trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve që angazhohen me zbatimin e procedrurave të prokurimit, me synim realizimin e tyre me sa më ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet.

Ngarkohet me përgjegjësi KVO e përbërë nga: z. F. Ll, znj. A. K, znj. V. D.

3. Mbi auditimin e procedurës së prokurimit me objekt "Rikonstruksion i Pediatrisë në Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Sarandë".

Tenderi ka të dhënat si më poshtë:

Procedura e Prokurimit: "Rikonstruksion i Pediatrisë në Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Sarandë".				
1. Urdhër Prokurimi nr. 1070, datë 02.09.2020 2. lloji i Procedurës së Prokurimit Kërkesë për propozim	**3. njësia e prokurimit** A. K S. G L. M		**4. Komisioni i Vlerësimit të Ofertave sipas Urdhrit nr. 122, datë 24.11.2020.** V. D V. M L. I	
5. Fondi Limit (pa tvsh) 4,918,148 lekë	6. Oferta Fituese (pa tvsh) 4,378,010 lekë		**7. Diferenca me fondin Limit (pa tvsh)** 540,138 lekë	
8. Data e hapjes së ofertave 08.12.2020	**9. Burimi i Financimit** Financim nga Buxheti		**10. Operatorët Ekonomikë** **1.** Shoqëria "C." me ofertë me vlerë 3,071,400 lekë. **2.** OE "K. & C." me ofertë me vlerë 4,303,940 lekë. **3.** Shoqëria "M."me vlerë oferte 4,393,490 lekë. **4.** Shoqëria "N. 8. " me vlerë oferte 4,378,010 lekë. **5.** OE R"R. C. ", me vlerë oferte 4,866,780 lekë. **6.** OE "E. K.", me vlerë 4,769,169 lekë. **7.** "V. K.", me vlerë oferte 4,608,140 lekë. **b.** Skualifikuar – 3 OE	
11. Ankimime -	**12. Përgjigje e ankesës nga AK** -		**13. Përgjigje ankesës nga KPP** -	
b.Zbatimi i Kontratës së Punimeve/Shërbimeve/Mallrave				
14. lidhje e kontratës nr. 111 prot., datë 01.02.2021	**15. Vlera e kontratës (me tvsh)** 5,253,612 lekë		**16. Likuiduar** - lekë Pa likuiduar: - lekë	
17. Situacioni përfundimtar/faturë malli/shërbimi` Vlera me TVSH 5,253,127 lekë Vlera pa TVSH 4,377,606 lekë	**18. Afati i kontratës në ditë.** Parashikuar 30 ditë Zbatuar: 30 ditë		**19. Zgjatja e kontratës me ditë Shkresa (amendamenti) nr. Datë** -	
20. Mbikëqyrësi i punimeve A. K.	**Licencë nr.**	**Kontrata nr. 265,**	**Likuiduar** **.....**	**Pa likuiduar** **lekë**

		datë 18.02.2020		
21. Kolaudatori i punimeve A. T	**Licencë nr.**	**Kontrata nr.265/1, datë 18.02.2020**	**Likuiduar .....**	**Pa likuiduar .....**
22. Aktkolaudimi 19.12.2020	**23. Akti i marrjes në dorëzim.** 19.12.2020		**24. Fletë Hyrja** Nr..... Datë.....Lekë	

Në tender janë ftuar të marrin pjesë subjektet: "N.–86.", "E.", "F. K.", "E. K." dhe "R. C.". Në tender kanë marrë pjesë 7 OE, nga të cilët për mangësi të paraqitura në dokumentacionin e ofertës janë skualifikuar 3 OE. Është shpallur fitues OE "N.-86." SHPK.

Procedura e rikonstruksionit të pediatrisë është argumentuar me faktin e amortizimit të lartë të ambienteve përbërëse. Dëmtimet e mureve, shtresave të pllakave, dyer e dritare, tavane etj., kanë bërë të domosdoshëm ndërhyrjen për rehabilitim. Fondi për realizimin e këtyre punimeve është parashikuar nga buxheti i institucionit.

Titulli i gjetjes:	Gabime në aplikimin e çmimeve për përllogaritjene fondit limit.
Situata:	Procesverbali për përllogaritjen e fondit limit është mbajtur me datë 02.09.2020. Fondi limit është bazuar në preventivin e përgatitur nga z. E. R, me licencë A.1279/1, me vlerë 4,918,148 lekë. Çmimet e preventivit, në përgjithësi janë aplikuar bazuar në manualet e çmimeve të ndërtimit, për rastet kur nuk ka referenca, janë hartuar analiza teknike. Nga verifikimi sipas zërit 2.204/1 "Bojë hidroplastike importi cilësi e parë", është aplikuar çmimi 471 lekë për m^2, ndërsa referuar manualeve të punimeve të ndërtimit 2015, çmimi është 431 lekë. Sipas zërit të mësipërm, fondi limit është rritur në mënyrë të pa argumentuar me vlerë 53,280 lekë [1332 m^2 (471 lekë/m^2 – 431 lekë/m^2)]. - Sipas zërit An.7 "F.V dyer druri me veshje MDF dhe me mbushje material termik" nga ana e z. E. R, në analizën e çmimit është përcaktuar vlera 30,000 lekë/m^2, ndërsa në preventiv është përcaktuar vlera 37,000 lekë/m^2. Sipas këtij zëri fondi limit është rritur në mënyrë të pa argumentuar me vlerë 175,000 lekë [25 m^2 x (37,000 lekë/m^2 – 30,000 lekë/m^2). - Sipas zërit An.8 "F.V portë duralumini me dyfish xham dhe me sistem elektronik për hapje" nga ana e z. E. R, në analizën e çmimit është përcaktuar vlera 30,000 lekë/m^2, ndërsa në preventiv është përcaktuar vlera 42,000 lekë/m^2. Sipas këtij zëri fondi limit është rritur në mënyrë të pa argumentuar me vlerë 76,800 lekë [6.4 m^2 x (42,000 lekë/m^2 – 30,000 lekë/m^2). Sa më sipër, fondi limit është rritur në mënyrë të pa argumentuar me vlerë 305,080 lekë. Duke qenë se kontrata është nënshkruar me vlerë 4,378,010 lekë, konsiderohet se veprimi i mësipërm nuk ka krijuar pasoja financiare.
Kriteri:	VKM nr. 514, datë 15.08.2007 "Për informatizimin e llogaritjes së kostos dhe hartimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, Pika 2.
Ndikimi:	Nuk ka patur ndikim, si pasojë e uljes së vlerës së kontratës.
Shkaku	Mos përcaktimi i saktë i çmimit të referencës.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandim:	Komisionet e përllogaritjes së fondit limit, duhet të aplikojnë çmime me referenca të sakta të manualeve teknike të çmimeve të punimeve të

	ndërtimit. Në rastet kur çmimi i referencës nuk është pjesë e çmimeve të manualit, atëherë duhet të merren për referencë çmimet e zërave më të përafërt, ose duke hartuar analiza të sakta të kostos.

Titulli i gjetjes:	Komision i ngritur pa patur në përberje specialist të fushës.
Situata:	Sipas Urdhrit të Prokurimit nr. 1070 prot., datë 02.09.2020, të titullarit të AK z. E. Dh, njësia e prokurimit përbëhet nga z. A. K me profesion ekonomist, znj. S. G me profesion jursit dhe z. L. M me profesion IT. Komisioni i vlerësimit të ofertave për këtë procedurë është ngritur sipas Urdhrit të Titullarit të AK z. E. Dh nr. 1329 prot., datë 24.11.2020, i përbërë nga z. V. M me profesion ekonomist, znj. L. I me profesion inxhinier elektrik dhe znj. V. D me profesion ekonomist, pra në asnjërin komision nuk është caktuar një specialist i fushës.
Kriteri:	VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (shfuqizuar) neni 57, pika 4, neni 58.
Ndikimi:	Nuk ka siguri, për trajtimin e çështjeve teknike, të cilat dalin gjatë zbatimit të procedurave.
Shkaku	Mos respektimi i akteve ligjore e nënligjore të prokurimit publik.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandim:	Drejtoria e Shëbimit Spitalor Sarandë, të marrë masa për krijimin e komisioneve me përbërje të paktën një specialist i fushës, në mënyrë që t'i japë zgjidhje problemeve teknike që lindin gjatë zbatimit të procedurave të prokurimit për realizimin e tyre me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet.

Ngarkohet me përgjegjësi ish-Titullari i AK z. E. Dh.

Titulli i gjetjes:	Kritere në kundërshtim me ligjin.
Situata:	Dokumentete e tenderit janë miratuar me datë 19.11.2020. APP nëpërmjet email të datës 24.11.2020, ka dërguar disa rekomandime mbi hartimin e kritereve të veçanta. Është kërkuar që shoqëria duhet të ketë të punësuar në stafin teknik për kryerjen e punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratën individuale të punës të vlefshme, diplomë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën gusht-tetor 2020, 1 inxhinier ndërtimi, një inxhinier hidroteknik dhe 1 inxhinier elektrik. Duke qenë se kemi të bëjmë me punime rikonstruksioni dhe në volume jo të konsiderueshme, është i mjaftueshëm që një OE të ketë të punësuar një inxhinier ndërtimi, ose inxhinier hidroteknik, madje punimet eketrike kanë të bëjnë vetëm me zëvendësime instalimesh, kërkesa për specialist elektrik është e mjaftueshme. Këkesat për tre inxhinierë të punësuar, mund të reduktojë numrin e operatorëve pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, sidomos të ndërmarrjeve të vogla që operojnë në fushën e ndërtimit.
Kriteri:	Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" (i shfuqizuar), neni 23, pika 2, neni 46, pika 3. VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (shfuqizuar) neni 26, pika 5
Ndikimi:	Nuk ka siguri, për trajtimin e çështjeve teknike, të cilat dalin gjatë zbtimit të procedurave.

Shkaku	Mos respektimi i akteve ligjore e nënligjore të prokurimit publik.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandim:	Drejtoria e Shërbimit Spitalor Sarandë, të marrë masa për trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve që angazhohen me zbatimin e procedrurave të prokurimit, me synim realizimin e tyre me sa më ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet.

Ngarkohet me përgjegjësi Njësia e Prokurimit e përbërë nga: znj. A. K, znj. S. G dhe z. L. M.

4. "*Shërbimi lavanterisë dhe hotelerisë për nevoja të Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Sarandë*", gjatë periudhës 08 Shtator 2021 deri më datë 07 Shtator 2023.

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: *Shërbimi lavanterisë dhe hotelerisë për nevoja të Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Sarandë*			
1. Lloji i Procedurës së Prokurimit **"**procedure e hapur" marveshje kuadër me afat 4-vjet Urdhri nr 723 datë 07/06/2021	**2 Njësia e Prokurimit** A. K S. G L. M	**3.1 KVO** Urdhri nr 723 datë 07/06/2021 F. S V. M V. D	**3.2 KSHA** Urdhër nr 883 prot. Datë 12.07.2021 L. I E. D M. Z Urdhër nr 144 prot. Datë 03.08.2021 F. S
4. Fondi Limit 97,256,679 lekë	**5. Oferta fituese** **96,880,898.8 lekë** **99.6% e fondit limit**	**6. Diferenca me fondin limit** 375,780.2 lekë	
7/1 Afati kohor dhe Data e hapjes së tenderit Data 01.07.2021 **7/2 Kohezgjatja 48 muaj**	**8. Burimi Financimit** Buxheti i shtetit	**9. Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender Numër**3** b) S'kualifikuar 2OE, c) Kualifikuar 1OE	

a. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

-Titullari i DSHSS z. E. Dh me urdhërin nr. 361 prot datë 05.03.2021 ka ngritur grupin e punës për hartimin e specifikimeve teknike, dhe përllogaritjen e fondit limit për procedurën *"Shërbimi lavanterisë dhe hotelerisë për nevoja të Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Sarandë". Grupi i punës ka pregatitur relacionin me nr. 625 prot datë 14.05.2021.*

Titullari i autoritetit kontraktor pas marrjes së relacionit ka nxjerr urdhërin e prokurimit nr. 723 prot date 07.06.2021 për procedurën e prokurimit *"Shërbimi lavanterisë dhe hotelerisë për nevoja të Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Sarandë" si dhe ka krijuar njësinë e prokurimit të përbër nga A. K, S. G dhe L. M.*

-Në përllogaritjen e fondit limit dhe sasive ne KG për mallrat e butë kemi disa pasaktësi në përllogaritjen e peshës nga grupi i punës kryesisht ne pavionin e pediatrisë ku përmasat e çarçafëve, batanijes apo jorganit nuk janë të njëjta me ato të një shtrati normal duke fryrë fondin limit me efekt financiar për buxhetin e shtetit, kjo e konfirmuar edhe nga proceverbal kolaudimi i përmuajshëm mbajtur mes grupit të monitorimit të kontratës dhe Operatorit ekonomik fitues ku kanë rezultuar pesha të tjera për këto zëra. Gjithashtu bie ndesh dhe me vetë specifikimet e këtyre produkteve të hartuara nga ky komision. Në faqen 19 dhe 20 të relacionit nr, 625 prot datë 14.05.2021 duken **qartë diferencat në përmasa** të batanijeve çarçafëve zarf apo çarçafëve normal dhe këllëf dysheku midis atyre për të rritur dhe fëmijëve apo nenonat.

Material i butë pediatria	**Pesha/kg sipas kontra.**	**Pesha e materilit kg/dite**	**Pesha ne proporcion me dimensionet**	**Pesha e materilit kg/dite**	**Diferenca ne kg**	**Vlera ne lekë**
Carcaf Zarf	1.29	5.55	0.72	3.09	2.46	

Carcaf shtrati	0.82	3.61	0.66	2.84	0.77	
Jorgan me vatin	1.75	0.2	0.987	0.1	0.1	
Batanije	2.05	0.17	0.96	0.08	0.09	
Këllëf dysheku i gomuar	0.5	1.47	0.25	0.71	0.76	
Totali ne dit		11		6.82	4.18	
Totali ne muaj	30.4167	334.5837		207.4419	127.14	
Totali ne vit	*12	4,015		2,489.3	1,525.7	525,344

Sic viher re në tabelën e mësipërme fondi për llogaritjen e vlerës së kontratës nga grupi i punës dhe certifikuar nga Njësia e prokurimit është i fryrë me 525,344 lekë/vit, ose **2,101,377 lekë** për procedurën e prokurimit, vlerë e cila ka sjellë rritje të fondit limit me efekt për buxhetin e shtetit dhe ngarkon me përgjegjësi grupin e punës për hartimin e fondit limit si dhe njësinë e prokurimit.

Titulli i gjetjes:	**Rritje e fondit limit**
Situata:	Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt **"*Shërbimi lavanterisë dhe hotelerisë për nevoja të Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Sarandë" grupi*** i përllogaritjes së fondit limit nuk ka respektuar specifikimet teknike të përcaktuara po nga këto në faqet 18-20 të relacionit nr, 625 prot date 14.05.2021, mos respektimi I specifikimeve konkretisht përmasave të materilait të butë për pavionin pediatric por duke I marrë ato si pavionet për të rritur ka sjellë një rritje të fondit limit me 2,101,377 lekë vlerë e cila konsiderohet efekt financiarë negative për buxhetin e shtetit.
Kriteri:	Ligji i prokurimit publik nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar. Vendimi Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" i ndryshuar, neni 59 pika 2 paragafi i fundit.
Ndikimi:	Shtimi i kostove për institucionin
Shkaku:	Mos respektimi i specifikimeve teknike të hartuara.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandim:	AK, Njësia e prokurimit ose grupi i përllogaritjes së fondit limit nëse ka një të tillë, në çdo rast duhet të respektojë çdo specifikim teknik, dizajnim apo projektim të parashikuar në përllogaritjen e fondit limit me qëllim shmangien e diferencave që krijohen dhe përsosmërinë në përcaktimin e fondit që do prokurohet.

Për hartimin e specifikimeve teknike dhe DST Njësia e prokurimit ka huazuar të dhënat nga institucionet e tjera spitalore duke mos marrë në bazë llojin e spitalit, nevojën e tij apo çdo element tjetër të nevojshëm në kundërshtim me VKM nr. 914 datë 29.12.20214 "Për miratimin e rregullave të prokurimit teknik" i ndryshuar, neni 28 pika 2.

-Shqyrtimi i ankesave dhe sugjerimeve të APP.

Pas publikimit të kontratës nga ana e APP ka ardhë emaili me date 14.06.2021 tek personi përgjegjës znj. S. G për prokurimet për rekomandimet e mundshme për kriteteret e kualifikimit dhe specifikimet teknike.

Pas marrjes së emailit titullari i AK ka nxjerrë urdhërat nr 802 prot, date 18.06.2022 dhe nr. 133, datë 18.06.2021 për pezullimin e procedures së prokurimit dhe shyrtimin e rekomandimeve të APP.

Pas reflektimit te rekomandimeve të shumta titullari i AK nxjerrë urdhërin nr. 801 prot datë 18.06.2021 me numër urdhëri 132, datë 18.06.2021 për heqje nga pezullimi. Siç vihet re titullari përgjegjësi i prokurimeve dhe titullari AK nuk e kanë idenë e kronologjisë së shkresave pasi e mbajnë emailin për 4 ditë në konsultim, fillimisht nxjerrin urdhërin për heqje nga pezullimi pastaj për pezullim, praktikisht de Juro procedura sipas numrave të urdhërave mbetet e pezulluar.

-Me shkresën datë 09.07.2021 protokolluar pranë DSHSS me nr. 874 datë 12.07.2021 OE Lavanteri Elit ka bërë ankesë për kriteret e vendosura, madje duke cilësuar në ankesë që këto kritere favorizojnë OE "D.S" shpk duke ngushtuar konkurencën.
Më 12.07.2021 titullari i AK ka nxjerrë urdhërin nr. 883prot. date 12.07.2021 me numër urdhëri 139 datë 12.07.2021 për pezullimin e procedures dhe ngarkimin për shqyrtim të ankesës KSHA e përbërë nga L. I, E. D dhe M. Z.
Më14.07.2021 KSHA kthen përgjigje duke pretenduar se nuk jemi specialist të fushës dhe nuk mundemi ti kthej përgjigje.
Krijimi i grupit për shyrtimin e akesës pa specialistë të fushës veprime në kudërshtim em VKM 914 "Për miratimin e rregullave tëprokurimit publik" neni 78 pika 6, gërma a, ngarkon me përgjegjësi titullarin e AK.
Pas marrjes së përgjigjes titullari i AK ka nxjerrë urdhërin nr. 895 prot, date 14.07.2021 me nr. Urdhëri 139/1 datë 14.0.2021 për caktimin e ekspertit të fushës të jashtëm dhe ngarkon N/Drejtorin Ekonomik për zbatimin e urdhërit.
-Gjithashtu në DSHSS ka ardhë dhe një shkresë me email protokolluar nr. 946 prot date 30.07.2021 që mban emrin S. D, (pa sigluar) ku shprehet se ankesa e OE është përtej afateve dhe si e tillë nuk merret në konsideratë pasi nuk ka bërë ankimin paralel në KPP së bashku me pagesat. Se dimë në është vënë në dijeni për situatën reale personi në fjalë, por kjo procedurë është një ndërthurje midis ligjit të vjetër dhe të ri të prokurimit, VKM ku është hartuar DST dhe pjesët e tjera integrale të procedurës i referehon VKM 914 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" atë baze ligjore nuk e përfshin.
Më 30.07.2021 ka ardhur dhe një relacion teknik me nr. 947 prot date 30.07.2021 nga P. A si specialist fushe.
-Pas njohjes me keto shkresa titullari i AK nxjerrë urdhërin nr. 948 prot. datë 03.08.2021 për shqyrtimin e ankesës dhe ngarkohet personi F. S si zyrtari i KSHA. Pas marrjes së urdhërit z. F. S në cilësinë e KSHA nxjerr vendimin nr. 960 prot, date 05.08.2021 i cili e refuzon ankesën si të pa vlefshme, vendim i cili nuk qëndron nga aspekti ligjor ose është NUL pasi personi në fjalë z. F. S është me profesion economist dhe në respektim të VKM nr. 914 , datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" neni 78 pika 6 gërma ai i cili citon: Titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen një komisioni të përbërë nga 3 (tre) persona, *ku të paktën njëri është ekspert i fushës* për të shqyrtuar ankesën dhe për të dhënë një vendim. Përjashtimisht, në rast të mungesës së personelit, titullari i autoritetit kontraktor ia ngarkon çështjen për shqyrtim 1 (një) zyrtari të vetëm, *i cili duhet të jetë ekspert fushe*. Komisioni/zyrtari i ngarkuar është përgjegjës për vendimin e dhënë në përfundim të shqyrtimit të ankesës.

Titulli i gjetjes:	Caktimi i stafit në detyra jo në përputhje me ligjin
Situata:	Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt ***"Shërbimi lavanterisë dhe hotelerisë për nevoja të Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Sarandë"*** me fond limit 97,256,679 lek, nga ana e titullarit të Ak pas njohjes me relacionin teknik të ing. të kontraktuar nxjerr urdhërin nr. 948 prot, date 03.08.2021 për shqyrtimin e ankesës dhe ngarkohet personi F. S si zyrtari i KSHA, punonjës pa kualifikimet e nevojshme për shyrtimin e ankesës sipas kërkesave të Vendimit Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik".
Kriteri:	Vendimi Nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" , i ndryshuar, neni 78 pika 6, shkronja a
Ndikimi:	Cënimi i paanshmërisë në vendimmarrje
Shkaku:	Interpretim i gabuar i ligjit
Rëndësia:	E mesme

Rekomandim:	DSHSS të marrë masa për trajnimin e vazhdueshëm të stafit të saj si dhe emërimin në postet e titullarit të AK staf të kualfikuar dhe me integritet me qëllim marrjen e vendimeve në proporcion të drejt me situatën dhe legjislacionin në fuqi.

Vlerësimi i ofertës:
Në sistemin SPE për këtë procedure kanëmarrë pjes 3 OE nga ku njëri nuk ka paraqitur dokumentacion dhe dy të tjerët kanë konkuruar për plotësimin e kritereve, operatori ekonomik D. shpk dhe BOE " L. E." & " N. O."
Komisioni i vlerësimit të ofertave i përbërë nga F. S kryetar dhe V. D dhe V. M antarë.
Nga verfikimi i raportit të vlerësimit të sistemit OE ekonomik D. shpk sipas KVO i plotëson të gjitha kriteret ndërsa BOE nuk i plotëson.
Kjo është e vërtetë se BOE " L. E." & " N. O." ka disa mungesa të dokumentacionit kryesisht OE " N. O." por KVO ka vlerësuar me dy standarde ofertat ekonomike.
Nga auditimi i dokumentacionit teknik në SPE të OE D. shpk nga grupi i auditimit u konstatuan disa mangësi si mëposhtë:
Kapaciteti teknik pika 3.3.11

3	Makineri Paketimi Profesionale për paketim rrobash	Cope	2

Për ketë makineri OE ka paraqitur faturen tatimore të shitjes nr serial 50212901 datë 28.07.2017 me përshkrim *Makineri apketuese HP630WS 1 cop*
Si dhe ka paraqitur një faturë zhdoganimi nr. 7439 datë 19.02.2008 me përshkrim si në foto;

Makineri paketimi o mbeshtjelljeje(jo:per
mbushje,mbyllje,vulosje te shisheve,kanacev
TAVOLINE PAKETUESE-1 CP

Pra një makineri paketim shishesh, AK kërkon paketim hermetik teshash dhe jo shishesh. **<u>Kriter që nuk plotësohet.</u>**
Ak në pikën 3.3.4 kërkrkon; Në strukturën e ambientit të lavanderisë të jetë një dhomë e veçuar kontaminimi e nevojshme për ndarjen e materialit të larë me atë të palarë. Për të vërtetuar këtë kërkesë të AK operatori ekonomik duhet të paraqesi një planimetri të qartë të ambjentit ku ushtron veprimtarinë, foto, ku do të bëhet verifikimi në ambjent për ambjentet e sipërkërkuara.
-Për të plotësuar këtë kriter OE D. shpk ka sjellë dokumentin me nr 15 në sistem Planimetria e dhomës. Ky dokumentacion është fragment harte dhe në asnjë rast nuk është planimetri, planimetria ka disa kritere që duhet të plotësoj minimalisht duhet të jetë në shkallën 1:100 dhe të mbaj një kokë dhë një person me licenc kush e harton. Por nga KVO ky element nuk përbën problem. ***<u>Kriter që nuk plotësohet</u>***
OE duhet të dorëzojë ofertën sipas pikes 1 germa a ***a.*** *Formulari i Ofertës, sipas* ***Shtojces 1****;*
Po të shikohet shtojca 1 në DST dhe ajo sipas D. shpk nuk janë të njëjta. AK ka kërkuar që shtojca 1 të ketë sasinë kg/ditore të caktuar nga AK sipas DST dhe OE duhet të caktoj çmimin për KG, ndërsa OE ka sjellë një ofertë me sasinë totale dhe çmimin për njësi duke mos iu përmbajtur shtojcës nr. 1.
Por përsëri për KVO nuk përbën problem mjafton që BOE ta cilësoje si shtojcë të plotësuar gabim dhe OE D. ta kualifikoj, vlerësim dukshëm me dy standarde nga KVO.
Edhe pse me këto mangësi OE D.S shpk është parë si i plotë në dokumentacion duke mos patur devijimi nga KVO, veprime që ngarkojnë me përgjegjësi antarët e KVO për vlerësim me dy standarde të OE.
-Sic vihet re në këtë procedurë shkresat nuk kanë asnjë rrjedhë logjike numrat, ato fillojnë dhe mbarojnë të ndryshëm me njëri tjetrin duke e bërë tejet të vështirë për cilido pasjen e një dokumentacioni të plotë me fraksion duke filluar nga kërkesa për prokurim deri tek lidhja e kontratës.

Titulli i gjetjes:	**Kualifikim i padrejtë**
Situata:	Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt ***"Shërbimi lavanterisë dhe hotelerisë për nevoja të Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Sarandë"*** me fond limit 97,256,679 lek, nga ana e KVO është kualfikuar OE D. shpk në kundërshtim me kërkesat ligjore dhe dokumentat e tenderit të hartuar sipas DST të miratuar, KVO ka vepruar me dy standarde në rastin e vlerësimit të ofertave në këtë proçedurë prokurimi, ku me njërin OE është treguar shumë strikt dhe me tjetrin shumë liberale.
Kriteri:	*Ligji i prokurimit publik nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar me Ligjin Nr. 9800, datë 10.09.2007, Ligjin Nr.9855, datë 26.12.2007, Ligjin Nr. 10170, datë 22.10.2009, Ligjin Nr.10 309, datë 22.07.2010, Ligjin Nr. 22/2012, Ligjin Nr. 131/2012, Ligjin Nr. 182/201,. Neni 46 pika 1 dhe neni 53 pika 3 .* *Vendimi Nr.914, datë 29.12.2014"Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" ndryshuar me VKM nr.402, datë 13.5.2015; nr.1046, datë 23.12.2015; nr.823, datë 23.11.2016; nr.893, datë 21.12.2016; neni 66 pika 3 si dhe Dokumentet standarte të tenderit Pika 3.3.4; 3.3.11 si dhe shtojca 1.*
Ndikimi:	Cënim i barazisë
Shkaku:	Staf i pa kualifikuar
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandim:	DSHSS sha të marrë masa që në të ardhmen të kryej vlerësim sa më objektiv duke ruajtur panshmërinë në procedurat që vlerësohet qofshin ato me ofertë më të ulët apo më të lartë. Pasja në vëmendje plotësimin e të gjitha kritereve për kualfikim në respect të frymës së ligjit.

Mbi zbatimin e kontratës.

Marrëveshja kuadër nr. 1046 prot, datë 08.09.2021" Shërbim lavanderie dhe hotelerie për nevoja e Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Sarand" ku të gjitha kushtet janë të përaktuara me afat 48 muaj dhe vlerë të pritshme 97,256,69 lekë pa tvsh.

Kontrata nr. 1047 prot date 08.09.2021 me një afat 24 muaj dhe vlerë kontrate 48,440,449 lekë. Në zbatim të specifikime për materialin e butë që do të lahet, blihet dhe zëvendësohet sipas jetëgjatësisë së materiali përkatës dhe kushteve të autoritetit kontraktor DSHSS, materialet që do të përdoren nga sipërmarrësi për shërbimin e lavanterisë dhe hotelerisë duhet të plotësojnë këto specifikime:.

1. "Dyshek tek spitalor"; (dimensionet190x90x10 cm,) me specifikime teknike: Dysheku të jetë i njëtrajtshëm (pa ndarje), përbërja nga *brenda me dy shtresa vatin të fortë*, ku nga njëra anë të ketë porozitet për qarkullimin e ajrit, dhe i veshur nga jashtë me mbulesë të fortë të padepërtueshme, injifugo (kundër zjarrit), antibakteriale dhe antialergjike. Të ketë të shënuar datën e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor. ***Ngjyra sipas kërkesës së autoritetit kontraktor.***

U konstatua që: Nuk ka asnjë informacion për specifikimet teknike për dyshekët që ndodhen në DSHSS (nëse plotësohen kushtet e sipërcituara). Nuk ka asnjë korrespodencë midis AK dhe operatorit ekonomik «D. » që kryen shërbimin.

2."Dyshek pediatric"; Dysheku të jetë i njëtrajtshëm (pa ndarje), përbërja nga *brenda me dy shtresa vatin të fortë*, ku nga njëra anë të ketë porozitet për qarkullimin e ajrit, dhe i veshur nga jashtë me mbulesë të fortë të padepërtueshme, injifugo (kundër zjarrit), antibakteriale dhe antialergjike. Të ketë të shënuar datën e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor. ***Ngjyra sipas kërkesës së autoritetit kontraktor.***

U konstatua që: Nuk ka asnjë informacion për specifikimet teknike për dyshekët që ndodhen në DSHSS (nëse plotësohen kushtet e sipërcituara). Nga grupit i auditimit u konstatua se nuk

kishte te furnizim me dyshek pediatric por ishin pershtatur dysheket normal pasi mungonin specifikimet nga grupi i ngritur.
3. "Dyshek neonat"; Dysheku të jetë i njëtrajtshëm (pa ndarje), përbërja nga *brenda me dy shtresa vatin të fortë*, ku nga njëra anë të ketë porozitet për qarkullimin e ajrit, dhe i veshur nga jashtë me mbulesë të fortë të padepërtueshme, injifugo (kundër zjarrit), antibakteriale dhe antialergjike. Të ketë të shënuar datën e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor.***Ngjyra sipas kërkesës së autoritetit kontraktor.***
*U konstatua që: Nuk ka asnjë informacion për specifikimet teknike për dyshekët që ndodhen në DSHSS (nëse plotësohen kushtet e sipërcituara).**Duke parë dhe për cfarë moshe foshnjesh do përdoret vetem grupi i hartimit të specifikimeve teknike i duket normal ky dyshek.***
Por huazimi specifikimeve nga institucione spitalore të tjera sjellë dhe pasojat e pa riparueshme dhe që ngarkojnë me përgjegjësi stafin.
4. "Jastëk"; (dimensionet40cmx80cm, Fibra Sintetike) me specifikime teknike: Mbushje uniforme me fibra sintetike, ngjyrë e bardhë, datën e futjes në materialit të butë në përdorim në shërbimin mjekësor.
U konstatua që: Nuk ka asnjë informacion për specifikimet teknike të jastëkëve që ndodhen në DSHSS (nëse plotësohen kushtet e sipërcituara). Nga te dhenat e targetes ne jastekun e gjendur ne magazine e spitalit rezultoi se ai ishte me dimensioned 45 cm x 70 cm duke mos I plotesuar specifikimet teknike te kerkuara.
5. "Jorgan me vatin"; (dimensionet 190cmx140cm) me specifikime teknike: Me mbushje me vatin , me tegela ndarëse në formë kuadrati , veshja e jashtme material pambuku, ngjyrë sipas kërkesës së autoritetit kontraktor.
U konstatua që: Nuk ka asnjë informacion për specifikimet teknike të jorganëve vatin që ndodhen në DSHSS (nëse plotësohen kushtet e sipërcituara). Nga grupit i auditimit u konstatua që asnjë prej jorganëve vatin nuk ka të shënuar datën e futjes në shërbimin mjekësor. Nuk ka asnjë korrespodencë midis AK dhe operatorit ekonomik që kryen shërbimin për sasinë reale, ngjyrën dhe gjendjen e jorganëve vatin në DSHSS..
6. "Jorgan me vatin pediatrik"; (dimensionet 150cmx100cm / 100cm/100cm) me specifikime teknike: Me mbushje me vatin , me tegela ndarëse në formë kuadrati , veshja e jashtme material pambuku, ngjyrë sipas kërkesës së autoritetit kontraktor.
U konstatua që: Nuk ka asnjë informacion për specifikimet teknike të jorganëve vatin që ndodhen në DSHSS (nëse plotësohen kushtet e sipërcituara). Nga grupi i auditimit u konstatua që asnjë prej jorganëve vatin nuk ka të shënuar datën e futjes në shërbimin mjekësor. Nuk ka asnjë korrespodencë etj.
<u>Një problematik kryesore mbetet në pavionin e pediatrisë ku nga kryeinfermierja bëhet kërkesa për mall të butë për pediatrin dhe asaj i furnizohet mall i butë për shtretër të mëdhenj duke rritur kg peshën për OE D. për të larë dhe përfituar.</u>

-Sektori i Shërbimeve të Hotelerisë të Spitalit, në bazë të kërkesave ditore (fletë forcën e pavijonit) dhe grafikut të pavijoneve, harton evidencën ditore përmbledhëse në total për të gjithë Spitalin, dhe ia dorëzon sipërmarrësit brenda orës 13:00 për ditën pasardhëse.
-Peshimi dhe numërimi i materialit të butë të larë, të thatë , të hekurosur , si dhe të paketuar do të bëhet çdo ditë në orën 08:00 nën prezencën e përfaqësuesit të autoritetit kontraktor dhe përfaqësuesit të sipërmarrësit, duke mbajtur procesverbalin përkatës të firmosur nga palët. Ky dokument do të ketë vlerë financiare, pasi likuidimi i operatorit ekonomikë do të bëhet mbi bazën e procesverbaleve të nënshkruara nga palët për çdo ditë.
-Vetëm pasi të jetë peshuar e numëruar, materiali i butë është gati për tu shpërndarë nga Sipërmarrësi në shërbimet përkatëse, sipas kërkesave të shërbimit të bërë një ditë më parë. Materiali i butë dhe i palarë do të dalë me copë dhe do të hyjë i larë me kilogramë.
-Sipërmarrësi ia dorëzon materialin e butë Kryeinfermierit të pavijonit në bazë të grafikut të hartuar nga Sektori i Shërbimeve të Hotelerisë. Për çdo rast, dorëzimi i materialit të butë do të bëhet vetëm pasi ky material i butë të jetë peshuar, numëruar dhe në momentin e dorëzimit

do të mbahet procesverbali i dorëzimit (në kg.) i firmosur nga të dyja palët, nga grupi i pritjes së mallit si dhe nga Kryeinfermieri i pavijonit/shërbimit përkatës, në 3 kopje. Kryeinfermieri i pavijonit dhe grupi i pritjes së mallit bën kontrollin për larjen,hekurosjen,cilësinë e materialit të butë dhe në rast konstatimi të materialit të butë difektoz ose të papastër, e kthen mbrapsht duke e pasqyruar në procesverbal. Ky procesverbal duhet të ketë të saktësuar numrin e materialit të butë të marrë në dorëzim nga Kryeinfermieri i pavijonit.

Material i butë	**Pesha/kg sipas kontra.**	**Pesha sipas matjes te grupit te monitorimit**	**Pesha sipas verifikimit klsh**	**Diferenca ne kg**
Çarçaf Zarf	1.29	1.18	1.18	0.11
Batanije	2.05	2.05	1.96	0.09

Nga auditimi i zbatimi të kontratës muaji shkurt 2022 shikohen devijime në llojin e materilit të butë të numëruar dhe paguar, nga verifikimi dhe analizimi I pavionit të pediatrisë (fëmijëve) të cilët sipas kontratës duhe të kenë carcafët e shtratit, carcafët e sipërm, batanijet, jorganët mbulesën e gomuar për pediatrin me përmasat sipas kontratës, ato furnizohen me letra dhe numërohen si material i butë për shtretër normal duke devijuar ndjeshëm nga pesha reale e tyre.

Referuar kontratës së nënshkruar dhe vulosur nga palët faqe 16 deri në 19 Aneksi nr. 2 Specifikimet teknike.

Pediatria Shkurt 2022

Kerkes date	**1**	**2**	**3**	**4**	**5**	**6**	**7**	**8**	**9**	**10**	**11**	**12**	**13**	**14**	**15**	**16**	**17**	**18**	**19**	**20**	**21**	**22**	**23**	**24**	**25**	**26**	**27**	**28**	
Carcaf Zarf	27	23	30	30	27	30	34	22	34	31	32	31	38	26	30	22	30	42	32	28	21	41	25	23	29	21	33	25	817
Carcaf shtrati	14	9	13	12	15	16	13	12	17	16	18	17	18	12	10	7	12	12	16	12	13	21	11	12	15	10	14	9	376
Jorgan me vatin							1								1				1	1		1					1		6
Batanije																						1			1		2		4
Këllëf I gomuar	1	1			3	2	1		3	1	1				1					2		3		2	1		2	2	26

Pra,OE ka furnizuar pediatrinë krevatet e fëmijëve me 817 çarçafë zarf, 376 çarçafë shtrati, 6 Jorganë me vatin. 4 batanie dhe 26 këllëf të gomuar.

Sic vihet re dhe nga tabela kërkesa dhe furnizimi për pediatrinë duket tejet i zhdrejtë pa asnjë sens dhe rakordim me numrin e të sëmurëve, por duket vetëm si sasi për të plotësuar normën e OE D. shpk.

Nr	**Material I butë pediatria**	**sasia e kerkuar**	**Pesha cop/kg sipas likujdimit**	**Pesha e materilit kg/total**	**Pesha ne proporcion me dimensionet**	**Pesha e materilit kg/total**	**Diferenca ne kg dhe LEK**
1	**Carcaf Zarf**	**817**	**1.29**	**1,053.93**	**0.72**	**588.24**	**465.69**
2	**Carcaf shtrati**	**376**	**0.82**	**308.32**	**0.66**	**248.16**	**60.16**
3	**Jorgan me vatin**	**6**	**1.75**	**10.5**	**0.987**	**5.922**	**4.57**
4	**Batanije**	**4**	**2.05**	**8.2**	**0.96**	**3.84**	**4.36**
5	**Këllëf dysheku I gomuar**	**26**	**0.5**	**13**	**0.25**	**6.5**	**6.5**
6	**Totali ne muajin shkurt**			**1,393.95**		**852.65**	**541.3**
	Cmimi kg			344		344	344
	Vlera			**479,518.8**		**293,315**	**186,203**

Siç vihet re nga tabela e mësipërme vetëm për muajin Shkurt 2022, OE D. shpk me mbështetjen e AK ka përfituar padrejtësisht nga furnizimi me material të butë pavionin e pediatrisë në **vlerën**

186,203 lekë, e cila konsiderohet dëm ekonomik për buxhetin e shtetit. Nga Ak ka ardhur shkresa nr. 767 prot. Datë 01.09.2022 për saktësimin e vlerës për periudhën Shtator 2021-maj 2022 për këtë shërbim, sipas rekomandimeve në projekt raport dhe vlera e përllogaritur për 9 muaj është **1,095,579 lekë.**
Gjithashtu, gjatë inspektimin në ambientet e DSHSS për mënyrën e furnizimit të mallrave të butë dhe cilësinë e tyre u konstatua se OE "D." shpk me pëlqimin e autoritetit kontraktor shfrytëzon ambjentet e lavanderisë ekzistuese të DSHSS për magazinimin dhe shpërndarjen e mallit të butë pa asnjë qira apo detyrim tjetër.
Shfrytëzimi i ambienteve të ish lavanderisë me një sipërfaqe rreth 50m2 pa asnjë kontratë qiraje dhe jo në përputhje me kontratën e lavanderisë, ngarkon me përgjegjësi titullarin e institucionit z. A. K dhe K...n të ardhura të munguara për buxhetin e institucionit **në vlerën 50 m2 x 100 lekë/m2 = 5000lekë/muaj x 10 muaj = 50,000 lekë të ardhura të munguara** sipas Vendim Nr. 54, datë 5.2.2014 "Për përcaktimin e kritereve, të procedurës e të mënyrës së dhënies me qira, enfiteozë apo kontrata të tjera të pasurisë shtetërore", i ndryshuar.

Titulli i gjetjes:	Përfitim i padrejtë
Situata:	Nga auditimi i zbatimit të kontratës të ***"Shërbimi lavanterisë dhe hotelerisë për nevoja të Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Sarandë"*** me vlerë kontrate fond limit 96,880,898 lek, me operatorë fitues dhe zbatues të shërbimit "D." shpk, nga verifikimet e dokumentacionit shoqërues të pagesës për mujin shkurt 2022 si dhe krahasimi i tij me specifikimet teknike ne kontratë faqet 16 deri në 19 Aneksi nr. 2 "Specifikimet teknike" u konstatua se OE fitues si dhe Autoriteti kontraktorë nuk kanë respektuar kontratën në lidhje me llojin e materilit të butë të furnizuar sipas përmasave të hartuara nga grupi I punës por kanë ofruar material të butë sipas dëshirës duke përfituar padrejtësisht **vlerën 1,095,579 lekë e cila konsiderohet dëm ekonomik për buxhetin e shtetit**.
Kriteri:	*Ligjin e prokurimit publik nr. 9643 LIGJI Nr. 9643, datë 20.11.2006, i ndryshuar me Ligjin Nr. 9800, datë 10.09.2007, Ligjin Nr.9855, datë 26.12.2007, Ligjin Nr. 10170, datë 22.10.2009, Ligjin Nr.10 309, datë 22.07.2010, Ligjin Nr. 22/2012, Ligjin Nr. 131/2012, Ligjin Nr. 182/201,. Neni 60 pika 1 si dhe* kontrata nr. 1047 prot date 08.09.2021.
Ndikimi:	Mos ofrimi i rehatisë në shtratet e fëmijëve
Shkaku:	Monitorim jo i saktë
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandimi:	DSHSS të marri masa që t'i kërkojë kontraktorit "D." shpk, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës **1,095,579** lekë, të cilën e ka përfituar padrejtësisht si dhe në të ardhmen të kryej shërbimin sipas DST dhe kontratës së nënshkruar.

5. "*Blerje kite, reagent e material konsumi laboratorik-3 lote*", viti 2020

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: ***Blerje kite, reagent e material konsumi laboratorik-3 lote***			
1. Lloji i Procedurës së Prokurimit "procedure e hapur" marveshje kuadër me afat 12 muaj me 3 lote Urdhri nr 418 datë 18.03.2020	**2 Njësia e Prokurimit** A. K S. G L. M	**3.1 KVO** Urdhri nr 419 datë 18.03.2020 F. S V. M V. D	**3.2 KSHA**

4. Fondi Limit 1,566,690 lekë	**5. Oferta fituese** **S...d loti 2 473,550** **G. loti 3 117,980** **G. loti 1 61,100**	**6. Diferenca me fondin limit**
7/1 Afati kohor dhe Data e hapjes së tenderit Data 30.03.2020 **7/2 Kohezgjatja 12 muaj**	**8. Burimi Financimit** Buxheti i shtetit	**9. Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender Numër**6** b) S'kualifikuar 2OE, c) Kualifikuar 4OE

a. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

-Titullari i DSHSS z. E. Dh pas marrjes së kërkesës për nevojat sipatalore për kite reagent nr. 89 prot datë 17.03.2020 ka nxjerr urdhërin nr. 413 prot datë 17.03.2020 ku ka ngritur grupin e punës për përllogaritjen e fondit limit për procedurën *"Shërbimi* ***Blerje kite, reagent e material konsumi laboratorik-3 lote****"*.

Titullari i autoritetit kontraktor pas marrjes së relacionit ka nxjerr urdhërin e prokurimit nr. 418 prot date 18.03.2020 për procedurën e prokurimit ***Blerje kite, reagent e material konsumi laboratorik-3 lote*** *si dhe ka krijuar njësin e prokurimit të përbër nga A. K, S. G dhe L. M.*
-Në përllogaritjen e fondit limit komisioni i është referuar kontratave të mëparshme për llogaritjen e fondit limit.
Hartimi i specifikimeve është bërë nga njësia e prokurimit me procesverbalin e datës 19.03.2020.
Procedura e prokurimit hapet më 30.03.2020.
Vlerësimi i ofertës:
Në sistemin SPE për këtë procedure kanë marrë pjesë 6 OE sipas loteve mëposhtë:
Për lotin nr 1 ka marrë pjesë subjekti "G. " shpk dhe "S." shpk
Për lotin nr 2 ka marrë pjesë subjekti "S." shpk
Për lotin nr 3 ka marrë pjesë subjekti 'G. " shpk, "S." shpk dhe "K." shpk
Pas vlerësimit të ofertave KVO me procesverbalin e dates 15.04.2020 ka kualfikuar OE si mëposhtë:
Për lotin nr.1 "G." shpk me çmim për njësi 4,735.4 lek pa TVSH
Për lotin nr.2 "K." shpk me çmim për njësi 8,562 lek pa TVSH
Për lotin nr.3 "S." shpk me çmim për njësi 11,931 lek pa TVSH
Nuk u konstatuan problematika në procedurën e prokurimit.

6. "*Blerje kite, reagent e material konsumi laboratorik-3 lote*", viti 2021

Zhvillimi i Procedurës së Prokurimit me objekt: ***Blerje kite, reagent e material konsumi laboratorik-3 lote***			
1. Lloji i Procedurës së Prokurimit **"**kërkes për propozim" marveshje kuadër me afat 12 muaj me 3 lote Urdhri nr 552 datë 21.04.2021	**2 Njësia e Prokurimit** A. K S. G L. M	**3.1 KVO** Urdhri nr 593 datë 05.05.2021 F. S V. M L. I	**3.2 KSHA**
4. Fondi Limit **2,773,621 lekë** **Loti 1** 1,164,338 lek **Loti 2** 1,170,400 lek **Loti 3** 438,883 lek	**5. Oferta fituese** **S...d loti 2 473,550** **G. loti 3 117,980** **G. loti 1 61,100**	**6. Diferenca me fondin limit**	
7/1 Afati kohor dhe Data e hapjes së tenderit Data 17.05.2021 **7/2 Kohezgjatja 12 muaj**	**8. Burimi Financimit** Buxheti i shtetit	**9. Operatoret Ekonomike** a)Pjesëmarrës në tender Numër**6** b) S'kualifikuar 2OE, c) Kualifikuar 4OE	

a. Mbi realizimin e procedurës së prokurimit.

-Titullari i DSHSS z. E. Dh pas marrjes së kërkesës për nevojat sipatalore për kite reagent nr. 495 prot datë 01.04.2021 ka nxjerr urdhërin nr. 546 prot datë 16.04.2021 ku ka ngritur grupin e punës për përllogaritjen e fondit limit për procedurën "**Blerje kite, reagent e material konsumi laboratorik-3 lote**" të përbër nga F. S, E. D dhe Xh. M.
Kërkesa e bërë nga Znj. Xh. M dhe V. M është mesatarisht 50% më e lartë në numër krahsimisht me kërkesën e po të njëjtit person në vitin 2020 pa dhë asnjë shpjegim pa marrë për bazë as gjendjen e farmacisë më 31.03.2021 krahsuar me konsumin e vitit 2020 apo 2019. Grutpi i punës ka hartuar procesverbalin datë 19.04.2021 për përllogaritjen e fondit limit Ju ka referuar testimit të tregut për nxjerrjen e çmimeve për produktet dhe përllogaritjen e fondit limit duke shmangur në mënyrë të pashpjegueshme kontratat e mëparshem të realizuara me sukses në këtë Institucion.

-Përzegjedhja e testimit të tregut duke shmangur kontratat e mëparshme ka sjellë një fryrje të fondit limit duke dhën mundësin OE pjesëmarrës të përfitojnë veprime në kundërshtim me ligjin nr. 162/2020 " Për prokurimin publik" neni 2, germa a, b si dhe VKM 914 datë 29.1.2014 neni 59, pika 2 germa b dhe ngarkon me përgjegjësi F. S, E. D dhe Xh. M.

Titulli i gjetjes:	**Mangësi në llogaritjen e fondit limit**
Situata:	Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "**Blerje kite, reagent e material konsumi laboratorik-3 lote**" grupi i përllogaritjes së fondit limit nuk ka respektuar ligjin nr. 162/2020 " Për prokurimin publik" neni 2 për miradministrimin e fondeve publike, duke përzgjedhur një proçedurë për testimin e tregut me kosto më të larta sesa marja në konsideratë e kontratave të mëparshme, kjo e vërtetuar dhe nga ofertat e ardhura që kanë qenë anomlisht të ulëta për me argument përkatës. Grupi i punës për përllogaritjen e fondit limit e e ka fryrë fondin dukë përzgjedhur mënyrën e testimit të tregut pa pasur asnjë arsye konkrete edhe pse kontratat e mëparshme janë realizuar me sukses.
Kriteri:	Ligji nr. 162/2020 " Për prokurimin publik" neni 2, germa a, b si dhe VKM 914 datë 29.1.2014 neni 59, pika 2 germa b.
Ndikimi:	Shtimi i kostove për institucionin
Shkaku:	Mos marrja në konsideratë të kontratave të mëparshme
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandim:	AK, Njësia e prokurimit ose grupi i përllogaritjes së fondit limit nëse ka një të tillë, në çdo rast duhet të respktojë çdo specifikim teknik, dizajnim apo projektim të parashikuar, duke marë në konsideratë kontratat e mëparshme dhe çdo formë tjetër të paeashikuar nga legjislacioni për një përdorim sa më të mirë të fondeve publike.

-Titullari i autoritetit kontraktor pas marrjes së relacionit ka nxjerr urdhërin e prokurimit nr. 552 prot date 21.04.2021 për procedurën e prokurimit ***Blerje kite, reagent e material konsumi laboratorik-3 lote*** *si dhe ka krijuar njësin e prokurimit të përbër nga A. K, S. G dhe L. M.*
Me procesverablin e dates 06.05.2021 Njësia e prokurimit ka hartuar kriteret e kualifikimit për procedurën e prokurimit.
Vlerësimi i ofertës:
Me urdhërin nr 593 prot. Date 05.05.2021 titullari I AK ka ngritur KVO të përbër nga F. S Kryetar, V. M dhe L. I Anëtarë.
Në sistemin SPE për këtë procedure kanëmarrë pjes 6 OE sipas loteve mëposhtë:
-Për lotin nr 1 ka marrë pjesë subjekti "G." shpk, D. o. M. D. G. shpk, I. shpk, K. shpk dhe "S." Shpk

-Për lotin nr 2 ka marrë pjesë subjekti "S." shpk
Për lotin nr 3 ka marrë pjesë subjekti "G." shpk, D. o. M. D. G. shpk, I. shpk, K. shpk , "S." Shpk dhe "A." shpk.

Me procesverbalin nr. 3 datë 25.05.2021 KVO pas verifikimit të ofertave arriti nëkonkluzionin se për lotin 1 dhe 3 Operatori G. Shpk ka sjellë ofert Anomalisht të ulët, për lotin 1 OE K. Shpk ka sjellë ofert anomalisht të ulët dhe për lotin 3 OE A. ka sjellë ofert anomalisht të ulët.
KVO ka kërkuar shpjegimi OE me oferta anaomalisht të ulëta dhe pas shpjegimeve me shkresat përkatëse i ka kualifkuar ato për në fazën e vlerësimit.
Kjo mbështet faktin e një fondi limit të fryrë.
Pas vlerësimit të ofertave KVO ka kualfikuar OE të renditur në vend të pare sipas ofertës më të ulët OE mëposhtë:
Për lotin nr.1 "G." shpk me çmim për njësi 1,920.6 lek pa TVSH
Për lotin nr.2 "S." shpk me çmim për njësi 20,920 lek pa TVSH
Për lotin nr.3 "G." shpk me çmim për njësi 8,990.28 lek pa TVSH

Për sa më sipër Drejtoria Shëndetësore Spitalore Sarandë ka sjellë shkresën nr. 767 prot, datë 01.09.2022 dhe nr. 386/6 prot datë 06.09.2022 të KLSH-së me observacionet përkatëse.

Pretendimi i subjektit: … *Gjithashtu deklarojmë se në përgjithësi jemi dakort me gjetjet tuaja në project raportin e auditimit.*
Vlera e përllogaritur nga Ak e cila duhet të arkëtohet nga OE D. shpk është 1,095,579 lekë. Bashkangjitur materialet shkresore mbi të cilat është bërë përllogaritja e vlerës së mësipërme.

Qëndrimi i Grupit të auditimit: *Grupi i auditimit mbasi e lexoj me kujdes dhe saktësoi të dhënat merr në konsideratë observacionin së bashku me dokumentacionin shoqërues dhe vërtetues dhe reflektoi në vlerën e përllogaritur.*

7. Mbi auditimin e kontratës së punimeve civile me objekt "Rikonstruksion i Pediatrisë në Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Sarandë".
Kontrata e punimeve civile "Rikonstruksion i Pediatrisë së Spitalit Sarandë", është nënshkruar me nr. 111 prot., datë 01.02.2021, me vlerë 4,378,010 lekë pa TVSH, me Kontraktorin "N.-86." SHPK. Afati i përfundimit të punimeve është përcaktuar 1 muaj, referuar datës së dorëzimit të objektit dhe dorëzimit të dokumentacionit.
Për mbikëqyrjen e punimeve është përzgjedhur z. A. K, me të cilin është nënshkruar kontrata nr. 265 prot., datë 18.02.2021. Për kolaudimin e punimeve është përzgjedhur z. A. T me të cilin është nënshkruar kontrata nr. 265/1 prot., datë 18.02.2021.
Bazuar në dokumentacionin e dosjes teknike, dorëzimi i sheshit të ndërtimit është bërë me datë 19.02.2021.
Sipërmarrësi dhe mbikëqyrësi i punimeve kanë njoftuar nevojën për disa ndryshime për t'i ardhur në ndihmë ecurisë së punimeve dhe mirëfunksionimit të pediatrisë. Njoftimi është bërë me nr. 543 prot., datë 03.03.2021.
Punimet kanë përfunduar me datë 25.04.2021. Aktkolaudimi është hartuar me datë 27.04.2021.
Punimet janë marrë në dorëzim të përkohshëm dhe certifikata përkatëse është lëshuar me datë 29.04.2021, nga komisioni i përbërë nga: znj. D. A, znj. L. I, z. A. D, z. V. M, z. N. K. Bazuar në shtesën e afatit, punimet kanë përfunduar brenda periudhës së përcaktuar.

Titulli i gjetjes:	Punime të likuiduara por të pa realizuara.
Situata:	Referuar dokumentacionit teknik, si dhe verifikimeve në objekt, u konstatuan mangësi si më poshtë: - Sipas zërit 2.4 "Tavan i varur me pllaka gipsi 60 x 60 cm" është certifikuar sasia 341 m^2. Nga kjo sasi, sasia 98.7 m^2, i përket korridorit të madh. Nga verifikimi i planimetrisë dhe matjeve në objekt rezulton

	se sipërfaqja e korridorit është 66 m^2 (30 m x 2.2 m), nga ku rezulton se është certifikuar më tepër sasia 32.7 m^2. Vlera **75,210 lekë** (32.7 m^2 x 2,300 lekë/m^2), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori "N.-86." SHPK dhe përbën dëm ekonomik. Po sipas këtij zëri, rezulton se në sipërfaqen totale të llogaritur nuk është zbritur sipërfaqja e ndriçuesve led (60 cm x 60 cm) për sasinë 40 copë. Vlera **33,120 lekë** (40 copë x 0.36 m^2 x 2,300 lekë/m^2), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori "N.-8." dhe përbën dëm ekonomik. - Sipas zërit 2.3 "Shtresë me pllaka grez importi", është certifikuar sasia 440 m^2. Për korridorin e madh është certifikuar sasia 98.7 m^2. Nga verifikimi i planimetrisë dhe matjeve në objekt rezulton se sipërfaqja e korridorit është 66 m^2 (30 m x 2.2 m), nga ku rezulton se është certifikuar më tepër sasia 32.7 m^2. Vlera **62,130 lekë** (32.7 m^2 x 1,900 lekë/m^2), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori "N.-86." SHPK dhe përbën dëm ekonomik. -Në lidhje me punimet në tavan llogaritur me diferencë 32.7 m^2 janë certifikuar më tepër edhe punimet sipas zërit 3.1 "Patinin tavani allçi (stuko)" me vlerë **14,715 lekë** (32.7 m^2 x 450 lekë/m^2) si dhe zërit 3.2 "Bojë hidroplastike importi cilësi e I) me vlerë **10,791** lekë (32.7 m^2 x 330 lekë/m^2). - Nga verifikimi sipas zërit "Portë duralumini me dyfish xham dhe me sistem elektronik për hapje", rezulton se në librezën e masave, referuar dhe matjeve në objekt është realizuar sasia 5.7 m^2, ndërsa është likuiduar sasia 6.4 m^2. **Vlera 39,200 lekë** [(6.4 m^2 - 5.7 m^2) x 56,000 lekë/m^2], është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori "N.-86." SHPK dhe përbën dëm ekonomik.
Kriteri:	Ligji nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, neni 7. Udhëzimin e KM nr. 3, datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, pika I.17. Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", pika 8.2 dhe 8.3.
Ndikimi:	Është shkaktuar dëm ekonomik me vlerë **235,166 lekë.**
Shkaku	Mos raportimi i saktë i sipërfaqes së realizuar.
Rëndësia:	E mesme.
Rekomandim:	Drejtoria e Shërbimit Spitalor Sarandë, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **235,166 lekë**, nga Kontraktori "N. - 86" SHPK**,** për punime të likuiduara por të pa realizuara.

Ngarkohet me përgjegjësi Mbikëqyrësi i punimeve z. A. K.

2.6. Mbi zbatimin e dispozitave ligjore në krijimin dhe përdorimin e të ardhurave dytësore.

Në lidhje me procedurat e ndjekura për krijimin dhe përdorimin e të ardhurave dytësore, u shqyrtua dokumentacioni si më poshtë:
-Dokumentacioni mbi pasqyrimin dhe evidentimin e të ardhurave.
-Korespodenca me Ministrinë për miratimin e përdorimit të të ardhurave dhe rakordimi me thesarin.
-Dokumentacioni mbi respektimin e % së përdorimit sipas klasifikimit të udhëzimit FSDKSH.

-Burimet e realizimit të të ardhurave dhe dokumentacioni i mbajtur.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit të sipërcituar konstatohet se:

Të ardhurat e realizuara nga veprimtaria e spitaleve janë klasifikuar nga Ministria e Financave në zbatim të udhëzimeve të zbatimit të buxhetit si të ardhura jashtë limitit me të drejtë përdorimi edhe pas mbarimit të vitit buxhetor përkatës. Mënyra e përdorimit të këtyre të ardhurave është e përcaktuar në udhëzimin e FSDKSH nr.2, datë 11.02.2014 "Për përdorimin e të ardhurave që realizojnë Spitalet nga veprimtaria e tyre dhe nga dhurimet" dhe në VKM nr.20, datë 20.01.2021 "Për financimin e shërbimeve shëndetësore spitalore nga skema e detyrueshme e sigurimeve të kujdesit shëndetësor për vitin 2021" pikat 10 dhe 11.
Të ardhurat që realizojnë spitalet nga veprimtaria e tyre, janë:
a)Të ardhurat nga tarifat e shërbimeve që u kryhen pacientëve, të cilët nuk kanë rekomandimin e mjekut të përgjithshëm dhe të familjes, si tarifa për vizita, analiza dhe ekzaminime të ndryshme.
b)Të ardhurat nga veprimtaria ekonomike, si qiratë, parkimi i automjeteve në territorin e spitalit, shërbime kancelarie, shtypshkrime të ndryshme,etj.
c) Të ardhurat e krijuara nga dhurimet në vlerë materiale e monetare.

Spitali Rajonal Sarandë, realizon të ardhura nga veprimtaria e tij kryesore dhe për periudhën objekt auditimi, ka realizuar të ardhura nga kryerja e ekzaminimeve të ndryshme mjeksore dhe shërbimi i parkimi, të cilat për 4 vitet paraqiten si më poshtë:

Të ardhurat dytësore	**Viti 2018**	**Viti 2019**	**Viti 2020**	**Viti 2021**
Të trashëguara nga viti i mëparshëm pa përdorur.	**9,346,053**	**6,217,414**	**10,483,026**	**16,543,431**
Të ardhura nga shërbimet spitalore	9,277,900	8,766,050	8,584,100	8,977,532
Të ardhura nga parkimi	77,100	601,150	768,450	1,300
Shuma vetëm për vitin përkatës	***9,355,000***	***9,367,200***	***9,352,550***	***8,978,832***
Shuma gjithsej në fund viti	**18,701,053**	**15,584,614**	**19,835,576**	**25,522,263**

Referuar tabelës së më sipërme rezulton se *të ardhurat nga shërbimet spitalore* për vitin 2019, krahasuar me vitin 2018, janë ulur me 511, 850 lekë, ndërsa në vitet 2019, 2020 dhe 2021, janë në nivele të qëndrueshme, ndërsa *të ardhurat nga parkimi,* janë ulur ndjeshëm në vitin 2021. Krahasuar vitin 2019 me 2018, rezulton se të ardhurat nga ky burim janë rritur me 524,050 lekë, për vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, janë rritur me 167,300 lekë, ndërsa për vitin 2021, krahasuar me vitin 2020 janë ulur me 767,150 lekë, duke ndikuar negativisht në totalin e të ardhurave të mbledhura nga spitali, e cila reflektohet në uljen e nivelit të të ardhurave të realizuara në vitin përkatës.
Për të ardhurat nga parkimi me qëllim menaxhimin e hapsirave të parkimit në territorin e spitalit është nxjerrë urdhri i drejtorit nr.115, datë 09.11.2018, ku janë përcaktuar edhe tarifat orare të qëndrimit të automjeteve.
Të ardhurat në total për vitin 2019 krahasuar me 2018, janë ulur në shumën 12,200 lekë, për vitin 2020 krahasuar me 2019, të ardhurat janë ulur në shumën 14,650 lekë dhe për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020, janë ulur në shumën 373,718 lekë.
Megjithëse të ardhurat nga shërbimet spitalore janë nivele të qëndrueshme, janë ulur me 767,150 lekë, të ardhurat nga parkimi krahasuar me vitin 2020, si rezultat i mosshfrytëzimit të sipërfaqes së parkimit në favor të spitalit, veprim në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", i ndryshuar, pika 10 **"**Përgjegjësitë e menaxherëve të tjerë, nëpunësve dhe punonjësve publike" dhe rregulloren e institucionit Kreu II "Detyrat dhe kompetencat e zv/drejtorit ekonomik".
Udhëzimi nr.2, datë 11.02.2014, i FSDKSH, përcakton edhe % e përdorimit të të ardhurave për Spitalet Universitare, Spitalet Rajonale dhe Spitalet Bashkiake.
Përdorimi i të ardhurave, referuar përqindjeve të përcaktuara në udhëzim është i paraqitur si më poshtë:

Përdorimi i të ardhurave dytësore	Çelur 2018	Përdorur 2018	Çelur 2019	Përdorur 2019	Çelur 2020	Përdorur 2020	Çelur 2021	Përdorur 2021
Për investime	7,012,753	6,520,611	3,302,302	3,073,063	3,339,505	1,116,025	6,026,685	5,850,725
Mallra	4,311,106	2,668,053	5,389,933	178,080	8,778,873	417,480	3,591,533	-
Për paga	7,377,194	*3,294,975*	6,892,379	1,850,445	7,717,198	1,758,640	2,693,650	1,328,276
a. Përdorur gjatë vitit ushtrimor	**18,701,053**	***12,483,639***	**15,584,614**	***5,101,588***	**19,835,576**	***3,292,145***	**16,543,431**	***7,179,001***
b. Mbetur pa përdorur të ardhura të çelura	9,355,000	3,137,586	9,367,200	2,580,921	9,352,550	582,285	8,978,832	-
Të ardhura të trashëguara në vitin 2018	9,346,053	***9,346,053***	6,217,414	***2,520,667***	10,483,026	**2,709,860**	16,543,431	**7,179,001**
Çelur gjithsej të ardhura	**18,701,053**	**12,483,639**	**15,584,614**	**5,101,588**	**19,835,576**	**3,292,145**	**25,522,263**	**7,179,001**

Burimi: Të dhëna të marra nga evidenca e rakorduar me degën e thesarit

Siç shihet dhe nga tabela e mësipërme, për vitin 2018 të ardhurat dytësore janë përdorur në vlerën *12,483,639* lekë, ndërsa pjesa e papërdorur në vlerën 3,137,586 lekë, është mbartur në vitin 2019. Për vitin 2019, të ardhurat dytësore janë përdorur në vlerën *5,101,588 lekë*, ndërsa pjesa e papërdorur në vlerën 2,580,921 lekë, është mbartur në vitin 2020. Për vitin 2020, të ardhurat dytësore janë përdorur në vlerën 3,292,145 lekë, ndërsa pjesa e papërdorur në vlerën 582,285 lekë, është mbartur në vitin 2021. Për vitin 2021, të ardhurat dytësore të krijuara janë përdorur në vlerën 7,179,001 lekë dhe nuk ka vlerë të papërdorur.

Përdorimi i të ardhurave dytësore për vitet 2018, 2019 dhe 2020, është kryer duke respektuar përqindjet e përcaktuara në Udhëzimin e Fondit të Sigurimit të Detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor nr. 2, datë 11.02.2014 "Për përdorimin e të ardhurave që realizojnë Spitalet nga veprimtaria e tyre dhe nga dhurimet".

Çelja e të ardhurave për përdorim, është realizuar sipas shkresave të autorizuara nga SSr, miratuar nga thesari mbas krijimit të të ardhurave përkatëse, ku për çdo fond të autorizuar janë përcaktuar përqindjet e përdorimit për lloj shpenzimi si "paga", "shpenzime operative", apo "investime". Gjithashtu për të ardhurat dytësore të përdorura, sipas rastit, është marrë autorizim për përdorimin e tyre nga ana e FSDKSH-se apo MSHMS sipas natyrës së shpenzimit që është kryer.

Përsa më sipër ngarkohet me përgjegjësi z. F. S me detyrë zv/drejtor ekonomik.

Titulli i gjetjes:	Mangësi në mbledhjen e të ardhurave
Situata:	*Të ardhurat nga shërbimet spitalore* për vitin 2019, krahasuar me vitin 2018, janë ulur me 511, 850 lekë, ndërsa në vitet 2019, 2020 dhe 2021, janë në nivele të qëndrueshme, ndërsa *të ardhurat nga parkimi*, janë ulur ndjeshëm në vitin 2021. Krahasuar vitin 2019 me 2018, rezulton se të ardhurat nga ky burim janë rritur me 524,050 lekë, për vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, janë rritur me 167,300 lekë, ndërsa për vitin 2021, krahasuar me vitin 2020 janë ulur me 767,150 lekë, duke ndikuar negativisht në totalin e të ardhurave të mbledhura nga spitali, e cila reflektohet në uljen e nivelit të të ardhurave të realizuara në vitin përkatës. Për të ardhurat nga parkimi me qëllim menaxhimin e hapsirave të parkimit në territorin e spitalit është nxjerrë urdhri i drejtorit nr.115, datë 09.11.2018, ku janë përcaktuar edhe tarifat orare të qëndrimit të automjeteve. Të ardhurat në total për vitin 2019 krahasuar me 2018, janë ulur në shumën 12,200 lekë, për vitin 2020 krahasuar me 2019, të ardhurat janë ulur në shumën 14,650 lekë dhe për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020, janë ulur në shumën 373,718 lekë.

	Megjithëse të ardhurat nga shërbimet spitalore janë nivele të qëndrueshme, janë ulur me 767,150 lekë, të ardhurat nga parkimi krahasuar me vitin 2020, si rezultat i mosshfrytëzimit të sipërfaqes së parkimit në favor të spitalit
Kriteri:	Udhëzimi nr.30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", i ndryshuar, pika 10 **"**Përgjegjësitë e menaxherëve të tjerë, nëpunësve dhe punonjësve publike" dhe rregulloren e institucionit Kreu II "Detyrat dhe kompetencat e zv/drejtorit ekonomik".
Ndikimi:	Ulje e të ardhurave të spitalit
Shkaku	Keqmenaxhim
Rëndësia:	E lartë
Rekomandim:	Drejtori i Spitalit, Drejtoria ekonomike dhe shërbimeve, të marrë masa për venien në funksionim të parkimit në ambientet e brendshme me qëllim shfrytëzimin e hapsirave për parkim në dobi të spitalit dhe rritjen e të ardhurave.

2.7. Mbi funksionimin e sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Menaxhimi financiar dhe kontrolli kanë të bëjnë me forcimin e performancës së institucionit që të marrë vendime më të mira ku të ofrohen shërbime më të mira dhe të japë vlerë më të mirë për paranë. Për të arritur këtë menaxhimi financiar dhe kontrolli synon që menaxhmenti i institucionit të jetë përgjegjës jo vetëm për marrjen e vendimeve financiare por edhe për të siguruar që këto vendime të jenë dobiprurëse dhe në interes më të mirë të publikut.
Kjo do të thotë që të sigurohet se paratë publike shfrytëzohen mirë dhe shfrytëzimi i tyre shtrihet sa më shumë që është e mundur nëpërmjet përdorimit efikas, efektiv dhe ekonomik të burimeve si personeli, pasuritë dhe buxhetit. Në drejtim të vlerësimit të sistemeve të kontrollit të brendshëm të Spitalit Bashkiak Sarandë (në vijim SBR) janë kryer verifikimet për implementimin dhe plotësimin e kërkesave në lidhje me funksionimin, përgjegjshmërinë menaxheriale, realizimit të objektivave të institucionit për përdorimin me efektivitet të fondeve të tij. Duke u bazuar në Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, nga grupi i auditimit u hartuan pyetësorë mbi organizimin dhe implementimin e këtij ligji dhe ju dorëzuan strukturave drejtuese për të paraqitur dokumente në zbatim të këtij drejtimi.
Në mbështetje të përgjigjeve të pyetësorit si dhe referuar dokumentacionit të vënë në dispozicion konstatohet se:
-Mjedisi i Kontrollit
Mjedisi i kontrollit është baza e menaxhimit të fondeve buxhetore dhe përbën themelin, ku ngrihen të gjithë komponentët e tjerë të kontrollit të brendshëm. Titullarët e njësive të sektorit publik janë përgjegjës për ngritjen, gjendjen dhe përmirësimin e mjedisit të kontrollit.
a. Integriteti personal dhe etika profesionale e nivelit menaxhues dhe punonjësve të tjerë të institucionit:
Titullari i njësisë publike dhe të gjithë anëtarët e stafit duhet të udhëhiqen nga integriteti personal dhe profesional në marrjen e vendimeve dhe në kryerjen e detyrave të tyre. Sipas përcaktimeve të Manualit të Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016, në Kapitullin III, pika 3.1 përcaktohet se: "Kuadri i sjelljes së menaxherëve dhe stafit duhet të përcaktohen nga titullari i njësisë publike në një Kod të Brendshëm Etike, ose në një Kod Sjelljeje". Gjithashtu edhe në zbatim të Ligjit nr. 9367, datë 07.04.2005, "Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike", i ndryshuar, dhe të Ligjit nr. 9131, datë 08.09.2003, "Për rregullat e etikës në administratën publike", institucionet duhet të hartojnë kod etike.

-SBR nuk disponon Kod Etike në të cilin të përcaktohen sjelljet e pranuara të stafit dhe menaxherëve si dhe rastet e konfliktit të interesit. Gjithashtu, rregullat e etikës nuk janë as pjesë e rregullores së brendshme si dhe Institucioni nuk ka një komision etike për të trajtuar këto çështje.

b. Politikat menaxheriale dhe stili i punës:

Stili i të vepruarit dhe filozofia e menaxhimit reflektojnë pikëpamjet kryesore të drejtuesit rreth mënyrës se si duhen organizuar punonjësit dhe aktivitetet e një njësie. Çdo drejtues ka një filozofi dhe një stil pune të veçantë, nëpërmjet të cilit ai/ajo menaxhon punonjësit, demonstron dhe nxit kompetencën dhe sjelljen etike.

Qasja ndaj punës dhe ngritja e sistemeve, zakonisht paraqiten në një strategji institucionale. Në nenin 8, pika 8/a, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, përcaktohet se: "Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore: a) miratimin e politikave dhe monitorimin e objektivave të njësive publike që ata drejtojnë, të planeve strategjike e vjetore, përfshirë strategjinë e menaxhimit të riskut dhe të plan-veprimeve për arritjen e objektivave".

-SBR nuk ka hartuar një strategji institucionale në të cilën të paraqiten prioritetet dhe objektivat si dhe planet e veprimit për arritjen e tyre.

Gjithashtu, po në nenin 8, pika 8/b, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, përcaktohet se: "Titullarët e njësive publike në fushën e menaxhimit financiar dhe kontrollit kanë këto kompetenca kryesore: b) ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik të njësisë publike".

Në nenin 27, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, përcaktohet se: "Grupi për menaxhimin strategjik përbëhet nga titullari i njësisë publike, zëvendës titullarët, nëpunësi autorizues, nëpunësi zbatues dhe të gjithë menaxherët e tjerë të nivelit të lartë. Kreu i auditimit të brendshëm merr pjesë në mbledhjet e grupit për menaxhimin strategjik pa të drejtë vendimmarrjeje. Çështjet, që lidhen me menaxhimin financiar dhe kontrollin, duhet të diskutohen gjatë takimeve periodike ndërmjet menaxherëve të niveleve të ndryshme në njësinë publike. Çështjet kryesore dhe mangësitë serioze që dalin brenda njësisë i parashtrohen grupit për menaxhimin strategjik, me qëllim diskutimin e mëtejshëm dhe marrjen e masave".

-Për vitet 2018-2021 SBR nuk disponon urdhër për ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik.

c) Struktura organizative, garantimi i ndarjes së detyrave, hierarkia dhe rregulla të qarta, të drejtat, përgjegjësitë dhe linjat e raportimit:

SBR Sarandë e kryen aktivitetin e saj në bazë të një rregullore të brendshme e vitit 2018 e lidhur nëpërmjet Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale dhe Drejtoria e Shërbimit Spitalor Sarandë "Spitali Petro Nako Sarandë".

ç*) Politikat dhe praktikat e menaxhimit të burimeve njerëzore:*

-Për periudhën objekt auditimi nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të personelit nuk është kryer vlerësimi i punës për çdo punonjës i cili realizohet çdo 6 mujor.

-Gjithashtu nuk janë hartuar dhe miratuar programe specifike për trajnimin e stafit. Punonjësit kanë mangësi të mëdha në trajnime, pasi nuk janë përfshirë në programe trajnimi, si dhe njohuritë e tyre në lidhje me kuadrin rregullator ligjor mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin rezultojnë të jenë shumë të dobëta.

-Menaxhimi i riskut

Menaxhimi i riskut përmban identifikimin, vlerësimin dhe kontrollin mbi ato ngjarje apo situata të mundshme, që kanë efekt të dëmshëm për përmbushjen e objektivave të njësisë publike, dhe kryhet për të dhënë siguri të arsyeshme se këto objektiva do të realizohen.

Në nenin 21, pika 2, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, përcaktohet se: "Për t'i zbatuar veprimtaritë e menaxhimit të riskut, titullari i njësisë publike miraton një strategji, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka

ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut. Nëpunësi autorizues analizon dhe përditëson kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, të paktën një herë në vit".
-SRB nuk ka hartuar dhe miratuar Strategjinë e Riskut, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut, nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, pra nuk është identifikuar dhe krijuar një regjistër risku, vlerësimi, për kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave. Nuk janë përcaktuar personat përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin dhe implementimin e kësaj strategjie.
-Gjithashtu, SBR për periudhën nën auditim nuk ka hartuar regjistër risku, në kundërshtim me nenin 12, pika 3 e Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, ku përcaktohet se: "Nëpunësit zbatues të të gjitha niveleve të njësisë publike përgjigjen përpara nëpunësit autorizues përkatës për: d) identifikimin dhe krijimin e regjistrit të riskut, vlerësimin, kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave dhe realizimin me sukses të veprimtarive të strukturave që ata drejtojnë".
SBR nuk disponon as procedurë të menaxhimit të riskut ku të bëhet identifikimi, analiza dhe kontrolli i risqeve dhe as raporte monitorimi të fushave me risk.
Pavarësisht rëndësisë që ka identifikimi i risqeve dhe menaxhimi i tyre, Spitali Bashkiak Sarandë nuk ka ndërmarrë asnjë veprim lidhur me këtë çështje. Mungesa e një strategjie risku, e një regjistri risku dhe e identifikimit të risqeve me qëllim marrjen e masave për eliminimin apo zbutjen e efektit të tyre, cenon arritjen e objektivave dhe performancën institucionale.
-Veprimtaritë e kontrollit
Aktivitetet e kontrollit janë rregullat, procedurat dhe veprimet që synojnë reduktimin e risqeve në mënyrë që të arrihen qëllimet dhe objektivat e njësisë dhe të nxisin zbatimin e vendimeve të drejtuesve. Mungesa e identifikimit të risqeve, mungesa e një strategjie institucionale në të cilën të jenë përcaktuar objektivat dhe planet e veprimit, si dhe mungesa e qartë e ndarjes së detyrave në Spitalin Bashkiak Sarandë, vështirësojnë kryerjen efektive të kontrolleve, identifikimin e parregullsive dhe nxjerrjen e përgjegjësive.
Në kuadër të zbatimit të veprimtarisë së kontrollit, në nenin 16, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, përcaktohet se: "Titullarët e njësive publike miratojnë gjurmët e auditimit, për procedura që lidhen me veprimtari kryesore të njësisë dhe sigurojnë që të gjitha operacionet e njësisë publike dokumentohen në atë formë, që u mundëson audituesve të brendshëm, të jashtëm dhe autoriteteve mbikëqyrëse të kuptojnë mjedisin e kontrollit. Gjurma e auditimit arkivohet sipas dispozitave ligjore në fuqi".
-SBR nuk ka hartuar, miratuar, arkivuar Gjurmët e Auditimit, e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkrojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimit, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve. Që ka si qëllim të ndihmojë menaxhimin për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të identifikojë boshllëqet.
-Informacioni dhe komunikimi
Komunikimi është shkëmbimi i informacioneve të dobishme ndërmjet punonjësve të të gjitha niveleve të njësisë publike, si horizontalisht dhe vertikalisht, dhe ndërmjet njësive publike për të mbështetur vendimet dhe për të koordinuar aktivitetet. Informacioni duhet t'i komunikohet menaxhimit dhe punonjësve të tjerë, në formën dhe brenda një harku kohor, që i ndihmon ata për të kryer përgjegjësitë e tyre. Komunikimi me furnitorët e shërbimeve, rregullatorët dhe palët e tjera të jashtme është gjithashtu thelbësor për kontrollin e brendshëm efektiv.
Në lidhje me komunikimin e brendshëm, në mungesë të aktit rregullator mbi organizimin dhe funksionimin e Spitalit Bashkiak Sarandë, është e paqartë dhe e paverifikueshme bazuar në shkresat zyrtare se si titullari informohet nga përgjegjësit e sektorëve, nëse realizohet me anë të takimeve e mbledhjeve, relacioneve apo raporteve të ndryshme. Gjithashtu është e pa

verifikueshme mënyra e përcaktuar për komunikimin e punonjësve brenda institucionit dhe jashtë institucionit.
-Në lidhje me komunikimin e jashtëm, SBR nuk ka një faqe zyrtare ëeb në të cilën paraqiten informacione për publikun.
-Monitorimi
Titullarët e njësive publike janë përgjegjës për ngritjen e një sistemi për monitorimin e menaxhimit financiar dhe të kontrollit, me qëllim vlerësimin lidhur me funksionimin e duhur dhe garantimin e përditësimit të tij, sa herë që ndryshojnë.
Monitorimi i sistemit të MFK nga titullari mund të realizohet nëpërmjet pyetësorit të vetëvlerësimit të kontrollit të brendshëm, sikurse paraqitet në Shtojcën 2 të Manualit për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin. Duke ju përgjigjur pyetjeve të pyetësorit të vetëvlerësimit, institucioni bën vlerësimin e zhvillimit të komponentëve të veçantë të kontrollit të brendshëm, ku çdo përgjigje me jo tregon se ka mangësi dhe duhen marrë masa për përmirësime.
-Për vitet 2018-2021 SBR nuk ka plotësuar asnjë pyetësor vetëvlerësimi në mënyrë që të identifikojë problematikat e kontrollit të brendshëm me qëllim përmirësimin e tyre, në kundërshtim kjo me kërkesat e Kapitullit III të Manualit të MFK, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.
Në nenin 18 pika 1, të Ligjit nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar, përcaktohet se "Nëpunësi autorizues i njësisë publike, në bazë të vetëvlerësimeve, depoziton te titullari i njësisë publike dhe nëpunësi i parë autorizues një deklaratë dhe raportin përkatës për cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrolleve të brendshme të njësisë publike që mbulon, për vitin e mëparshëm, jo më vonë se fundi i muajit shkurt të vitit aktual".
-Për vitet 2018-2021 SBR nuk ka hartuar deklaratën dhe raportin mbi cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm, në kundërshtim me nenin 18 të ligjit për MFK-në.
Si konkluzion, nga ana e drejtimit institucional nuk është vënë në funksionim Ligji për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, nuk njihet nga strukturat drejtuese të SBR e punonjësit e saj, nuk ka funksionuar në asnjë hallkë të njësisë dhe për pasojë, drejtuesit nuk kanë bërë një vlerësim të efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit.

Titulli i gjetjes:	Mangësi në vlerësimin dhe veprimet/masat e menaxhmenti për të kontrolluar dhe reaguar ndaj rreziqeve që ekspozohet spitali.
Situata:	Në lidhje me implementimin e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollin nga Spitali Bashkiak Sarandë konstatohen këto parregullsi: -Nuk disponon Kod Etike në të cilin të përcaktohen sjelljet e pranuara të stafit dhe menaxherëve si dhe rastet e konfliktit të interesit. Gjithashtu, rregullat e etikës nuk janë as pjesë e rregullores së brendshme si dhe Institucioni nuk ka një komision etike për të trajtuar këto çështje. -Nuk ka hartuar një strategji institucionale në të cilën të paraqiten prioritetet dhe objektivat si dhe planet e veprimit për arritjen e tyre. -Nuk disponon urdhër për ngritjen e grupit të menaxhimit strategjik. -Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të personelit nuk është kryer vlerësimi i punës për çdo punonjës i cili realizohet çdo 6 mujor. -Nuk janë hartuar dhe miratuar programe specifike për trajnimin e stafit. Punonjësit kanë mangësi të mëdha në trajnime, pasi nuk janë përfshirë në programe trajnimi, si dhe njohuritë e tyre në lidhje me kuadrin rregullator ligjor mbi menaxhimin financiar dhe kontrollin rezultojnë të jenë shumë të dobëta.

	-Nuk ka hartuar dhe miratuar Strategjinë e Riskut, e cila përditësohet çdo tre vjet ose sa herë që ka ndryshime thelbësore të mjedisit të riskut, nuk janë analizuar dhe përditësuar kontrollet që synojnë minimizimin e riskut, pra nuk është identifikuar dhe krijuar një regjistër risku, vlerësimi, për kontrollin e risqeve që vënë në rrezik arritjen e objektivave. Nuk janë përcaktuar personat përgjegjës për ndjekjen dhe monitorimin dhe implementimin e kësaj strategjie. -Nuk ka hartuar, miratuar, arkivuar Gjurmët e Auditimit, e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre, që synon të ripërshkrojë të gjitha veprimtaritë individuale dhe vendimmarrjen lidhur me to. Ajo përfshin mbajtjen e dokumentacionit, raportimit, kontabilitetin dhe sistemin e mbajtjes së dosjeve. Që ka si qëllim të ndihmojë menaxhimin për të vlerësuar përshtatshmërinë e sistemeve të menaxhimit financiar dhe kontrollit, të identifikojë boshllëqet. -Në lidhje me komunikimin e jashtëm, SBR nuk ka një faqe zyrtare ëeb në të cilën paraqiten informacione për publikun. -Për periudhën objekt auditimi nuk ka plotësuar asnjë pyetësor vetëvlerësimi në mënyrë që të identifikojë problematikat e kontrollit të brendshëm me qëllim përmirësimin e tyre. -Për periudhën objekt auditimi nuk ka hartuar deklaratën dhe raportin mbi cilësinë dhe gjendjen e sistemeve të kontrollit të brendshëm.
Kriteri:	Ligji nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar si dhe Manuali i Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016.
Ndikimi/Efekti:	Menaxhmenti, ndonëse ka zbatuar një numër kontrollesh të brendshme për të siguruar se sistemet funksionojnë si duhet, nevojiten aktivitete shtesë për të forcuar kontrollet në raportimin menaxherial, llogaridhënie dhe menaxhim të rrezikut.
Shkaku:	Mos njohje sa dhe si duhet e dispozitave ligjore që rregullojnë menaxhimin financiar dhe kontrollin.
Rëndësia:	E lartë.
Rekomandim:	Spitali Bashkiak Sarandë të marrë masa për të rritur performancën në drejtim të përdorimit efikas, efektiv dhe ekonomik të burimeve, të personelit, pasurive dhe buxhetit në zbatim të fondeve buxhetore që menaxhmenti i spitalit të jetë përgjegjës, jo vetëm për marrjen e vendimeve por edhe për të siguruar që këto vendime të jenë efektive, si hartimin dhe menaxhimin e strategjisë dhe regjistrit të riskut, krijimin e listave të proceseve kryesore dhe gjurmët e auditimit, me qëllim arritjen e mjaftueshme të aktiviteteve të kontrollit për identifikimin, kontrollin dhe reduktimin e risqeve, si edhe përfshirjen efektive të sektorëve të ndryshëm në procese, dokumentacionin përkatës, përgjegjësitë personale, mbështetjen e sistemeve të IT.

Për veprimet dhe mos veprimet e mësipërme ngarkohen me përgjegjësi: z. T. L, z. E. Dh, z.A. K, F. Ll dhe z. F. S.

IV.GJETJET DHE REKOMANDIMET
A. MASA ORGANIZATIVE

1. Gjetje nga auditimi: Procesverbali për përllogaritjen e fondit limit, në procedurën me objekt "Rikonstruksion i ambienteve të pediatrisë", është mbajtur në datë 02.09.2020. Fondi limit është bazuar në preventivin e përgatitur nga z. E. R, me licencë A.1279/1, me vlerë 4,918,148 lekë. Çmimet e preventivit, në përgjithësi janë aplikuar bazuar në manualet e çmimeve të ndërtimit, për rastet kur nuk ka referenca, janë hartuar analiza teknike.
Nga verifikimi sipas zërit 2.204/1 "Bojë hidroplastike importi cilësi e parë", është aplikuar çmimi 471 lekë për m^2, ndërsa referuar manualeve të punimeve të ndërtimit 2015, çmimi është 431 lekë. Sipas zërit të mësipërm, fondi limit është rritur në mënyrë të pa argumentuar me vlerë 53,280 lekë [1332 m^2 (471 lekë/m^2 – 431 lekë/m^2)].
- Sipas zërit An.7 "F.V dyer druri me veshje MDF dhe me mbushje material termik" nga ana e z. E. R, në analizën e çmimit është përcaktuar vlera 30,000 lekë/m^2, ndërsa në preventiv është përcaktuar vlera 37,000 lekë/m^2. Sipas këtij zëri fondi limit është rritur në mënyrë të pa argumentuar me vlerë 175,000 lekë [25 m^2 x (37,000 lekë/m^2 – 30,000 lekë/m^2).
- Sipas zërit An.8 "F.V portë duralumini me dyfish xham dhe me sistem elektronik për hapje" nga ana e z. E. R, në analizën e çmimit është përcaktuar vlera 30,000 lekë/m^2, ndërsa në preventiv është përcaktuar vlera 42,000 lekë/m^2. Sipas këtij zëri fondi limit është rritur në mënyrë të pa argumentuar me vlerë 76,800 lekë [6.4 m^2 x (42,000 lekë/m^2 – 30,000 lekë/m^2).
Sa më sipër, fondi limit është rritur në mënyrë të pa argumentuar me vlerë 305,080 lekë. Duke qenë se kontrata është nënshkruar me vlerë 4,378,010 lekë, konsiderohet se veprimi i mësipërm nuk ka krijuar pasoja financiare. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 56-73, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
1.1.Rekomandim: Komisionet e përllogaritjes së fondit limit, duhet të aplikojnë çmime me referenca të sakta të manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit. Në rastet kur çmimi i referencës nuk është pjesë e çmimeve të manualit, atëherë duhet të merren për referencë çmimet e zërave më të përafërt, ose duke hartuar analiza të sakta të kostos.

Vazhdimisht

2. Gjetje nga auditimi: Për zbatimin e procedurave të prokurimit me objekt "*Blerje lëndë djegëse, pelet*", si dhe "Rikonstruksion i ambienteve të pediatrisë", njësia e prokurimit dhe KVO janë ngritur pa patur në përbërje një specialist të fushës, veprim ky në kundërshtim me VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (shfuqizuar) neni 57, pika 4 dhe neni 58.*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 56-73,të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
<u>2.1.Rekomandim:</u> Drejtoria e Shërbimit Spitalor Sarandë, të marrë masa për krijimin e komisioneve me përbërje të paktën një specialist i fushës, në mënyrë që t'i japë zgjidhje problemeve teknike që lindin gjatë zbatimit të procedurave të prokurimit për realizimin e tyre me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet.

Vazhdimisht

3.Gjetje nga auditimi: Sipas procedurës së prokurimit me objekt "*Blerje lëndë djegëse, palet*", me kontrate nr. 262 prot., datë 15.02.2019 me vlerë 3,365,712 lekë në kriteret teknike pika 2, është përcaktuar që OE duhet të ketë gjendje dy kaldaja për palet (me fuqi 480 -500 KW) me disa nga karakteristikat të tilla si: Tipi KN-AT, fuqia motorike 1100 Ë, dimensionet (2750 mm x 2180 mm x 1720 mm), pesha 1850 kg, kapaciteti ditor i silozit 1.5 m^3. Në kriteret teknike pika 3, është kërkuar të ketë gjendje dy bruciatorë për palet me karakteristika: Modeli BP 500 kw, dimensionet (380 x 420 x 1250 mm), shneku me diametër, 125 mm, fuqia e motorit të shnekut 190 W dhe dimensioni i tubit të shkarkimit 75 mm.

Vendosja e specifikimeve si më sipër kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurën e prokurimit, pasi për makineri të ndryshme dhe me dimensione të ndryshme nga ato të kërkuara, mund të realizohet i njëjti proces, me të njëjtën prodhueshmëri, apo kapacitet.
Në procedurën e prokurimit me objekt "*Rikonstruksion i ambienteve të pediatrisë*", është kërkuar që shoqëria duhet të ketë të punësuar në stafin teknik për kryerjen e punimeve në këtë objekt, të vërtetuar me kontratën individuale të punës të vlefshme, diplomë, si dhe të figurojë në listëpagesat e shoqërisë për periudhën gusht-tetor 2020, **1 inxhinier ndërtimi**, **një inxhinier hidroteknik dhe 1 inxhinier elektrik**. Duke qenë se kemi të bëjmë me punime rikonstruksioni dhe në volume jo të konsiderueshme, është i mjaftueshëm që një OE të ketë të punësuar një inxhinier ndërtimi, ose inxhinier hidroteknik, madje punimet elektrike kanë të bëjnë vetëm me zëvendësime instalimesh, kërkesa për specialist elektrik është e mjaftueshme.
Kërkesat për tre inxhinierë të punësuar, mund të reduktojë numrin e operatorëve pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, sidomos të ndërmarrjeve të vogla që operojnë në fushën e ndërtimit.
Në tenderin me objekt "*Blerje lëndë djegëse, palet*", kanë marrë pjesë 2 OE, nga të cilët vetëm njëri OE ka paraqitur dokumentacion. OE "A." SHPK, shpallur fitues nuk ka paraqitur dokumentacion që të vërtetojë përputhshmërinë e specifikimeve teknike sa i takon dimensioneve të kaldajës, kapacitetit ditor të silozit, dimensionin e tubit të shkarkimit etj. Mangësitë e mësipërme ndikojnë në garancinë që jep makineria për përballimin e nevojave sipas kapacitetit të parashikuar.
Veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" (i shfuqizuar), neni 23, pika 2, neni 46, pika 3 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (shfuqizuar) neni 26, pika 5. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 56-73, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
3.1.Rekomandim: Drejtoria e Shërbimit Spitalor Sarandë, të marrë masa për trajnimin e vazhdueshëm të punonjësve që angazhohen me zbatimin e procedurave të prokurimit, me synim realizimin e tyre me ekonomicitet, eficiencë dhe efektivitet.

Vazhdimisht

4. Gjetje nga auditimi: Referuar realizimit të buxhetit për vitet 2018-2021, konstatohet se nga Spitali Sarandë përveç pamjaftueshmërisë së fondeve dhe mosplotësimit të kërkesave në rritje për shtesë fondesh rezultojnë edhe tejkalime tej parashikimit në mallra të ndryshëm, zëra për të cilët nuk është treguar vëmendje prioritare që në planifikimin e viteve të ardhshëm të bazohen në arritjet e një viti më parë si edhe në pritshmëritë referuar sëmundjeve dhe epidemive në qarkullim. Nga auditimi ka rezultuar se, për planifikimin e nevojave vjetore për barna dhe materiale mjekësore nga Shërbimet mjekësore, gjatë hartimit të projektbuxhetit dhe planit buxhetor (pas miratimit), nuk bëhet analizë mbi gjendjen e ilaçeve, sasinë e konsumit të tyre vjetore, në mënyrë që të justifikojnë dhe argumentojnë listën për nevojat e këtyre barnave. Rritja e sasive të barnave të porositura nuk është e shoqëruar me relacione shpjeguese dhe argumentuese për justifikimin e sasive shtesë. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.2, faqe 16-24, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
4.1.Rekomandim: Strukturat drejtuese në vazhdimësi të marrin masa për ndjekjen e procedurave të hartimit të PBA, duke siguruar që planifikimet të kryhen mbështetur në analiza të dinamikës të vlerësimit të kostove të nevojshme për ruajtjen e sasisë dhe cilësisë të shërbimeve të ofruara, vlerësimin e të dhënave historike të shpenzimeve, kostove për njësi, si edhe në pritshmëritë referuar sëmundjeve dhe epidemive në qarkullim, duke rritur kërkesat për artikujt të cilët rezultojnë me tejkalim dhe minimizimin e shpenzimeve të tjera, me qëllim uljen e detyrimeve të papaguara të cilat deri në vitin 2021 kanë qenë në nivel të lartë.

Vazhdimisht

5. Gjetje nga auditimi: Nga departamenti i financës, regjistrimet e veprimeve kontabël, janë kryer me regjistra ose në programin Excel dhe jo me "Bartës informatikë", të cilët janë programe informatike të pa manipulueshme dhe të printueshme në çdo kohë, gjë e cila ndikon në pasaktësi gjatë procesit të regjistrimit të dokumenteve financiarë, si dhe gabime gjatë kuadrimit të veprimeve kontabël, në kundërshtim me ligjin nr. 25/2018, "Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare", neni 3, pika 14 që përcakton mënyrën se si mbahet dokumenti kontabël dhe pikën 15 për "Bartësit kontabël" Neni 3 Përkufizime, neni 7, Dokumenti kontabël dhe neni 8.*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.4, faqe 27-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

5.1.Rekomandim: Strukturat drejtuese të Spitalit Sarandë të marrin masa për evidentimin e saktë të veprimeve në kontabilitet, nëpërmjet prokurimit të një programi financiar me qëllim përmirësimin e mbajtjes së skedave të kontabilitetit, për të rritur cilësinë e regjistrimit, përpunimit dhe hartimit të pasqyrave financiare.

Menjëherë

6. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Pasqyrave financiare për periudhën objekt auditimi u konstatua se:

-Nuk janë zbatuar drejt parimet e përgjithshme për përgatitjen e llogarive vjetore dhe mbajtjen e kontabilitetit, sipas përcaktimeve të dispozitave ligjore për kontabilitetin. -Azhurnimet e veprimeve ekonomike janë mbajtur kronologjikisht dhe kontabilizimet e tyre janë kryer në ditarët e bankës, arkës, magazinës, pagave, etj, por nuk janë mbajtur partitarët për llogaritë kreditore e debitore.

-Nuk është mbajtur libri i madh apo libri centralizator për evidentimin e veprimeve kontabël të kryera, për të kaluar nga ditarët në fletë-kontabilizimet apo kartelat kontabël deri në bilancin vërtetues rezultuar nga prerja e artikujve kontabël.

-Nuk është mbajtur libri i veprimeve të ndryshme për evidentimin e sistemimeve të ndryshme në kartelat kontabël. Këto libra kontabël janë bartës të informacionit të regjistruar në mënyrë kronologjike dhe sistematike të efekteve të veprimeve të kryera, të marra nga dokumentet vërtetuese, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8 datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar, Kreu III, pika 3.2 "Procedurat e mbylljes së llogarive vjetore të njësive të qeverisjes së përgjithshme" *Nënpikat 43, 44 dhe 45 i ndryshuar. (Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 27-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

6.1. Rekomandim: Sektori i Financës të marrë masë që në mbajtjen e kontabilitetit dhe hartimin e pasqyrave financiare, të zbatojë parimet e kontabilitetit në procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare duke ndjekur fazat në mënyrë logjike, që nga mbajtja e dokumenteve përmbledhës të transaksioneve dhe veprimeve që rezultojnë nga mbajtja e kontabilitetit në ditarët përkatës kronologjik, saktësimin e pozicionit të çeljes së llogarive nga viti i mëparshëm dhe pas verifikimit paraprak të pozicionit të llogarive, të cilat duhet të jenë të balancuara, dhe në fund kryerjen e veprimeve të mbylljes së llogarive, deri në pozicionin përfundimtar të tyre, duke evidentuar edhe në librin e veprimeve të ndryshme sistemimet me të gjitha të dhënat e kryera në llogaritë e ndryshme sipas rastit.

Vazhdimisht

7. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i Pasqyrave financiare për periudhën objekt auditimi u konstatua se:

-Për aktivet afatgjata jo materiale (Klasa20), konstatohet se Vlera e mbetur në fund të vitit 2021 prej ***10,411,705 lekë*** e aktiveve afatgjata jo materiale e paraqitur në gjendjen e *llogarisë 202 "Studime dhe Kërkime",* është e pa analizuar dhe nuk ka të dhëna se çfarë përfaqëson.

-Vlera e projekt-studimeve për investime të kryera nuk është shpërndarë sipas llojit të aktiveve materiale, ku janë kryer investimet, pavarësisht se punimet kanë përfunduar në vitet e mëparshme. Për këtë vlerë nuk ekziston inventar kontabël dhe fizik dhe nuk dihet se ku janë ruajtur, nëse janë bërë hyrje në arkiv në çdo dosje teknike të tenderave sipas investimit të kryer

në aktivet materiale afatgjatë, veprime në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03. 2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Kreu III. "Procedurat për përgatitjen, paraqitjen dhe konsolidimin e pasqyrave financiare në njësitë e Qeverisjes së Përgjithshme", pika 36 i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 27-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

7.1. Rekomandim: Sektori i Financës të analizojë vlerën ***10,639,223 lekë*** me emërtesat përkatëse të projekt-studimeve dhe të kryejë veprimet e sistemimit në kontabilitet për shpërndarjen e vlerës të studim-projektimeve sipas investimeve të kryera dhe për çdo lloj aktivi afatgjatë material si pjesë e kostos së tij, duke kredituar llog. 202 "Studime dhe Kërkime "dhe debituar llogaritë përkatëse të klasës 21 për vlerat e mbetura koresponduese, në mënyrë që aktivet sipas llojit të paraqiten në vlerë të plotë. Gjithashtu të bëjë korrektimet e duhura për llogaritjen e amortizimit të tyre dhe sistemimet kontabël përkatëse.

Me mbylljen e pasqyrave të vitit 2022

8. Gjetje nga auditimi: *Gjendja e llogarisë 214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune"* në vlerë neto paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 38,862,568 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në shumën 37,459,894 lekë. Ndërsa në vlerë historike (vlerë bruto) paraqitet në mbyllje të vitit 2020 në vlerën 147,569,642 lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 paraqitet në vlerën 243,833,407 lekë, pra kemi shtesë në vlerën 96,263,765 lekë, ku 540,454 lekë është shtesë pa pagesë për të cilën nuk ka emërtim dhe analizë se nga ka ardhur, po kështu edhe vlera prej 95,723,311 lekë, nga lëvizjet brenda aktiveve, vlerë për të cilën nuk ka asnjë të dhënë se çfarë veprime sistemimi kontabël janë kryer, pasi nuk është mbajtur ditari i veprimeve të ndryshme dhe nuk ka sqarime për to në formatin e Pasqyrave financiare të të dhënave shpjeguese.

-Mungon analiza sipas llojeve të aktiveve që përbëjnë këtë grup aktivesh, me emërtesat aktiv për aktiv dhe vlerat përkatëse, duke munguar kështu inventari kontabël dhe fizik për këtë grup aktivesh, veprim në kundërshtim me UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" i ndryshuar pikat 26, 28, 30, Kreu IV pika 75;

-Udhëzimin e MFE nr. 8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Kreu II pika 5 dhe Kreu III, pika 3.1 "Procedurat e përgatitjes së pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", nënpika 30. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 27-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

8.1. Rekomandim: Titullari i Institucionit të ngrejë një grup pune me specialistë të fushës për kryerjen e inventarizimit dhe vlerësimit të aktiveve në llog. *214 "Instalime teknike, makineri, pajisje, vegla pune"* dhe nëpërmjet Sektorit të Financës të kryejë zbërthimin e dokumentacionit të financiar të trashëguar për nxjerrjen e të dhënave për aktivet e hyra e veprimet me to në vite, për të verifikuar, saktësuar e analizuar vlerat e paraqitura në PF e në rast pasaktësish të bëhen sistemimet e nevojshme në kontabilitet dhe në inventarin fizik.

Deri në 31.12.2022

9. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i dokumentacionit të mbajtur për kryerjen e inventarizimit për vitet 2019, 2020 dhe 2021 janë nxjerrë urdhrat përkatës, rezultoi se komisionet e inventarizimit kanë hartuar fletët e inventarëve me gjendjen fizike të aktiveve të qëndrueshme të patrupëzuara e të trupëzuara dhe gjendjen kontabël sipas llogarive. Fletët e inventarëve janë të konfirmuara nga komisioni dhe përgjegjësit material brenda afateve të përcaktuara për kryerjen e inventarëve. Referuar dokumentacionit të mbajtur nga komisioni konstatohet se për disa njësi kryerja e inventarizimit paraqet mangësi dhe shkelje të dispozitave ligjore, pasi komisioni ka konstatuar mungesa në artikuj të ndryshëm ka kryer diferencat nga gjendja fizike dhe i ka kaluar brenda ditës së inventarizimit në listën "mallra për jashtë përdorimit dhe funksionit".

Shuma e diferencave të artikujve për gjendjen fizike krahasuar me gjendjen e kontabilitetit e konstatuar nga inventarët e kryer **për vitin 2020 është 7,503,244** lekë dhe **shuma për vitin 2021 është 5,412,482** lekë, për të cilat nuk janë zbatuar drejt procedurat e inventarizimit si edhe nuk janë nxjerrë urdhër zhdëmtimet për personat përgjegjës në rastet e diferencave të gjendjes fizike.
-Vlera e propozuar për nxjerrje jashtë përdorimi të mallrave dhe materialeve që kanë humbur vlefshmërinë e përdorimit në spitalin Bashkiak Sarandë është **21,844,733 lekë,** për të cilën prej vitit 2019 nuk është vepruar nga strukturat drejtuese dhe nuk janë marrë masa për asgjësimin e tyre si ngritja e komisioneve të vlerësimit, komisionet e asgjësimit, etj.
-Në proces verbal nuk janë argumentuar arsyet e vlerësimit të artikujve nëse janë të nevojshëm ose jo për veprimtarinë e njësisë, vlerësimin e gjendjes fizike dhe mundësinë e përdorimit të mëtejshëm në njësi të tjera si dhe nëse do të nxirret përfundimisht jashtë përdorimit ndërmjet shitjes si material, mbeturinë apo asgjësimit përfundimtar.
-Vlerësimi i aktiveve nuk është bërë sipas kritereve si plotësimi i kohë së shfrytëzimit në bazë të normave të amortizimit, afatit të skadencës, nëse ka, dhe nuk mund të riparohen, kur vlera e riparimit ose e përshtatjes për t'i kthyer në gjendje pune është e barabartë ose më e madhe se vlera e tregut për blerjen e një aktivi të ngjashëm, kur ka kaluar afati i vlefshmërisë së tyre dhe nuk mund të përdoren si të zhvleftësuara, kur kanë humbur cilësitë e tyre të caktuara në standardet shtetërore ose në kushtet teknike dhe nuk mund të përdoren si të zhvleftësuar a ose për qëllim tjetër në formën që janë ose në formë tjetër, megjithëse nuk ka kaluar afati i vlefshmërisë, etj.
-Relacioni i vlerësimit nuk përmbante procedurën e ndjekur për vlerësimin e aktiveve për nxjerrje nga përdorimi, arsyet, efektin ekonomik të masave për riaftësimin e tyre dhe propozimin përkatës, veprime në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" Kreu IV "Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve" Inventarizimi i aktiveve, "Përgjegjësitë për inventarizimin" pikat 85, 86, 87 dhe 89, "Procesi i vlerësimit të aktiveve" pikat 96, 98 dhe "Lista e aktiveve të identifikuara për vlerësim" pikat 102,103 dhe 104.*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 27-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
9.1. Rekomandim: Drejtori i institucionit të marrë masa për ngritjen e komisionit të inventarizimit me qëllim verifikimin e diferencave të gjendjes fizike të mallrave të paraqitura nga inventarizimet e viteve 2019-2020 dhe 2021 në shumën ***5,412,482 lekë,*** për të cilat nëse rezultojnë me diferenca të nxirren urdhër zhdëmtimet për personat përgjegjës.
9.2. Rekomandim: Drejtori i institucionit të marrë masa për ngritjen e komisionit të vlerësimit të mallrave që kanë humbur vlefshmërinë e përdorimit vlerësuar prej vitit 2019 në shumën **21,844,733 lekë,** si edhe të kryej procedurat e nxjerrjes jashtë përdorimit të mallrave që do të klasifikohen jashtë funksionit, duke kryer analizat dhe argumentimet e bazuara në kriteret përkatëse dhe me relacionet shoqëruese.

Menjëherë

10. Gjetje nga auditimi: Referuar analizës së gjendjes së llog.401- 404 "Furnitorë e llogari të lidhura me to", në fund vitin 2021 rezulton me një gjendje prej ***18,556,689 lekë*** në të cilën janë akumuluar fatura të pa likuiduara të viteve 2019, 2020 dhe 2021, të cilave u ka kaluar afati 30-ditor i pagesës së këtyre faturave, veprime në kundërshtim me ligjin nr. 9936, datë 26.6.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, neni 52 dhe ligjin nr.48/2014 "Për pagesat e vonuara në detyrimet kontraktore e tregtare" neni 6 "Afati".*(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 27-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
10.1. Rekomandim: Spitali Sarandë të marrë masa për sigurimin e likuiditeteve, në mënyrë që të mos krijojë kufizime limiti të arkës *(përjashtuar kufizimet e MFE)*, për likuidimin e faturave në kohë, me qëllim mos krijimin e borxhit për fatura të pa likuiduara dhe futjen e institucionit në vështirësi financiare.

Vazhdimisht

11. Gjetje nga auditimi: Drejtoria e Financës nuk ka marrë masat e nevojshme për mbajtjen e evidencës kontabël në përputhje me parimet e të drejtave dhe detyrimeve të konstatuara. Gjendja e llogarisë së fondeve ***7206 "Financim i pritshëm nga buxheti"*** në fund të vitit 2021 paraqitet në vlerën 40,150,870 lekë, e cila nuk rakordon me gjendjen në vlerën 34,345,484 lekë të llogarisë analoge 4342 *"Operacione me shtetin (të drejta)"* të bilancit, në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme" Aneksi 1 "Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik" Pika 3.3 "Trajtimi kontabël dhe funksioni i llogarive të të tretëve (klasa 4) nënpika 8 "Llogaritë e marrëdhënieve me shtetin" i ndryshuar. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 27-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

11.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës të kryejë veprimet e sistemimit kontabël të llogarisë së gjendjes fondeve ***7206 "Financim i pritshëm nga buxheti"*** në fund të vitit 2021, të paraqitur gabim në pasqyrën e performancës, duke e rakorduar me gjendjen llogarisë 4342 *"Operacione me shtetin (të drejta)"*në aktiv të bilancit. Këto veprime ti kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2021 si dhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2022 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë për detyrimet dhe të drejtat në postet përkatëse të bilancit në përputhje me parimet kontabël.

Deri në 31.12.2022

12. Gjetje nga auditimi: *Gjendja e llogarisë* ***63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit"*** paraqitet në vlerën **30,638,126 lekë** e cila nuk rakordon me ndryshimin e gjendjeve të llogarive të klasës 3 **"Gjendja e inventarit qarkullues"** të aktiveve qarkulluese në formatin 1 të bilancit, të cilat paraqiten në mbyllje të vitit 2020 në vlerën **31,913,704** lekë dhe në mbyllje të vitit 2021 në vlerën **30,638,126** lekë, ku diferenca e tyre në zbritje është në vlerën prej **-1,275,578** lekë, duke ndikuar në saktësinë e informacionit kontabël të ofruar", në kundërshtim me Udhëzimin e MFE nr.8, datë 09.03.2018 "Për procedurat e përgatitjes, paraqitjes dhe raportimit të pasqyrave financiare vjetore në njësitë e qeverisjes së përgjithshme", i ndryshuar, *Aneksi 1"*Analiza e detajuar e klasave të llogarive të kontabilitetit në sektorin publik*", pika 4 "Shpenzimet*, të ardhurat dhe operacionet që lidhen me to në njësitë e qeverisjes së përgjithshme (Përbërja dhe trajtimi kontabël i llogarive të klasave 6, 7 dhe 8) i ndryshuar". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 27-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

12.1. Rekomandim: Drejtoria e Financës të kryejë veprimet e sistemimit kontabël të ***llogarisë 63 "Ndryshimi i gjendjes së inventarit",*** nëpërmjet saktësimit të gjendjeve të llogarive të klasës e të inventarit qarkullues. Këto veprime ti kryejë për efekt të rregullimit të gjendjeve në fund të vitit 2021 si edhe në hartimin e pasqyrave financiare në mbyllje të vitit 2022 të ketë në konsideratë që të kryejë veprimet kontabël në mënyrë të saktë të llogarisë të ndryshimit të gjendjeve dhe të efekteve që shkaktojnë në llogaritë e fondeve bazë.

Deri në 31.12.2022

13. Gjetje nga auditimi: Nga Sektori i Financës nuk janë marrë masat e nevojshme për mbajtjen e regjistrit historik të AAGJM, kryerjen e procedurave të plota të inventarizimit si dhe llogaritjen e amortizimit aktiv për aktiv mbi bazë historiku të krijimit të tij.

Nuk janë mbajtur të dhëna për aktivet për një pjesë të tyre si: viti i krijimit, shtesat dhe pakësimet për to, pra nuk është mbajtur një libër i mirëfilltë historik me të gjitha të dhënat e aktiveve të trupëzuara sipas modelit klasik të trajtuar më lart, domosdoshmëri kjo për të pasur një evidentim dhe pasqyrë të plotë në mënyrë analitike të aktiveve në përputhje me gjendjet në llogaritë e bilancit në përputhje me kap III pika 30, të UMF nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik". *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 27-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

13.1. Rekomandim: Sektori i Financës të hartojë një regjistër të plotë historik për çdo aktiv me të dhënat për veprimet ekonomike të kryera me to në vite si: viti i hyrjes, vend-ndodhjen,

përshkrimin e aktivit, vlerën e blerjes, vlerën e shpenzimeve kapitale të kryera në vitet e mëpasshme që sjellin rritje të vlerës së aktivit, vlerën e akumuluar të amortizimit dhe vlerën e mbetur. Mbi bazën e tij të llogarisë amortizimin aktiv për aktiv si edhe të realizojë inventar fizik për të gjithë AAGJ, për verifikimin e ekzistencës fizike e tyre.

Brenda datës 31.12.2022

14. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i funksionimit të strukturave drejtuese në Spitalin Bashkiak Sarandë për periudhën 01.08.2018 deri më 31.12.2021, konstatohet se nuk është ngritur struktura e Këshillit Administrativ si një nga strukturat që drejton dhe jep mendime për mirëfunksionimin e aktivitetit spitalor, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9106, datë 17.7.2003, "Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë" neni 12, dhe Rregulloren e funksionimit të institucionit nenet 5 dhe 6. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-16, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

14.1. Rekomandim: Drejtori i Spitalit Sarandë, të marrë masa dhe të propozojë në Ministrisë së Shëndetësisë Mbrojtjes Sociale për ngritjen e strukturës drejtuese të Këshillit Administrativ, me qëllim përmirësimin, organizimin, financimin, funksionimin dhe kontrollin e veprimtarisë së shërbimit spitalor dhe rritjen e nivelit të shërbimit.

Brenda datës 31.12.2022

15. Gjetje nga auditimi: Rregullorja e Brendshme e funksionimit të Institucionit nuk është e miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, megjithëse është hartuar nuk është miratuar me Urdhër të Drejtorit të Spitalit. Nga shqyrtimi i librit të protokollit për vitin 2018, rezulton se me nr.246 prot., datë 20.02.2018 është dërguar shkresa për miratimin e Rregullores së Brendshme në Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, por mungon kopja e shkresës përcjellëse si edhe nuk është kthyer përgjigje për miratimin ose jo të kësaj Rregullore e cila daton prej vitit 2018, veprim në kundërshtim me Ligjin nr. 9106, datë 17.7.2003, "Për shërbimin spitalor në Republikën e Shqipërisë" Kreu III, neni 23. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.1, faqe 15-16, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

15.1. Rekomandim: Drejtoria e Spitalit Sarandë të marrë masa për plotësimin e kuadrit ligjor të institucionit, miratimin e rregullores së re dhe statutit duke e përshtatur dhe në koherencë me ndryshimet në strukturë dhe legjislacion, me qëllim monitorimin tekniko-administrativ, duke evidentuar problematika, përgjegjësi dhe rekomandime me afate konkrete brenda kompetencave të përshkruara në Rregulloren dhe statutin e Spitalit.

Menjëherë

16. Gjetje nga auditimi: Në lidhje me implementimin e ligjit për menaxhimin financiar dhe kontrollit konstatohet se:

-Mungon Kodi Etik, gjithashtu rregullat e etikës nuk janë pjesë e rregullores së brendshme si dhe Institucioni nuk ka një komision etike për të trajtuar këto çështje.

-Nuk është hartuar një strategji institucionale në të cilën të paraqiten prioritetet dhe objektivat si dhe planet e veprimit për arritjen e tyre.

-Nuk është ngritur grupi të menaxhimit strategjik.

-Nga auditimi me zgjedhje i dosjeve të personelit nuk është kryer vlerësimi i punës për çdo punonjës i cili realizohet çdo 6 mujor.

-Nuk janë hartuar dhe miratuar programe specifike për trajnimin e stafit.

-Nuk janë hartuar dhe miratuar Strategjitë e Riskut.

-Nuk është hartuar, miratuar, arkivuar Gjurma e Auditit, e cila përfaqëson rrjedhën e dokumentuar të transaksioneve financiare dhe të transaksioneve të tjera, nga fillimi deri në përfundim të tyre.

-Në lidhje me komunikimin e jashtëm, mungon një faqe zyrtare web në të cilën paraqiten informacione për publikun.

-Nuk është plotësuar asnjë pyetësor vetëvlerësimi në mënyrë që të identifikojë problematikat e kontrollit të brendshëm me qëllim përmirësimin e tyre.
-Për periudhën objekt auditimi ***nuk është vënë në funksionim Ligji për Menaxhimin Financiar dhe Kontrollin, nuk njihet nga strukturat drejtuese të SBR e punonjësit e saj, nuk ka funksionuar në asnjë hallkë të njësisë dhe për pasojë, drejtuesit nuk kanë bërë një vlerësim të efektivitetit të sistemit të menaxhimit financiar dhe kontrollit,*** veprime këto në kundërshtim me Ligjin nr. 10296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin" i ndryshuar si dhe Manualin e Menaxhimit Financiar dhe Kontrollit, të miratuar me Urdhër të Ministrit të Financave nr. 108, datë 17.11.2016. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.7, faqe 77-81, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
16.1. Rekomandim: Spitali Bashkiak Sarandë të marrë masa për të rritur performancën në drejtim të përdorimit efikas, efektiv dhe ekonomik të burimeve, të personelit, pasurive dhe buxhetit në zbatim të fondeve buxhetore që menaxhmenti i spitalit të jetë përgjegjës, jo vetëm për marrjen e vendimeve por edhe për të siguruar që këto vendime të jenë efektive, si hartimin dhe menaxhimin e strategjisë dhe regjistrit të riskut, krijimin e listave të proceseve kryesore dhe gjurmët e auditimit, me qëllim arritjen e mjaftueshme të aktiviteteve të kontrollit për identifikimin, kontrollin dhe reduktimin e risqeve, si edhe përfshirjen efektive të sektorëve të ndryshëm në procese, dokumentacionin përkatës, përgjegjësitë personale, mbështetjen e sistemeve të IT.

Menjëherë

17.Gjetje nga auditmi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt ***"Shërbimi lavanterisë dhe hotelerisë për nevoja të Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Sarandë"*** me fond limit 97,256,679 lekë, nga ana e KVO është kualifikuar OE "D." shpk në kundërshtim me kërkesat ligjore dhe dokumentet e tenderit të hartuar sipas DST të miratuar, KVO ka vepruar me dy standarde në rastin e vlerësimit të ofertave në këtë proçedurë prokurimi, ku me njërin OE është treguar shumë strikt dhe me tjetrin shumë liberale.
17.1.Rekomandim: DSHSS të marrë masa që në të ardhmen të kryej vlerësim sa më objektiv duke ruajtur paanshmërinë në procedurat që vlerësohet qofshin ato me ofertë më të ulët apo më të lartë. Pasja në vëmendje plotësimin e të gjitha kritereve për kualifikim në respekt të legjislacionit.

Menjëherë

18. Gjetje nga auditmi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt "**Blerje kite, reagent e material konsumi laboratorik-3 lote**" grupi i përllogaritjes së fondit limit nuk ka respektuar ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" neni 2 për miradministrimin e fondeve publike, duke përzgjedhur një proçedurë për testimin e tregut me kosto më të larta sesa marrja në konsiderat e kontratave të mëparshme, kjo e vërtetuar dhe nga ofertat e ardhura që kanë qenë anomlisht të ulëta për me argument përkatës. Grupi i punës për përllogaritjen e fondit limit e ka fryrë fondin duke përzgjedhur mënyrën e testimit të tregut pa pasur asnjë arsye konkrete edhe pse kontratat e mëparshme janë realizuar me sukses. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 27-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
18.1.Rekomandim: AK, Njësia e prokurimit ose grupi i përllogaritjes së fondit limit, në çdo rast duhet të respktojë çdo specifikim teknik, dizajnim apo projektim të parashikuar, duke marrë në konsideratë kontratat e mëparshme dhe çdo formë tjetër të parashikuar nga legjislacioni për një përdorim sa më të mirë të fondeve publike.

Në vijimësi

B. MASA SHPËRBLIM DËMI

1. Gjetje nga auditimi: Nga auditimi i zbatimit të kontratës me objekt "*Shërbimi lavanterisë dhe hotelerisë për nevoja të Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Sarandë"* me vlerë kontrate 96,880,898 lekë, ku fitues është shpallur OE "D." shpk, rezulton se: mallrat e paraqitura në

faturën e muajin shkurt 2022, nuk janë sipas specifikimeve teknike të kontratës (faqet 16 deri në 19 Aneksi nr. 2 "Specifikimet teknike"), pasi nuk kanë ofruar llojin e materialit të butë sipas përmasave të hartuara nga grupi i punës, duke ofruar material të butë jo sipas kontratës (*konstatuar edhe nga AK*), duke përfituar padrejtësisht ***vlerën 1,095,579 lekë, e cila konsiderohet dëm ekonomik për buxhetin e shtetit.*** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 27-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandim: DSHSS të marrë masa që t'i kërkojë kontraktorit "D." shpk, duke ndjekur të gjitha procedurat administrative, si dhe të gjitha shkallët e gjykimit për arkëtimin e shumës **1,095,579** lekë, të cilën e ka përfituar padrejtësisht si edhe në të ardhmen shërbimi të kryhet referuar DST dhe kontratës së nënshkruar.

Menjëherë

2.Gjetje nga auditimi: Referuar dokumentacionit teknik, si dhe verifikimeve në objekt, për kontratën "*Rikonstruksion i ambienteve të pediatrisë*", u konstatuan mangësi si më poshtë:

- Sipas zërit 2.4 "Tavan i varur me pllaka gipsi 60 x 60 cm" është certifikuar sasia 341 m^2. Nga kjo sasi, sasia 98.7 m^2, i përket korridorit të madh. Nga verifikimi i planimetrisë dhe matjeve në objekt rezulton se sipërfaqja e korridorit është 66 m^2 (30 m x 2.2 m), nga ku rezulton se është certifikuar më tepër sasia 32.7 m^2. Vlera **75,210 lekë** (32.7 m^2 x 2,300 lekë/m^2), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori "N.-86." SHPK dhe përbën dëm ekonomik.

Po sipas këtij zëri, rezulton se në sipërfaqen totale të llogaritur nuk është zbritur sipërfaqja e ndriçuesve led (60 cm x 60 cm) për sasinë 40 copë. Vlera **33,120 lekë** (40 copë x 0.36 m^2 x 2,300 lekë/m^2), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori "N.-8." dhe përbën dëm ekonomik.

- Sipas zërit 2.3 "Shtresë me pllaka grez importi", është certifikuar sasia 440 m^2. Për korridorin e madh është certifikuar sasia 98.7 m^2. Nga verifikimi i planimetrisë dhe matjeve në objekt rezulton se sipërfaqja e korridorit është 66 m^2 (30 m x 2.2 m), nga ku rezulton se është certifikuar më tepër sasia 32.7 m^2. Vlera **62,130 lekë** (32.7 m^2 x 1,900 lekë/m^2), është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori "N.-86." SHPK dhe përbën dëm ekonomik.

-Në lidhje me punimet në tavan llogaritur me diferencë 32.7 m^2 janë certifikuar më tepër edhe punimet sipas zërit 3.1 "Patinim tavani allçi (stuko)" me vlerë **14,715 lekë** (32.7 m^2 x 450 lekë/m^2) si dhe zërit 3.2 "Bojë hidroplastike importi cilësi e I) me vlerë **10,791** lekë (32.7 m^2 x 330 lekë/m^2).

- Nga verifikimi sipas zërit "Portë duralumini me dyfish xham dhe me sistem elektronik për hapje", rezulton se në librezën e masave, referuar dhe matjeve në objekt është realizuar sasia 5.7 m^2, ndërsa është likuiduar sasia 6.4 m^2. **Vlera 39,200 lekë** [(6.4 m^2 - 5.7 m^2) x 56,000 lekë/m^2], është përfituar padrejtësisht nga Kontraktori "N.-86." SHPK dhe përbën dëm ekonomik, veprime në kundërshtim me Ligjin nr. 8402, datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar, neni 7, Udhëzimin e KM nr. 3, datë 15.02.2001 "Për mbikëqyrjen dhe kolaudimin e punimeve të ndërtimit" i ndryshuar, pika I.17, si dhe Udhëzimin nr. 2, datë 13.05.2005 "Për zbatimin e punimeve të ndërtimit", pika 8.2 dhe 8.3. *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 27-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*

1.1. Rekomandim: Drejtoria e Shërbimit Spitalor Sarandë, të kërkojë në rrugë ligjore duke ndjekur të gjitha procedurat e nevojshme administrative dhe të gjitha shkallët e gjykimit, arkëtimin e vlerës **235,166 lekë**, nga Kontraktori "N. – 86." SHPK, për punime të likuiduara por të pa realizuara.

Deri më datë 31.12.2022

C. MASA PËR ELIMINIMIN E EFEKTEVE NEGATIVE TË KONSTATUARA NË ADMINISTRIMIN E FONDEVE PUBLIKE DHE PËR MENAXHIMIN ME EKONOMICITET, EFICENCË DHE EFEKTIVITET TË FONDEVE PUBLIKE

1. Gjetje nga auditimi: Të ardhurat nga shërbimet spitalore për vitin 2019, krahasuar me vitin 2018, janë ulur me 511,850 lekë, ndërsa në vitet 2019, 2020 dhe 2021, janë në nivele të qëndrueshme, ndërsa të ardhurat nga parkimi, janë ulur ndjeshëm në vitin 2021. Krahasuar vitin 2019 me 2018, rezulton se të ardhurat nga ky burim janë rritur me 524,050 lekë, për vitin 2020 krahasuar me vitin 2019, janë rritur me 167,300 lekë, ndërsa për vitin 2021, krahasuar me vitin 2020 janë ulur me 767,150 lekë, duke ndikuar negativisht në totalin e të ardhurave të mbledhura nga spitali, e cila reflektohet në uljen e nivelit të të ardhurave të realizuara në vitin përkatës.
Për të ardhurat nga parkimi me qëllim menaxhimin e hapësirave të parkimit në territorin e spitalit është nxjerrë urdhri i drejtorit nr.115, datë 09.11.2018, ku janë përcaktuar edhe tarifat orare të qëndrimit të automjeteve.
Të ardhurat në total për vitin 2019 krahasuar me 2018, janë ulur në shumën 12,200 lekë, për vitin 2020 krahasuar me 2019, të ardhurat janë ulur në shumën 14,650 lekë dhe për vitin 2021 krahasuar me vitin 2020, janë ulur në shumën 373,718 lekë.
Megjithëse të ardhurat nga shërbimet spitalore janë në nivele të qëndrueshme, ato janë ulur me ***767,150 lekë***, të ardhurat nga parkimi krahasuar me vitin 2020, si rezultat i mosshfrytëzimit të sipërfaqes së parkimit në favor të spitalit, në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", i ndryshuar, pika 10 **"**Përgjegjësitë e menaxherëve të tjerë, nëpunësve dhe punonjësve publike" dhe rregulloren e institucionit Kreu II "Detyrat dhe kompetencat e zv/drejtorit ekonomik". (*Më hollësisht trajtuar në pikën 2.6, faqe 74-76, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
1.1. Rekomandim: Drejtori i Spitalit, Drejtoria ekonomike dhe shërbimeve, të marrë masa për vënien në funksionim të parkimit në ambientet e brendshme me qëllim shfrytëzimin e hapësirave për parkim në dobi të spitalit dhe rritjen e të ardhurave.

Në vijimësi

2. Gjetje nga auditmi: Nga auditimi i procedurës së prokurimit me objekt ***"Shërbimi lavanterisë dhe hotelerisë për nevoja të Drejtorisë së Shërbimit Spitalor Sarandë" grupi*** i përllogaritjes së fondit limit nuk ka respektuar specifikimet teknike të përcaktuara. Mos respektimi i specifikimeve konkretisht përmasave të materialit të butë për pavijonin pediatrik por duke i marrë ato si pavijonet për të rritur ka sjellë një rritje të fondit limit me **2,101,377 lekë, vlerë e cila konsiderohet efekt financiar negativ për buxhetin e shtetit.** *(Më hollësisht trajtuar në pikën 2.5, faqe 27-55, të Raportit Përfundimtar të Auditimit).*
2.1. Rekomandim: AK, Njësia e prokurimit ose grupi i përllogaritjes së fondit limit nëse ka një të tillë, në çdo rast duhet të respektojë çdo specifikim teknik, dizajn apo projektim të parashikuar në përllogaritjen e fondit limit me qëllim shmangien e diferencave që krijohen dhe përsosmërinë në përcaktimin e fondit që do të prokurohet.

Në vijimësi

D. MASA DISIPLINORE

E.1.1 Për punonjësit që marrëdhëniet e punës rregullohen me Kodin e Punës
Mbështetur në nenet 37, 141 e 153, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 7961, datë 12.7.1995 "Kodi i Punës", i ndryshuar, dhe kontratës kolektive të punës si dhe kontratave individuale dhe

rregullores së brendshme të institucionit, Drejtori i Spitalit Bashkiak, Sarandë, të marrë masën disiplinore nga ***"Vërejtje"***, për:

1. z. M. B
2. znj. S. G
3. znj. L. I, në cilësinë e anëtarëve të Njësisë së Prokurimit, **për arsye se**:
Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit "Blerje lëndë djegëse për ngrohje-Palet, për vitin 2019", kanë përcaktuar dimensione fikse dhe marka për kaldajën ngrohëse, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" (i shfuqizuar), neni 23, pika 2. Znj. S. G, gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit "Rikonstruksion i Pediatrisë në Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Sarandë", ka hartuar kritere të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës.
Znj. L. I, në cilësinë e k/komisionit të inventarizimit ka vepruar në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" Kreu IV "Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve" Inventarizimi i aktiveve, "Përgjegjësitë për iventarizimin" pikat 85,86,87 dhe 89, "Procesi i vlerësimit të aktiveve" pika 96 dhe 98 dhe "Lista e aktiveve të identifikuara për vlerësim" pikat 102,103 dhe 104.
4. z. F. Ll
5. znj. A. K
6. znj. V. D, në cilësinë e anëtarëve të KVO**, për arsye se:**
- Në procedurën e prokurimit "Blerje lëndë djegëse për ngrohje-palet", kanë kualifikuar operatorin ekonomik i cili nuk ka plotësuar dokumentet sipas kërkesave të tenderit, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" (i shfuqizuar), neni 46, pika 1. znj. A. K, gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit "Rikonstruksion i Pediatrisë në Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Sarandë", ka hartuar kritere të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës.
7. z. L. M, në cilësinë e Njësisë së Prokurimit, **për arsye se**:
Gjatë zbatimit të procedurës së prokurimit "Rikonstruksion i Pediatrisë në Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Sarandë", ka hartuar kritere të cilat nuk janë në përputhje me natyrën dhe volumin e kontratës, në kundërshtim me Ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 "Për prokurimin publik" (i shfuqizuar), neni 23, pika 2, neni 46, pika 3 dhe VKM nr. 914, datë 29.12.2014 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik" (shfuqizuar) neni 26, pika 5.
8. znj. F. S,
9. znj. E. D
10.znj.Xh. M, në cilësinë e anëtarëve të grupit të punës për llogaritjen e fondit limit, në procedurën procedurën **"Blerje kite, reagent e material konsumi laboratorik-3 lote"** viti 2021, **për arsye se:** nuk kanë respektuar ligjin nr. 162/2020 "Për prokurimin publik" neni 2 për mirëadministrimin e fondeve publike, duke përzgjedhur mënyrën e testimit të tregut me kosto më të larta sesa marrja në konsideratë e kontratave të mëparshme.
znj. F. S, në cilësinë e k/komisionit të inventarizimit ka vepruar në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" Kreu IV "Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve" Inventarizimi i aktiveve, "Përgjegjësitë për inventarizimin" pikat 85,86,87 dhe 89, "Procesi i vlerësimit të aktiveve" pika 96 dhe 98 dhe "Lista e aktiveve të identifikuara për vlerësim" pikat 102,103 dhe 104.
11. z. V. C,
12. znj. S. D, në cilësinë e k/komisionit të inventarizimit kanë vepruar në kundërshtim me Udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" Kreu IV "Sistemi i kontrollit periodik të aktiveve" Inventarizimi i aktiveve, "Përgjegjësitë për inventarizimin" pikat 85,86,87 dhe 89, "Procesi i vlerësimit të aktiveve" pika 96 dhe 98 dhe "Lista e aktiveve të identifikuara për vlerësim" pikat 102,103 dhe 104.

13.z. F. S, me detyrë zv/drejtor ekonomik, nuk ka marrë masa për evadimin/asgjësimin e mallrave të propozuara për nxjerrje jashtë përdorimi të mallrave dhe materialeve që kanë humbur vlefshmërinë e përdorimit në spitalin Bashkiak Sarandë në vlerën **21,844,733 lekë,** prej vitit 2019.
- nuk ka marrë masa për rritjen e të ardhurave nga parkimi në favor të spitalit por si rezultat i mosshfrytëzimit të sipërfaqes të ardhurat nga parkimi janë ulur me ***767,150 lekë***, krahasuar me vitin 2020, duke vepruar në kundërshtim me Udhëzimin nr.30, datë 27.12.2011 "Për Menaxhimin e Aktiveve në Njësitë e Sektorit Publik", i ndryshuar, pika 10 **"**Përgjegjësitë e menaxherëve të tjerë, nëpunësve dhe punonjësve publike" dhe rregulloren e institucionit Kreu II "Detyrat dhe kompetencat e zv/drejtorit ekonomik".
- ka vepruar në kundërshtim me Udhëzimin nr. 7, "Për procedurat standarde të përgatitjes së PBA" datë 28.02.2018, pika 6. Metodologjia e përcaktimit të politikave ekzistuese dhe politikave Ligji nr. 10 296, datë 08.07.2010, "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin", i ndryshuar, Neni 4, pika 19 dhe neni 16, sa i takon planifikimit të buxhetit për artikujt të cilët rezultojnë me tejkalim dhe minimizimin e shpenzimeve të tjera me qëllim uljen e detyrimeve të papaguara të cilat deri në vitin 2021 kanë qenë në nivel të lartë.
-për planifikimin e nevojave vjetore për barna dhe materiale mjekësore nga Shërbimet mjekësore, gjatë hartimit të projektbuxhetit dhe planit buxhetor (pas miratimit), nuk ka analizuar gjendjen e ilaçeve, sasinë e konsumit të tyre vjetore, në mënyrë që të justifikojnë dhe argumentojnë listën për nevojat e këtyre barnave. Rritjen e sasive të barnave të porositura nuk e ka shoqëruar me relacione shpjeguese dhe argumentuese për justifikimin e sasive shtesë.

Shënim: Ish-Titullarët e AK z. E. Dh dhe z. T. L, kanë ngritur njësi prokurimi dhe komision të vlerësimit të ofertave pa angazhuar në përbërje të tyre specialistë të fushës. Duke qenë se janë larguar nga detyra, gjykojmë se masa disiplinore konsiderohet e ezauruar.
Në lidhje me mangësitë e konstatuara në zbatimin e Kontratës "Rikonstruksion i Pediatrisë në Drejtorinë e Shërbimit Spitalor Sarandë", gjykojmë mos rekomandojmë masë administrative, për mbikëqyrësin e punimeve z. A. K, duke e konsideruar vlerën e dëmit ekonomik jo të konsiderueshëm.

V. ANEKSE

Përdorimi i të ardhurave viti 2018

600	**PAGA, SHPERBLIME E SHPENZ. TJERA PERSONELI**	**3,294,975.00**
6002100	**Paga me kontrate pune**	3,294,975.00
602	**MALLRA DHE SHERBIME TE TJERA**	**2,668,053.00**
6021003	Ilaçe dhe material mjeksore	59,420
6021099	Të tjera material dhe shërbime speciale	60,000
6022099	Shërbime për dezefektimin e ambienteve të spitalit	114,240
6023100	Karburant dhe vaj	2,335,993

602550	Shpenzime për mbajtjen e aparaturave mjeksore	98,400
2310	**INVESTIME NGA TE ARDHURAT**	***6,520,611***
	Hidroizolim tarace	71,640
	F.V Sinjalistika	601,440
	Blerje F.v bariera elektronike	1,400,000
	.Vakumetër&Flusimetëer	300,000
	Blerje destkop	300,000
	Rikon kati i pare poliklinik	359,646
	Rrethimi i spitalit	330,184
	Furnizim dhe vendosje tabela sinjalistike	81,060
	Blerje Kompjutera – projekti sistemi radhes ne recepsion	*526,680*
	Blere panele oksigjeni	*1,122,161*
	blerje mobilje materniteti	*766,800*
	Blerje grila materniteti ri	*324,000*
	Blerje kosha mbeturinash	*132,000*
	blerje mobilje zyre zyre	*205,000*
	Shuma	**12,483,639**

Perdorimi i të ardhurave viti 2019

600	**PAGA, SHPERBLIME E SHPENZ. TJERA PERSONELI**	**3,294,975**
6002100	Paga me kontrate pune	3,294,975
602	**MALLRA DHE SHERBIME TE TJERA**	**2,668,053**
6021003	Ilaçe dhe materiale mjeksore	59,420
6021099	Të tjera material dhe shërbime speciale	60,000
6022099	Shërbime për dezefektimin e ambienteve të spitalit	114,240
6023100	Karburant dhe vaj	2,335,993
602550	Shpenzime për mbajtjen e aparaturave mjeksore	98,400
2310	**INVESTIME NGA TE ARDHURAT**	***6,520,611***
	Hidroizolim tarace	71,640
	F.V Sinjalistika	601,440
	Blerje F.v Bariera elektronike	1,400,000
	Vakumetër &Flusimetëer	300,000
	Blerje destkop	300,000
	Rikon kati i pare poliklinik	359,646
	Rrethimi i spitalit	330,184
	Furnizim dhe vendosje tabela sinjalistike	81,060
	Blerje Kompjuterae – projekti sistemi radhes ne recepsion	*526,680*
	Blere panele oksigjeni	*1,122,161*
	blerje mobilje materniteti	*766,800*
	Blerje grila materniteti ri	*324,000*
	Blerje kosha mbeturinash	*132,000*
	blerje mobilje zyre zyre	*205,000*
	Shuma	**12,483,639**

Perdorimi i të ardhurave viti 2020

6002	**PAGA TE PERSONELIT TE PERKOHSHEM**	**1,758,640**

6002900	Të tjera paga me kontratë	1,758,640
602	**MALLRA DHE SHERBIME TE TJERA**	**762,960**
6022099	Shërbime të tjera	72,000
6023	**SHERBIME TRANSPORTI**	15,000
6023100	Karburant dhe vaj	15,000
6025	**SHPENZIME PER MIREMBAJTJE TE ZAKONSHME**	**330,480**
6025500	SHpenzime për mirëmbajtjen e aparateve, pajisjeve teknike dhe veglave të punës	60,000
6025600	Shpenzime për mirëmbajtjen e mjeteve të transportit	270,480
231	**SHPENZIME PER RRITJEN E AKTIVEVE TE QENDR. TE TRUPEZUARA**	**1,116,025**
2312105	Shpenzime per ndertesa shendetesore	**1,080,871**
2314250	Shpenzime për pajisje të tjetra	**35,154**
	Shuma	**3,637,625**

Përdorimi i të ardhurave viti 2021

PAGA TE PERSONELIT TE PERKOHSHEM	**1,328,276**
Të tjera paga me kontratë	1,328,276
SHPENZIME PER RRITJEN E AKTIVEVE TE QENDR. TE TRUPEZUARA	**5,850,725**
Shpenzime për objekte të tjera ndërtimore	**5,850,725**
Shuma	**7,179,001**